



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E ENERGJISË DHE MINIERAVE

MINISTARSTVO ENERGIJE I RUDARSTVA

MINISTRY OF ENERGY AND MINING

STRATEGJIA E ENERGJISË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2009 – 2018



Prishtinë, 2009



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E ENERGJISË DHE MINIERAVE
MINISTARSTVO ENERGIJE I RUDARSTVA
MINISTRY OF ENERGY AND MINING

STRATEGJIA E ENERGJISË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2009 – 2018

Prishtinë, 2009



Republika e Kosovës
 Republika Kosovo - Republic of Kosovo
 Kuvendi - Skupština - Assembly

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo	
Ministria e Energjisë dhe Minierave / Ministarstvo Energije i Rudarstva / Ministry of Energy and Mining	
No. 550	D. 08.04.2010
P. autor: Pranuar: Kuvendi	Faza: Çështje: Pasi

Legjislatura III

Kuvendi,

Në mbështetje të nenit 65 (9) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të Rregullës 46 të Rregullores së Punës së Kuvendit, në seancën plenare të mbajtur më 01 prill 2010, pas shqyrtimit të Raportit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me Propozim-strategjinë e Energjisë për periudhën 2009-2018, mori këtë

V E N D I M

I. Miratohet Strategjia e Energjisë për periudhën 2009-2018, me rekomandimet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si në vijim:

1. Resurset e linjtit të vihen në dispozicion dhe shfrytëzimi në pajtim me kapacitetet e reja gjeneruese të energjisë dhe në harmoni me interesat zhvillimore të Kosovës.
2. Të krijohet ambient ligjor për konkurrencë dhe treg të lirë në fushën e sektorit të energjisë.
3. Në Strategjinë e energjisë, seksioni 11.2.5 Rivalizimi i TC "Kosova B" me pjesëmarrjen e sektorit privat, ndryshohet fjalia e tretë e paragrafit të dytë dhe formulohet si vijon: "sektori privat do të përfshihet në kuadër të transaksionit "Kosova e re".
4. Ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese të bëhet në bazë të interesit afatgjatë për Kosovën, në fazën e parë kapaciteti 1000 megavat me mundësi të ndërtimit të kapaciteteve të tjera, në harmoni me kërkesat dhe bilancin energjetik të vendit dhe të rajonit.
5. Qeveria e Kosovës obligohet ta harmonizojë Planin e veprimit me Strategjinë e energjisë të miratuar për periudhën 2009-2018.

Nr. 03-V-272
 Prishtinë, më 01 prill 2010

Kryetari i Kuvendit
 Jakup KRASNIQI

Vendimi i dërgohet:

- Qeverisë së Kosovës,
- Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë... dhe
- Arkivit të Kuvendit.

Përmbajtja

FALËNDERIM.....	7
SHKURTESAT.....	8
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	9
1. HYRJE.....	11
2. POLITIKAT, KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONET E SEKTORIT ENERGJETIK.....	11
2.1 POLITIKAT ENERGJETIKE DHE RREGULLIMI EKONOMIK.....	12
2.2 KORNIZA LIGJORE DHE RREGULLATORE.....	12
2.2.1 Korniza ligjore.....	12
2.2.2 Kuadri rregullator.....	13
2.3 INSTITUCIONET DHE NDËRMARRJET ENERGJETIKE.....	14
2.3.1 Institucionet.....	14
2.3.2 Ndërmarrjet energjetike.....	15
3. ANALIZA E GJENDJES DHE PROGRESI NË SEKTOR GJATË PERIUdhËS 2005-2008 17	17
3.1 PRODHIMI I LINJITIT DHE ENERGJIA ELEKTRIKE.....	17
3.1.1 Prodhimi i linjitit.....	17
3.1.2 Gjenerimi i energjisë elektrike.....	21
3.1.3 Bartja e energjisë elektrike.....	22
3.1.4 Shpërndarja e energjisë elektrike.....	23
3.2 FURNIZIMI, FATURIMI DHE INKASIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE.....	23
3.3 NGROHJA E PËRQENDRUAR.....	24
3.4 GAZI NATYROR DHE DERIVATET E NAFTËS.....	25
3.5 Efiçienca e energjisë dhe burimet e ripërtëritshme.....	25
3.6 Mbrojtja e mjedisit.....	26
3.7 Mbështetja financiare e deritanishme.....	29
4. KONSUMI DHE FURNIZIMI I ENERGJISË.....	30
4.1 KONSUMI TOTAL I ENERGJISË GJATË PERIUdhËS 2004-2007.....	30
4.2 KONSUMI I ENERGJISË SIPAS SEKTORËVE EKONOMIKË GJATË PERIUdhËS 2004-2007.....	31
4.3 ARSYET E RRIJTJES SË SHPEJTË TË KONSUMIT TË ENERGJISË.....	31
4.4 PRODHIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE NË PERIUdhËN 2000-2007.....	32
4.5 FURNIZIMI ME ENERGJI ELEKTRIKE GJATË PERIUdhËS 2000-2007.....	33
4.6 IMPORTI I ENERGJISË ELEKTRIKE.....	34
5. PROJEKTI ‘KOSOVA E RE’.....	35
6. INTEGRIMET RAJONALE DHE EVROPIANE.....	35
6.1 TRAKTATI PËR KOMUNITETIN E ENERGJISË.....	35
6.2 MEKANIZMI PËRCJELLËS PËR STABILIZIM ASOCIM.....	37
6.3 BASHKËPUNIMI DYPALËSH.....	37
6.4 KONFERENCA E DONATORËVE PËR KOSOVËN.....	39
7. PËRMBLEDHJE E ANALIZËS SWOT PËR SEKTORIN ENERGJETIK.....	40
8. PARASHIKIMI I NEVOJAVE PËR ENERGJI PËR PERIUdhËN 2009-2018.....	42
8.1 INTENSITETI ENERGJETIK DHE KONSUMI ENERGJETIK PËR BANOR.....	42
8.2 PARASHIKIMI I KËRKESËS PËR ENERGJI.....	42

8.2.1 Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin banesor.....	43
8.2.2 Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e shërbimeve	45
8.2.3 Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e industrisë	46
8.2.4 Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e transportit.....	48
8.2.5 Parashikimi i kërkesës së energjisë në sektorin e bujqësisë	50
8.2.6 Parashikimi i kërkesës për energji për gjithë sektorët	52
8.3 ANALIZA E PARASHIKIMIT TË KËRKESËS PËR ENERGJI ELEKTRIKE	53
8.3.1 Parashikimi i kërkesës për energji elektrike dhe i ngarkesave maksimale	53
8.3.2 Humbjet e energjisë elektrike në sistemin elektroenergetik	54
8.3.3 Masat për stabilizimin e furnizimit dhe kontrollit të konsumit të energjisë elektrike	54
8.4 PARASHIKIMI I PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË KOSOVË PËR PERIUdhËN 2009-2018	55
8.5 FURNIZIMI I KOSOVËS ME ENERGJI ELEKTRIKE PËR PERIUdhËN 2009-2018.....	56
8.6 FURNIZIMI I TERMOCENTRALEVE ME LINJIT PËR PERIUdhËN 2009-2018.....	57
9. MISIONI DHE VIZIONI I STRATEGJISË SË ENERGJISË.....	57
10. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE.....	58
11. POLITIKAT DHE MASAT PRIORITARE PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE.....	60
11.1 MIHJA E LINJIT	61
11.2 ENERGJIA ELEKTRIKE	63
11.2.1 Sthurja e mëtejme e KEK sh.a.	64
11.2.2 Faturimi dhe inkasimi, risanimi financiar i KEK sh.a.....	65
11.2.3 Mjedisi ligjor dhe rregullator	66
11.2.4 Termocentrali ‘Kosova e Re’	66
11.2.5 Rivitalizimi i TC “Kosova B” me pjesëmarrjen e sektorit privat	67
11.2.6 Modernizimi i sistemit të bartjes dhe integrimi ndërkombëtar i tij.....	67
11.2.7 Angazhimi i sektorit privat në shpërndarje dhe furnizim të energjisë elektrike.....	69
11.2.8 Zhvillimi i tregut të energjisë elektrike dhe konkurrenca	70
11.2.9 Tarifat e energjisë elektrike dhe mbrojtja sociale	71
11.2.10 Programi për menaxhimin e kërkesës “Demand Side Management”	71
11.2.11 Mbështetja nga Buxheti i Kosovës për sektorin elektroenergetik.....	71
11.3 NGROHJA E PËRQENDRUAR	72
11.4 GAZI NATYROR	72
11.5 NAFTA DHE DERIVATET E SAJ.....	74
11.6 EFIÇIENCA E ENERGJISË DHE BURIMET E RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË.....	75
11.7 SIGURIMI I STANDARDEVE PËR MBROJTJEN E MJEDISIT DHE ÇËSHTJET SOCIALE	76
11.8 VENDOSJA E SISTEMIT MODERN TË STATISTIKAVE ENERGETIKE	78
12. INTEGRIMET EVROPIANE DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR.....	78
13. NGRITJA E KAPACITETEVE INSTITUCIONALE VENDORE.....	79
14. MASAT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË SË ENERGJISË.....	79

Falënderim

Ministria e Energjisë dhe Minierave (MEM) falënderon ngrohtësisht të gjithë ata që bashkëpunuan me MEM në përgatitjen e kësaj Strategjie të Energjisë për Kosovën për periudhën 2009-2018, përfshirë Zyrën për Rregullatorin e Energjisë (ZRRË), Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (KOSTT sh.a.), Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK sh.a.), ngrohoret, Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave (MEF), Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), dhe Zyrën e Projektit LPTAP.

MEM falënderon, po ashtu edhe Bankën Botërore, Komisionin Evropian, Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar, për mbështetjen e gjithanshme që i japin institucioneve të sektorit energjetik në Kosovë. MEM beson se me këtë mbështetje në të ardhmen Kosova do të arrijë ta transformojë dhe rristrukturojë sektorin energjetik, si dhe do t'i tërheqë investimet e nevojshme private, duke e mundësuar integrimin e këtij sektori jetik me sistemet energjetike rajonale dhe Evropiane. Vetëm kështu do të mund të plotësohen objektivat strategjike të saj për përmirësimin rrënjësorë të sigurisë së furnizimit të konsumatorëve vendorë me shërbime energjetike, ekonomikisht të përballueshme dhe konkurruese.

Shkurtesat

AER	Agjencioni Evropian për Rindërtim
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BK	Buxheti i Kosovës
BRE	Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë
CBT	Tregtim Ndërkufitar i Energjisë
DSM	Menaxhimi nga Ana e Kërkesës - Demands Side Menagment
EE	Efiçienca e Energjisë
EJL	Evropa Juglindore
EMS	Energy Management System/ Menaxhimi me Sistemin e Energjisë
ETSO	Operatorët Evropian të Sistemit të Bartjes
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FpP	Ftesë për Propozim
GLN	Gazi i Lëngëzuar i Naftës
GPE	Grupi Punues për Energji
GWh	Gigavat orë
HC	Hydrocentral
KE	Komisioni Evropian
KEK sh.a.	Korporata Energjetike e Kosovës
KfW	Kreditanstalt für Wiederaufbau
KOSTT sh.a.	Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut në Kosovë
KPMM	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Ktoe	Kiloton Oil Ekuivalent
kW	Kilovat
kWh	Kilovat orë
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minerave
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MPSA	Mekanizmi Përcjellës i Stabilizimit Asocimit
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
MTI	Ministria për Tregtinë dhe Industri
MW	Megavat
NP	Ndërmarrje Publike
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSB	Operatorët e Sistemit të Bartjes
PATEL	Projekti i Asistencës Teknike Energjia nga Linjiti
PBP	Produkti i Brendshëm Bruto
PPP	Partneriteti Publiko Privat
PV	Plani i Veprimit
PVPE	Plani i Veprimit për Partneritet Evropian
PZSE	Programi për Zbatimin e Strategjisë së Energjisë
QK	Qeveria e Kosovës
SCADA	Supervisory Control and Data Acquisition System/ Mbikëqyrja e Komandimit dhe Mbledhja e të Dhënave
SLK	Skenari i Lartë i Kërkesës
SMK	Skenari i Mesëm i Kërkesës
SRE	Strategjia e Rishikuar e Energjisë
SWOT	Analiza e Përparësive, Dobësive, Mundësive dhe Rreziqeve
TC	Termocentral
TEEA	Marrëveshje Teknike e Përkohshme për Shkëmbim të Energjisë
TKE	Traktati i Komunitetit të Energjisë
TML	Taksa mbi Mijën e Linjtit
TTA	Marrëveshje Teknike e Përkohshme
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
VSMS	Vlerësimi Strategjikë Mjedisorë dhe Social
ZRrE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky dokument paraqet rishikimin e Strategjisë së Energjisë së Kosovës për periudhën 2005-2015. Mbështetur në analizën dhe reflektimin mbi situatën aktuale, kjo Strategji identifikon sfidat më të rëndësishme me të cilat ballafaqohet sektori energjetik, orienton zhvillimin e politikave më të përshtatshme për shndërrimin sa më parë të këtij sektori jetik për Kosovën në një sektor të qëndrueshëm dhe të vetëfinansueshëm, që ofron shërbime cilësore energjetike, ekonomisht të favorshme për konsumatorët në Kosovë, dhe identifikon politikat dhe masat kryesore që do të ndërmerren për avancimin e reformave në sektor, për ta mundësuar kështu tërheqjen e investimeve private, mbrojtjen e mjedisit, dhe integrimin sa më të plotë dhe më të shpejtë të sistemeve energjetike të Kosovës me ato rajonale dhe Evropiane.

Kjo Strategji i kushton vëmendje të veçantë përputhshmërisë me ‘*acquis*’ të Bashkimit Evropian, ‘*acquis*’ këto që për sektorin energjetik janë të obligueshme për Kosovën në kuadër të anëtarësimit në Traktatin e Komunitetit të Energjisë. Strategjia synon stimulimin e përdorimit racional të energjisë dhe rritjen e efikasitetit të saj, shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, futjen e teknologjive të reja dhe zbatimin e standardeve mjedisore, siç parashikohen me ligj.

Objektivat strategjike, politikat dhe masat e identifikuar në këtë Strategji, për secilin nënsektor të sektorit energjetik, përbëjnë bazën për hartimin e Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë për Periudhën 2009-2011.

Strategjia përfshin një periudhë kohore 10-vjeçare. Synimet dhe masat e parashikuara në të përbëjnë një vizion të qartë për disa aspekte kyçe me interes të lartë për zhvillimin e sektorit energjetik gjatë dekadës 2009-2018. Strategjia është e ndarë në dy pjesë.

Pjesa e Parë përmban një paraqitje komplete dhe analizë të situatës aktuale dhe progresit të arritur në sektorin energjetik gjatë periudhës 2006-2008, përfshirë politikat e zbatuara deri më tani; kuadrin ekzistues ligjor dhe rregullator; institucionet dhe ndërmarrjet ekzistuese energjetike; analizën e konsumit, prodhimit, bartjes e shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë; progresin në sektorin e ngrohjes, gazit natyror, efikasitetit të energjisë dhe burimeve të ripërtëritshme; mbështetjen financiare publike dhe nga donatorët për sektorin energjetik; progresin në përgatitjen për ndërtimin e Termocentralit ‘Kosova e Re’; dhe progresin e arritur në fushën e integritimeve rajonale dhe Evropiane. Pjesa e parë e Strategjisë përfundon me një përmbledhje të analizës SWOT për sektorin energjetik të Republikës së Kosovës. Nga analizat e paraqitura në Pjesën e Parë të Strategjisë, janë identifikuar sfidat përpara sektorit energjetik, sfida këto ku mbështeten objektivat strategjike të shënuara në Pjesën e Dytë të dokumentit.

Pjesa e Dytë përmban parashikimin e nevojave për energji dhe mbulimi i tyre për periudhën 2009-2018 në total dhe për secilin sektor ekonomik; misionin dhe vizionin e Strategjisë; objektivat strategjike; politikat dhe masat prioritare për realizimin e objektivave strategjike; perspektivën e integritimeve Evropiane dhe bashkëpunimi ndërkombëtar; nevojën dhe masat për ngritjen e kapaciteteve institucionale vendore; dhe masat e parashikuara për zbatimin e kësaj Strategjie.

Fokus të veçantë në këtë strategji ka arritja sa më parë të jetë e mundur e sigurisë së furnizimit të qëndrueshëm e cilësorë me energji elektrike. Për këtë, rëndësi e veçantë i është kushtuar ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike dhe rehabilitimit të TC ‘Kosova B’, të dyja

këto me pjesëmarrjen e sektorit privat. E njëjta parashikohet edhe për sigurimin e mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm me linjit të këtyre kapaciteteve gjeneruese në të ardhmen.

Përmirësimi i nivelit të faturimit dhe inkasimit të energjisë elektrike të shpenzuar përbën një sfidë të rëndësishme për KEK sh.a. dhe institucionet e vendit. Arritja e objektivave të vendosura do të përbëjë një bazë mjaft të mirë për ta rritur besimin e investitorëve në sektorin energjetik, si dhe do ta ulë masën e rrezikut të përceptuar prej tyre.

Plotësimi i obligimeve që rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë dhe procesi i integrimi Evropiane është një tjetër dimension i rëndësishëm i kësaj Strategjie. Në këtë kuadër, parashikohen masat që do të ndërmerren në të ardhmen për përfundimin e ristrukturimit dhe reformimit të sektorit energjetik në përputhje me direktivat e KE-së dhe legjislacionit vendor në fuqi, ashtu që ky sektor të bëhet jo vetëm i vetëqëndrueshëm nga pikëpamja financiare, por edhe të tërheqë investime private dhe të arrijë të kontribuojë ndjeshëm në zhvillimin e shpejtë dhe të qëndrueshëm ekonomik e social të vendit.

Zbatimi i qasjes Evropiane, sa i takon energjisë, mjedisit dhe konkurrencës, është në vëmendjen e kësaj Strategjie. Kjo do ta mundësojë integrimin e sektorit energjetik të vendit tonë në sistemet energjetike Evropiane. Vëmendje e veçantë i kushtohet mbrojtjes së mjedisit nga emetimet ndotëse prej stabilimenteve energjetike.

Edhe rritja e efikasitetit të energjisë dhe shfrytëzimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë konsiderohen elemente të rëndësishme të kësaj Strategjie. Politika dhe masa të qarta janë përfshirë në këtë dokument për këta dy sektorë të rëndësishëm.

Strategjia synon përgatitjen e një kuadri të plotë ligjor dhe rregullator, që do ta mundësonte tërheqjen e investimeve të konsiderueshme private në sektorin tonë energjetik. Korniza rregullatore e sektorit energjetik të Kosovës synohet të jetë e plotë dhe e qartë, në mënyrë që të arrihet besimi i investitorëve të huaj në të.

Së fundi, por mjaft e rëndësishme të theksohet se vizioni i Strategjisë është që nëpërmjet investimeve private do të mund të eliminohet jo vetëm barra aktuale që sektori energjetik përbën për Buxhetin e Kosovës, por edhe do të mund të arrihet të përmirësohet ndjeshëm siguria e furnizimit me energji dhe cilësia e tij në periudhën afatmesme në vijim

Pjesa e Parë

1. Hyrje

Ky rishikim i Strategjisë së Energjisë së Kosovës është realizuar në përputhje me Ligjin e Energjisë Nr. 2004/8. Strategjia e Rishikuar e Energjisë (SRE) është mbështetur në analizën dhe reflektimin mbi situatën aktuale. Ajo identifikon sfidat më të rëndësishme me të cilat ballafaqohet sektori energjetik, orienton zhvillimin e politikave më të përshtatshme për shndërrimin sa më parë të këtij sektori jetik për Kosovën në një sektor të qëndrueshëm dhe të vetëfinancueshëm, që ofron shërbime cilësore energjetike ekonomikisht të favorshme për konsumatorët në Kosovë, si dhe identifikon politikat dhe masat kryesore që duhet të ndërmerren për avancimin e reformave në sektor, për ta mundësuar kështu tërheqjen e investimeve private dhe integrimin sa më të plotë dhe më të shpejtë të sistemeve energjetike të Kosovës me ato rajonale dhe Evropiane.

Rishikimi i Strategjisë së Energjisë është bazuar në Programin dhe Vendimet e Qeverisë së Kosovës, si dhe një numër studimesh dhe analizash relevante. Vëmendje e veçantë i është kushtuar përputhshmërisë së kësaj Strategjie edhe me *acquis* të Bashkimit Evropian, *acquis* këto të obligueshme për Kosovën në kuadër të anëtarësimit në Traktatin e Komunitetit të Energjisë.

Ky dokument përbën kornizën themelore në bazë të së cilës, pas miratimit në Qeveri dhe aprovimit në Kuvendin e Kosovës, do të realizohen hapat e mëtejshëm të reformave, ristrukturimit të plotë dhe zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit energjetik. Objektivat strategjike, politikat, dhe masat të identifikuara në këtë dokument për secilin nënsektor synojnë edhe krijimin e bazës orientuese për hartimin e Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë për Periudhën 2009-2011.

Strategjia e Energjisë së Kosovës synon edhe menaxhimin efektiv të burimeve ekzistuese energjetike dhe mbrojtjen e mjedisit. Ajo fokusohet në rritjen e sigurisë së furnizimit sipas standardeve Evropiane dhe diversifikimin e burimeve energjetike. Kjo Strategji synon stimulimin e përdorimit racional të energjisë dhe rritjen e efikasitetit së përdorimit të saj, shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, futjen e teknologjive të reja që nuk e dëmtojnë në mënyrë të pariparueshme mjedisin, duke respektuar kështu zbatimin e standardeve mjedisore të pranuarra ndërkombëtare.

Kjo Strategji përfshinë një periudhë kohore 10-vjeçare, duke përbërë një dokument të qartë, që është zhvilluar duke u bazuar në dokumentet dhe studimet paraprake relevante. Masat për realizimin e strategjisë së rishikuar përfshijnë periudhën afatshkurtër trevjeçare 2009-2011, afatmesme deri më 2015, dhe afatgjate deri në vitin 2018. Synimet dhe masat e parashikuara në këtë dokument përbëjnë një vizion të qartë për disa aspekte kyçe me interes të lartë për zhvillimin e sektorit energjetik gjatë dekadës 2009-2018.

2. Politikat, korniza ligjore dhe institucionet e sektorit energjetik

Hartimi i politikave, organizimi, rregullimi dhe menaxhimi i sektorit energjetik në Republikën e Kosovës bëhet nëpërmjet një pakete ligjesh që janë përgjithësisht në përputhje me *acquis* të Bashkimit Evropian (BE) për energjinë. Ndërsa, institucionet e sektorit përfshijnë ato Qeveritare, rregullatore dhe ndërmarrjet energjetike.

2.1 Politikat energjetike dhe rregullimi ekonomik

Legjislacioni në fuqi përcakton rolet dhe përgjegjësitë për qeverisjen dhe rregullimin e sektorit të energjisë. Kuvendi i Kosovës miraton ligjet. Atij i prezantohen edhe politikat dhe strategjia e energjisë, të cilat propozohen nga Qeveria/MEM, në konsultim me palët e interesuara. Ministria e Energjisë dhe Minierave (MEM) përgatit Programin 3-vjeçar të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë, organizon punën dhe monitoron e raporton për zbatimin e Strategjisë së Energjisë dhe përgatitë rishikimin e saj. MEM është përgjegjëse për krijimin e politikave të energjisë dhe marrjen e vendimeve për sektorin e energjisë, të cilat promovojnë reformat e tregut dhe qeverisjen e mirë. Ndërsa, Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRrE) bën rregullimin ekonomik të sektorit dhe licencimin e operatorëve të tregut të energjisë.

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRrE) rishikon dhe miraton tarifat, si dhe bën monitorimin e tregut të energjisë. ZRrE siguron transparencë dhe përgjegjësi të aktorëve të tregut, dhe nxitë përmirësimin e performancës ekonomike, sociale dhe mjedisore. Është mandati i ZRrE-së të sigurojë që “furnizuesi publik” t’i përmbushë “obligimet për furnizim” me energji të të gjithë konsumatorëve në mënyrë të besueshme dhe me çmime që reflektojnë koston.

Organet tjera të qeverisë, siç janë Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor (MMPH), Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale (MPMS), Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), si dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF) kanë rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen e përgjegjësive sociale, ekonomike dhe mjedisore të industrisë së energjisë.

Republika e Kosovës është pronare e ndërmarrjeve publike (NP) në Kosovë, pra edhe e atyre energjetike, kurse të drejtat pronësore mbi NP-të Qeveria i ushtron nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, në përputhje me Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike.

2.2 Korniza ligjore dhe rregullatore

2.2.1 Korniza ligjore

Ligjet, rregulloret dhe vendimet e mëposhtme të Qeverisë përbëjnë bazën ligjore për organizimin dhe menaxhimin e Sektorit të Energjisë së Kosovës:

- Ligji për Energjinë Nr. 2004/8;
- Ligji për Rregullatorin e Energjisë Nr. 2004/9;
- Ligji për Energjinë Elektrike Nr. 2004/10;
- Ligji për Planifikimin Hapësinor Nr. 2003/4;

- Rregullorja për Minierat dhe Minerale Nr. 2005/3;
- Rregullorja për Komisionin e Pavarur të Minierave dhe Mineraleve Nr. 2005/2, respektivisht Ligji mbi Plotësimin e Rregullores mbi Themelimin e KPMM-së;
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 2003/9;
- Ligji për Tregtinë me Naftë dhe Derivatet e saj Nr. 2004/5;
- Ligji për Veprimtaritë Kërkimore–Shkencore Nr. 2004/42;
- Rregullorja për Alokimet Afatgjata të Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore, të menaxhuara nga komunat në Kosovë Nr. 2005/13;
- Ligji mbi Investimet e Huaja Nr. 02/2005;
- Vendimi i Qeverisë për ristrukturim të KEK sh.a, Nr. 06/2005;
- Vendimi i Qeverisë për shthurje të KEK sh.a, Nr. 04/36, 2008;
- Vendimi i Qeverisë mbi themelimin e Kompanisë për Shpërndarje dhe Furnizim të Energjisë Elektrike Nr. 03/38, 2008; dhe privatizimin e saj përmes tenderit publik Nr. 03/38, 2008 dhe Nr. 08/39;
- Ligji mbi Ndërmarrjet Publike Nr. 03/2008;
- Vendimi i Qeverisë për politikën e pronësisë për NP Qendrore Nr. 11/39 dhe Nr. 13/39;
- Ligji mbi Konkurrencën Nr. 36/2004;
- Vendimi i Qeverisë mbi mundësinë e zhvillimit të projektit energjetik Hydrocentrali Zhur, Nr. 02/40 2008;
- Ligji mbi Shpronësimin;
- Ligji për Ngrohjen Qendrore; dhe
- Ligji për Partneritet Publik-Privat dhe Koncesionet.

Gjithashtu, janë përgatitur edhe draftet e ligjeve:

- Ligji për Efiçencën e Energjisë;
- Ligji mbi Gazin Natyror; dhe
- Ligji për Miniera dhe Minerale.

Ligjet dhe draftligjet e mësipërme, që lidhen direkt me sektorin e energjisë, janë në pajtim me Direktivat Evropiane dhe me Kërkesat e Traktatit për Komunitetin e Energjisë (TKE).

Ligji për Energjinë përcakton që Ministria e Energjisë dhe e Minierave (MEM) duhet të hartojë dhe propozojë Strategjinë e Energjisë, që mbulon periudhën 10-vjeçare. Bazuar në Strategjinë e miratuar të Energjisë, MEM përgatitë Programin e Zbatimit të Strategjisë, për një periudhë kohore së paku 3-vjeçare (që në këtë dokument referohet si “periudha afatshkurtër”).

2.2.2 Kuadri rregullator

Ligji për Rregullatorin e Energjisë Nr. 2004/9 përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për rregullimin ekonomik të aktiviteteve të sektorit të energjisë elektrike, ngrohjes qendrore dhe gazit natyror. ZRrE, si institucion i pavarur, bën rregullimin ekonomik të aktiviteteve në sektorin e energjisë. Kurse, Ligji për Energjinë Elektrike Nr. 2004/10, vendosë kornizën e përgjithshme, sipas të cilës duhet të bëhet reforma dhe menaxhimi i sektorit të energjisë elektrike.

Zyra e Rregullatorit të Energjisë gjatë periudhës 2005-2008 ka përgatitur dhe/ose miratuar të gjitha metodologjitë për tarifën, si dhe kodet dhe procedurat rregullatore më të rëndësishme për funksionimin e sektorëve të energjisë elektrike dhe ngrohjes qendrore. Paketa rregullatore e deritanishme është në përputhje me *acquis* të Bashkësisë Evropiane (BE) dhe obligimeve që rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë (TKE).

Korniza rregullatore e sektorit energjetik të Kosovës synohet të jetë e plotë dhe e qartë, në mënyrë që të arrihet besimi i investitorëve të huaj në të, si dhe që kjo kornizë rregullatore të zbatohet me rigorozitet dhe është e parashikueshme në kuptimin që ajo nuk mund të ndryshohet papritur dhe arbitrarisht në dëm të aktorëve në tregun e energjisë, përfshirë atë publik apo privat. Por, nga ana tjetër, ZRrE në kuadër të kornizës rregullatore, ka për qëllim edhe mbrojtjen me përparësi të interesave të konsumatorëve, duke siguruar kështu një balancë të drejtë midis interesave të konsumatorëve dhe ndërmarrjeve energjetike, qofshin këto publike apo private.

2.3 Institucionet dhe ndërmarrjet energjetike

Institucionet kryesore përfshijnë MEM, ZRrE, dhe Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM). Ndërsa, ndërmarrjet energjetike kryesore janë Operatori i Sistemit, Transmetimit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (KOSTT sh.a.), Korporata Energjetike e Kosovës (KEK sh.a.), dhe ngrohoret e qyteteve.

2.3.1 Institucionet

1. Ministria e Energjisë dhe Minerave (MEM), është themeluar në fund të vitit 2004 përmes Shtojcës XIII të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/15 që ndryshon Rregulloren e UNMIK-ut 2001/19 'mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme për Vetëqeverisje në Kosovë'. MEM është përgjegjës për politikën dhe zhvillimin strategjik të sektorit të energjisë, përgatitjen e programit për zbatimin e strategjisë për energji dhe koordinimin e aktiviteteve për zbatimin e këtyre politikave dhe strategjive. Roli dhe aktivitetet e detajuara të MEM janë të definuara qartë në Ligjin mbi Energjinë Nr. 2004/8 dhe në Shtojcën XIII të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/15.

Misioni, Vizioni dhe synimet strategjike të MEM

I. Deklarata e misionit

Misioni i MEM-it është t'i kontribuojë zhvillimit të standardeve të jetës dhe mirëqenies kombëtare, duke promovuar zhvillimin e qëndrueshëm të industrive energjetike, të mihjeve dhe të mineraleve në Kosovë, duke siguruar eksploitim efikas dhe efektiv të resurseve energjetike dhe minerare.

II. Vizioni

MEM ka adoptuar një vizion strategjik afatgjatë për sektorët e energjisë dhe minierave në Kosovë. MEM është duke zbatuar reforma të orientuara drejt tregut dhe po koordinon ristrukturimin e sektorëve të energjisë dhe minierave, në mënyrë që t'i përgatisë ato për tërheqjen e investimeve shumë të nevojshme private përmes një procesi të hapur, transparent dhe konkurrues për arrijten e partneriteteve publike-private. Zhvillimi i tregut konkurrues i energjisë, në pajtim me *acquis* të BE-së dhe Traktatin për Komunitetin e Energjisë për Evropën Juglindore, përmes të cilit do të mund të ofrohen shërbime energjetike të cilësisë së lartë, me teknologji që nuk dëmtojnë mjedisin dhe me kosto të ulët, paraqet të vetmen rrugë përpara drejt zhvillimit të qëndrueshëm për vendin tonë.

III. Synimet strategjike

- Të zhvillohet dhe implementohet politikë, strategji dhe kornizë ligjore për reformimin dhe ristrukturimin e sektorit të energjisë në pajtueshmëri me *acquis* të BE-së
- Të promovohet dhe përkrahet zhvillimi i një tregu konkurrues energjetik, i cili do të integrohet në tregun e energjisë të BE-së në të ardhmen
- Të promovohet restaurimi i qëndrueshmërisë financiar i ndërmarrjeve energjetike
- Të arrihet siguria në furnizim me energji për konsumatorët me kosto sa më të ulët dhe në mënyrë sa më të padëmshme për mjedisin
- Të inkurajohet hulumtimi dhe zhvillimi i rezervave të reja të linjtit dhe mineraleve të tjera
- Të zhvillohen dhe implementohen politika, strategjia dhe korniza ligjore për sektorin minerar
- Të promovohen investimet private në sektorët e energjisë dhe minierave në formë të partneriteteve publike-private

2. Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRrE), është themeluar në vitin 2004 përmes Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 2004/9, si autoritet i pavarur rregullator për sektorët e energjisë elektrike, ngrohjes qendrore dhe gazit natyror. ZRRrE është së pari përgjegjëse për miratimin e tarifave, realizimin e procesit të zhvillimit të kapaciteteve të reja gjeneruese, monitorimin e tregjeve të energjisë dhe përgatitjen dhe/ose miratimin e rregulloreve për sektorin e energjisë, përfshirë kodet dhe rregullat përkatëse. ZRRrE siguron transparencën dhe përgjegjshmërinë e aktorëve në tregun e energjisë dhe angazhohet krahas tyre për të përmirësuar performancën e tyre ekonomike, sociale dhe mjedisore. Gjithashtu, është nën mandatin e ZRRrE-së që të sigurojë që furnizuesit publik të përmbushin “obligimet për të furnizuar” me energji elektrike amvisëritë dhe bizneset në mënyrë të qëndrueshme dhe me çmime ekonomike – Obligimi për të Ofruar Shërbime Publike.

ZRrE ka zhvilluar një kornizë rregullatore për një treg transparent dhe jodiskriminues të energjisë, përfshirë metodologjinë e tarifave, procedurat për mbrojtjen e konsumatorëve, si dhe ka shqyrtuar dhe miratuar një sërë kodesh dhe rregullash të rëndësishme/vevojshme. Ajo ka lëshuar licenca për të gjitha ndërmarrjet energjetike në Kosovë dhe ka miratuar të hyrat dhe tarifën e lejuara për KEK sh.a. dhe KOSTT sh.a., si dhe për ndërmarrjet e ngrohjes qendrore. Rishqyrtimi i tretë i tarifave/çmimeve të energjisë elektrike të KEK sh.a. dhe KOSTT sh.a. për vitin 2009 u finalizua në maj të vitit 2009. ZRrE është në proces të miratimit të 'feed-in' tarifave për energji nga burimet e ripërtëritshme. Deri tani janë miratuar 'feed-in' tarifat për hidrocentralet e vogla dhe fermet e erës.

3. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), është themeluar në janar të vitit 2005 përmes Rregullores së UNMIK-ut 2005/2 – dhe përfaqëson 'Agjencinë e Pavarur Rregullatore' për sektorin e minierave. KPMM është përgjegjës për lëshimin e licencave për hulumtim dhe shfrytëzim të mineraleve dhe jomineraleve, përfshirë linjtin. Ai, gjithashtu është përgjegjës për mbikëqyrjen e licencave të lëshuara.

4. Organet tjera qeveritare, siç janë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, luajnë rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen e komponentëve tjerë socialë, ekonomikë dhe mjedisorë të industrisë së energjisë elektrike. MEF luan rol të rëndësishëm në privatizimin dhe mbikëqyrjen e kompanive publike.

2.3.2 Ndërmarrjet energjetike

1. Korporata Energjetike e Kosovës (KEK sh.a.), është kompania publike e Kosovës, e cila ka në pronë dhe operon me asetë të gjenerimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike dhe të mihjes së linjtit. Performanca operative dhe financiare e saj gjatë periudhës 1999-2004 ishte negative. KEK sh.a. është menaxhuar nga kompani të huaja që nga shtatori i vitit 2002 deri në Dhjetor 2006. Nga Janari i vitit 2007 është vazhduar me asistencë teknike, po ashtu nga një kompani e huaj. Megjithatë, këto ndihma teknike, së bashku me menaxhmentin vendor, deri në fund të vitit 2008 nuk kanë arritur ta bëjnë KEK-un financiarisht të qëndrueshëm. Dështimi në kontrollin dhe menaxhimin e konsumit të energjisë elektrike është shkaktari kryesor i problemeve financiare të KEK sh.a.

2. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut të Energjisë Elektrike (KOSTT sh.a.), u themelua në vitin 2006, në pajtim me dispozitat mbi shthurjen/ristrukturimin e sektorit elektroenergjetik, të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe kushtet e Traktatit për Komunitetin e Energjisë. KOSTT sh.a. është kompani në pronë publike, përgjegjëse për operimin, planifikimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit të bartjes dhe interkonjeksionet e tij me sistemet energjetike fqinje, në mënyrë që ta ruajë sigurinë për furnizim në Kosovë. Përveç kësaj, KOSTT sh.a. është përgjegjës për funksionimin dhe operimin e tregut me shumicë të energjisë elektrike në Kosovë. Burimi kryesor i të ardhurave për KOSTT sh.a. vjen në formën e pagesave për bartje që paguhen nga KEK sh.a., sipas përcaktimit të ZRrE-së.

3. Kompanitë e ngrohjes qendrore ekzistojnë në Prishtinë, Gjakovë dhe Mitrovicë. Ato, së bashku gjenerojnë nxehtësi për ngrohje në lartësi prej 130 GWh_{th}/vit, apo rreth 3% të kërkesës së Kosovës për ngrohje. Stabilimentet e ngrohjes qendrore furnizojnë pjesët më të dendura të qyteteve dhe objekteve publike, siç janë spitalet, shkollat dhe ndërtesat administrative¹. Sistemi i ngrohtores së Prishtinës përbën më shumë se 80% të tërë kapacitetit të ngrohtores në Kosovë. Kjo ngrohore udhëhiqet nga Termokos sh.a., një ndërmarrje lokale që ofron shërbime publike. Të tri këto sisteme

¹ Të gjitha sistemet e ngrohjes qendrore ofrojnë vetëm ngrohje hapësirash dhe jo edhe ujë të ngrohtë për nevoja familjare. Si rezultat, të gjitha këto rrjete funksionojnë vetëm gjatë sezonit të ngrohjes.

vuajnë nga humbje shumë të mëdha komerciale të shkaktuara nga mospagesa e faturave. Të gjitha sistemet e ngrohjes qendrore ofrojnë vetëm ngrohje hapësirash dhe jo edhe ujë të ngrohtë për nevoja familjare. Si rezultat, të gjitha këto rrjete funksionojnë vetëm gjatë sezonit të ngrohjes. Kompanitë e ngrohjes qendrore janë në pronësi të pushtetit komunal përkatës.

3. Analiza e gjendjes dhe progresi në sektor gjatë periudhës 2005-2008

3.1 Prodhimi i linjtit dhe energjia elektrike

Sektori i energjisë elektrike në Kosovë është i dominuar nga KEK sh.a., një sistem i integruar vertikalisht, me përjashtim të sistemit të bartjes që nuk është pjesë e KEK sh.a. KEK sh.a. përbëhet nga dy miniera të linjtit në Bardh dhe Mirash, nga dy termocentrale me djegie të linjtit 'Kosova A' dhe 'Kosova B', me kapacitet të përgjithshëm efektiv prej 740-840 MW (me një kapacitet të instaluar prej 1478 MW), nga rrjeti i shpërndarjes, dhe nga furnizimi.

3.1.1 Prodhimi i linjtit

Në planin afatgjatë linjiti do të mbetet karburanti kryesorë për prodhimin e energjisë elektrike në Kosovë.

Rezervat e linjtit në Kosovë gjenden në dy basenet më të mëdha, të emëtuara "Kosova" dhe "Dukagjini". Rezervat gjeologjike të linjtit janë vlerësuar të jenë rreth 12.5 miliardë tonë (këtu përfshihen të gjitha kategoritë e rezervave). Tabela 1 paraqet përmbledhje të rezervave të linjtit sipas lokacioneve².

Tabela 1: Rezervat e linjtit sipas lokacioneve

Baseni	Sipërfaqja [km ²]	Rezervat [Milion Ton]			
		Të huluntuara		Të shfrytëzueshme	
		T	t _{ce}	T	t _{ce}
Kosova	274	10,091	2,957	8,772	2,521
Dukagjini	49	2,244.8	782	2,047.7	464
Drenicës-Fusha e Skenderajt	5.1	106,6	22	73.2	19
Totali		12,442.4	3,761	10,892.9	3,004

Linjiti i Kosovës ka përmbajtje të ulët të sulfurit dhe koncentrim relativisht të mirë të gëlqeres (kalcium oksidi) për absorbimin e një pjese të sulfurit gjatë procesit të djegies. Raporti në mes të djerrinës dhe linjtit është shumë i favorshëm, fakt ky që i bën këto miniera me mihje sipërfaqësore konkurrenë dhe tërheqëse për shfrytëzim. Figura 1 paraqet vendndodhjen e lokacioneve të zonave të shfrytëzimit në Basenin Kosova.

² Institutit Inkos – "Studimi për Vlerësimin e huluntimeve dhe rezervave gjeologjike të qymyrit në Kosovë", Baseni i Kosovës, Prishtinë 2007, fq. 81 dhe Baseni i Dukagjinit, Drenicës dhe Basenet tjera, Prishtinë 2007, fq.56, dhe fq. 24.

Figura 1: Lokacioni i zonave të eksploatimit në basenin “Kosova”



Bazuar në sasinë dhe kushtet e eksploatimit, për basenin “Kosova” është përcaktuar kjo radhitje e prioritetit për zhvillim:

Prioriteti 1.

Zona C (“Sibovci” apo “Mihja e Re”) dhe Zona D (Dardhishtë) ofrojnë kushtet më të volitshme për eksploatim sipërfaqësor.

Prioriteti 2.

Zona G dhe I premtjnë kushtet më të volitshme për shfrytëzim në të ardhmen nga pikëpamja e sasisë dhe përpjesës djerrinë : qymyr. Këto dy zona ofrojnë resurse të mjaftueshme për të justifikuar ndërtimin e termocentraleve me mihjet përkatëse.

Prioriteti 3.

Në krahasim me zona të tjera, kushtet e eksploatimit në Zonën E janë degraduar si rezultat i palosjeve të jashtme të djerrinës. Resurset në Zonat F, H, J dhe K janë reduktuar si shkak i përpjesës djerrinë:qymyr në krahasim me zonat e paraqitura nën Prioritetin 1 dhe 2. Me përjashtim të Zonës J, të gjitha Zonat tjera janë të reduktuar si pasojë e popullatës së dendur.

Në bazë të analizave të deritanishme, hapja e minierës së re të linjtit në Zonën C “Sibovc” apo “Mihja e Re” nga pikëpamja ekonomike, sociale dhe mjedisore është më e pranueshme. Për këtë, fillimi i hapjes dhe futjes në prodhim të kësaj mihje ka përparësi të konsiderueshme.

Në basenin e linjtit të Dukagjinit ekzistojnë rezerva gjeologjike prej 2.244 miliardë tonë linjit. Këtu mund të planifikohet hapja e minierave të reja, si dhe të humtohen mundësitë e ndërtimit të kapaciteteve të reja elektrogjeneruese. Për këtë nevojiten studimet shtesë gjatë periudhës që mbulon kjo Strategji. Aktualisht janë identifikuar dy fusha me potencial të zhvillimit. Tabela 2 përmbledh të dhëna për basenin e Dukagjinit.

Tabela 2: Të dhëna për basenin e linjitet të Dukagjinit

<i>Baseni i Dukagjinit</i>		<i>Zona 1 Tugepi</i>	<i>Zona 2 Shtupeli</i>
1	Sipërfaqja totale [km ²]	6	11
2	Sipërfaqja e vlerësuar e eksploatimit [km ²]	6	11
3	Trashësia e vlerësuar mesatare e djerrinës [m]	60	110
4	Trashësia e vlerësuar mesatare e qymyrit [m]	35	35
5	Përpjesa e vlerësuar mesatare [m:m]	1.7:1	3.1:1
6	Rezervat gjeologjike [Mt]	240	440
7	Rezervat e eksploatueshme [Mt]	170 (~70%)	310 (~70%)
8	Vlera mesatare kalorike [kJ/kg]	8,400	8,700
9	Madhësia e termocentralit [MW]	450	840

Bazuar në informatat ekzistuese, rezervat e linjitet në basenin e Drenicës nuk premtojnë shfrytëzimin e tyre për nevoja elektro-energetike, por këto duhet të vlerësohen nga aspekti i shfrytëzimit, kryesisht për nevojat e industrisë. Tabela 3 përmbledh të dhëna për basenin e Drenicës.

Tabela 3: Të dhëna për basenin e linjitet të Drenicës

<i>Baseni i Drenicës</i>		<i>Zona I Skenderaj</i>	<i>Zona II Drenas</i>
1	Sipërfaqja totale [km ²]		
2	Sipërfaqja e vlerësuar e eksploatimit [km ²]		
3	Trashësia e vlerësuar mesatare e djerrinës [m]		
4	Trashësia e vlerësuar mesatare e qymyrit [m]	200	10
5	Perpjësia e vlerësuar mesatare [m:m]		
6	Rezervat gjeologjike [Mt]	70	25
7	Rezervat e eksploatueshme [Mt]		
8	Vlera mesatare kalorike [kJ/kg]	7,300	7,300
9	Madhësia e termocentralit [MW]		

Mihjet ekzistuese dhe vazhdueshmëria e furnizimit me linjit të kapaciteteve elektro-gjeneruese ekzistuese

Spektori i mihjeve të linjitet siç e njohim ne sot, është rezultat i investimeve kapitale të kryera para disa dekadash (1962 – 1984). Ato investime përfshinin zhvillimin e minierave të Bardhit dhe Mirashit, me rezerva totale të thëngjillit prej 300 milionë tonë dhe ndërtimin e


termocentralit ‘Kosova A’, e më vonë ‘Kosova B’, me kapacitet të përgjithshëm të instaluar prej 1478 MW.

Ka qenë fakt i njohur që rezervat e dedikuara të thëngjillit të minierave Bardh dhe Mirash janë të pamjaftueshme për t’i furnizuar të dy termocentralet deri në fund të jetëgjatësisë së tyre operationale; prandaj, ishte planifikuar që një minierë e re të sigurojë furnizimin për TC ‘Kosova A’ dhe TC ‘Kosova B’ deri në fund të jetës së tyre operationale, përfshirë edhe zgjerimet e mundshme të kapaciteteve të prodhimit.

Gjatë viteve të 90-ta, për shkak të situatës politike dhe ekonomike, sektori i mihjeve ka pësuar stagnim, degradim dhe moshapjen e mihjes së re.

Bazuar në projektet për zhvillimin e Mihjes së Re, me synim të furnizimit me kontinuitet të TC Kosova A dhe TC Kosova B, KEK sh.a. është duke bërë përpjekje për hapjen e mihjes së re në Sibovc Jugperëndim, ku prodhimi i linjitetit pritet të fillojë që nga viti 2010. Ndërkohë, për t’i zburuar efektet e afatit të shkurtë për zhvillim normal të mihjes së re, KEK-u ka zgjeruar aktivitetet edhe në pjesën lindore të Mirashit, apo Sektori i Sitnicës, ku rezervat e shfrytëzueshme janë afër 10 milionë tonë. Figura 2 tregon lokacionet e mihjeve ekzistuese dhe asaj të re në Sibovc.

Figura 2: Lokacionet e mihjeve ekzistuese dhe asaj të re në Sibovc



Me fillimin e ndërtimit të termocentralit ‘Kosova e Re’ do të kërkohet një rritje e kapacitetit prodhues të linjitetit. Për këtë rritje të kapacitetit planifikohet shfrytëzimi i fushës të Sibovcit “Mihja e Re”, e cila ka rezerva të mjaftueshme për të furnizuar objektet ekzistuese deri në përfundim të jetëgjatësisë së tyre, si dhe për furnizimin me linjit të termocentralit Kosova e Re për 40 vitet e jetës operationale të tij.

Në kuadër të zhvillimeve të mihjes së re është me rëndësi të veçantë që në projekt të përfshihet edhe rikultivimi i pjesës së shfrytëzuar.

3.1.2 Gjenerimi i energjisë elektrike

Asetet e gjenerimit, shpërndarjes dhe mihjeve të linjitet të sektorit energjetik operohen nga KEK sh.a., ndërmarrje publike. KEK sh.a. vuan nga probleme të mëdha financiare, teknike, të personelit (numrit të madh të punonjësve) dhe menaxheriale. Pjesa më e madhe e kapaciteteve gjeneruese të Kosovës janë në dy termo-elektro-centralet – ‘Kosova A’ dhe ‘Kosova B’.³

Kapacitetet e instaluara teknike të dy termocentraleve, me gjithë vjetërsinë e tyre prej 24-46 vitesh, do të mund t’i përbushnin kërkesat e konsumit për energji elektrike bazike, por, për shkak të degradimit dhe mosinvestimit në sektorin e linjitet dhe të termocentraleve në Kosovë gjatë periudhës 1990-1999, mirëmbajtjes së mangët dhe mosrehabilitimit të domosdoshëm dhe në kohë, gatishmëria teknike dhe performancat e njësisve gjeneruese, me gjithë ngritjen e vazhdueshme të evidentuar deri në vitin 2008, janë nën nivelin e parametrave të instaluar. Tabela 4 përmbledh të dhëna për kapacitetet termo-elektro-gjeneruese ekzistuese në Kosovë.

Tabela 4: Kapacitetet termo-elektro-gjeneruese ekzistuese në Kosovë

Bloku i termocentralit	Kapaciteti i bllokut të termocentralit (MW)			Lloji i karburantit	Viti i fillimit të punës (vjetërsia)
		Prag	Neto në Dispozicion		
TC ‘Kosova A’					
Bloku A1	65	58	0	Linjit/Naftë	1962 (46)
Bloku A2	125	113	0	Linjit/Naftë	1964 (44)
Bloku A3	200	182	110-120	Linjit/Naftë	1970 (38)
Bloku A4	200	182	110-120	Linjit/Naftë	1971 (37)
Bloku A5	210	187	125-130	Linjit/Naftë	1975 (33)
TC ‘Kosova B’					
Bloku B1	339	309	240–260	Linjit/Mazut	1983 (25)
Bloku B2	339	309	260 – 280	Linjit/Mazut	1984 (24)

Burimi: KEK sba (tetor 2008)

Centrali i vetëm i rëndësishëm jashtë KEK sh.a. është hidrocentrali i Ujmanit/Gazivodës (2 X 17.5 MW = 35 MW), i cili administrohet nga Kompania Publike Hidrosistemi Ibër-Lepenc (ILE).

Bloqet A1 dhe A2 janë jashtë funksionit dhe nuk parashikohet riaktivizimi i tyre. Ato do të dekomisionohen. Riparime emergjente dhe kapitale janë bërë në blloqet A3 në vitin 2006, A4 në 2007 dhe A5 në vitin 2008.

Nga shtatori i vitit 2007 në të dy blloqet e TC ‘Kosova B’ është zvogëluar fuqia aktive për shkak të dëmtimeve në rotorët e trysnisë së ultë të 2 turbinave. Për këtë arsye fuqia maksimale aktuale në

³ Kosova ka në operim vetëm rreth 43MW kapacitete të instaluara në hidrocentrale, edhe pse posedon më shumë hidropotenciale.

pragun e B1 është 240 MW, ndërsa të B2, 280 MW. Kjo gjendje pritet të zgjasë deri në vitin 2010, kur do të instalohen rotorët e rinj dhe do të rritet fuqia e të dy blloqeve.

Kapacitetet aktuale prodhuese në TC 'Kosova A' janë: A3 - 115 MW, A4 - 115 MW dhe A5 - 125 MW. Me gjithë riparimet kapitale në këto tri blloqe, ato edhe më tutje janë të pasigurta në operim. Tri njësi të TC 'Kosova A' dhe 2 njësi të TC 'Kosova B' japin një kapacitet prej rreth 870 MW. Disponueshmëria e njësisve në TC 'Kosova A' nuk është në nivelin e mjaftueshëm, ndërsa në TC 'Kosova B' gjendja është më e mirë. Prodhimi hidrik sigurohet kryesisht nga hidrocentrali i Ujmanit me kapacitet 35 MW dhe HC Lumbardhi me kapacitet 8.3 MW. Pra, kapacitetet prodhuese të disponueshme sillen rreth 900 MW.

Situata e theksuar më lart, e shoqëruar me mungesë të mjeteve financiare për remonte dhe rivitalizime, si dhe humbjet e mëdha teknike dhe sidomos ato komerciale, bashkë me nivelin e ulët të inkasimit, e kanë sjellë KEK sh.a. në situatë të vështirë financiare. Prandaj, KEK sh.a. duhet të vazhdojë të mbështetet nga Qeveria me veprime institucionale për rritjen e performancës financiare dhe për investimet e domosdoshme kapitale, si dhe për financimin e një pjesë të importit të energjisë elektrike. Këto janë parakushte për stabilizim të funksionimit të sistemit të energjisë elektrike në Kosovë, si dhe për krijimin e njësisve stabile e të ndara në entitete biznesore.

3.1.3 Bartja e energjisë elektrike

Sistemi i bartjes menaxhohet nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT sh.a.). Kosova është palë kontraktuese e Komunitetit rajonal të Energjisë dhe është e lidhur në sistemin rajonal përmes interkonjeksioneve me Serbinë, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Shqipërinë. Kosova, gjithashtu gjendet në qendër të trajektoreve veri-jug të transmetimit për tregun e Evropës Juglindore (EJL), dhe është me rëndësi për rrjedhat e energjisë elektrike për dhe nga Serbia, Maqedonia dhe Greqia. Rënia e cilitdo segment të kësaj trajektoreje të transmetimit do të kishte ndikim negativ në rrjedhat e energjisë në rajonin jugor të EJL. KOSTT sh.a. vuan si rrjedhojë e mosinvestimit për shkak të mungesës së fondeve në periudhat e kaluara, dhe rrjedhimisht ka pasur kapacitete të limituara të bartjes, të cilat kanë qenë nën nivelin e kërkesës së pikut gjatë periudhave të dimrit në Kosovë.

Gjatësia e tërësishme e linjave të bartjes (400 kV, 220 kV dhe 110 kV) është 1,187 km. Pjesa më e madhe e linjave të bartjes janë kthyer në funksionim, pas riparimeve të pasluftës, derisa disa nënstacione janë ende në gjendje të keqe teknike. Rrjeti i bartjes prej 400 kV dhe 220 kV të Kosovës është pjesë integrale e sistemit të interkonjeksionit të rajonit.

Sistemi i bartjes së energjisë elektrike është i ndërlidhur me të gjitha sistemet fqinje në nivelin 400 kV, përveç me Shqipërinë, ku lidhja është vetëm në nivelin 220 kV. Aktivitetet për fillimin e ndërtimit të linjës së re të tensionit prej 400 kV me Shqipërinë, janë duke u zhvilluar dhe ndërtimi i kësaj linje pritet të fillojë gjatë vitit 2010/2011. Kjo linjë në periudhën afatmesme dhe afatgjatë do t'i lehtësojë këmbimet e energjisë elektrike dhe do të mundësojë optimizimin e dy sistemeve komplementare, atij termik të Kosovës me sistemin hidrik të Shqipërisë. Linja 400 kV, po ashtu ka rëndësi të madhe për shkëmbimet elektroenergjetike në rajon. Figura 3 paraqet ndërlidhjen e sistemit të bartjes të Kosovës me ato të vendeve përreth.

Figura 3: Lidhja e sistemit të bartjes të Kosovës me vendet përreth



3.1.4 Shpërndarja e energjisë elektrike

Për mungesë të zhvillimit ende të pamjaftueshëm, gjendja në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike është e rëndë, gjë që tregohet në vështirësitë që hasen për t'i përballuar kërkesat aktuale të konsumit. Në përgjithësi, si linjat, ashtu edhe trafo-stacionet gjatë dimrit janë të mbingarkuara dhe kjo ka pasojë humbje të larta teknike që në vitin 2006 kanë qenë 17.93% në vitin 2007 17.19%, kurse në vitin 2008 rreth 17.1%.

Duhet theksuar faktin se janë duke u zhvilluar një numër projektesh si në rrjetin e bartjes, ashtu edhe në atë të shpërndarjes, që do të kontribuojnë në zvogëlimin e humbjeve teknike, gjë që është orientim strategjik i Qeverisë.

3.2 Furnizimi, faturimi dhe inkasimi i energjisë elektrike


Humbjet komerciale janë ende të larta me një trend të ngadalshëm zvogëlimi sipas viteve, ku gjatë vitit 2006 kanë qenë 29.18%, në vitin 2007 30.31% dhe në vitin 2008 rreth 25.8%.

Në vitin 2007, nga Konsumi Bruto prej 4,582 GWh energji, u faturuan 2,425 GWh (53%), ndërsa nga energjia e faturuar u inkasua 1,843 GWh (76%). Në vitin 2007, humbjet komerciale ishin 1,333 GWh, ekuivalent me tërë prodhimin nga 'Kosova A', tërë prodhimin nga hidrocentralet plus

një pjesë e prodhimit të ‘Kosovës B’. Sipas çmimeve të vitit 2007, kjo paraqet një humbje vjetore në të hyra prej €99 milionë për KEK sh.a., vlerë kjo që do t’i mundësonte atij t’i mbulojë të gjitha shpenzimet e veta operative dhe importet e energjisë, si dhe një pjesë të investimeve kapitale që janë bërë gjatë kësaj periudhe.

Nëse do të eliminohehin vjedhja dhe mospagimi, kërkesa do të mund të zbritej për rreth 15% dhe të ardhurat do të ishin në dispozicion për mirëmbajtje, investime dhe import të rrymës, nëse përsëri do të paraqitej nevoja për këtë. Figura 4 paraqet grafikisht bilancin elektro-energetik për vitin 2008.

Figura 4: Paraqitje grafike e bilancit elektro-energetik për vitin 2008



3.3 Ngrohja e përqendruar

Sistemet e ngrohjes së përqendruar ekzistojnë vetëm në Prishtinë, Gjakovë dhe Mitrovicë. Këto sisteme janë të shtrira për aq sa përbushin vetëm 3% të kërkesave për ngrohje të hapësirave. Teknologjia e ngrohjes bazohet në mazut dhe në naftën për djegie. Edhe ky sektor ballafaqohet me teknologji të vjetruar, ndikim negativ në mjedis, si dhe me nivel të ulët të faturimit dhe arkëtimit të energjisë së shpenzuar. Nevoja për zhvillimin e tregut të ngrohjes është evidentuar në rezultatet e Studimit të Tregut të Ngrohjes (ELC, World Bank Study, 2007). Zhvillimi i këtij tregu do të mbështetet me masa nxitëse të Qeverisë. Ligji i Ndërmarrjeve Publike i ka vënë këto ndërmarrje në administrimin komunal.

Edhe sektori i ngrohjes së përqendruar, sidomos ai ekzistues në Prishtinë - Termokosi, ballafaqohet me vështirësi financiare dhe nuk ka rezultuar deri tani të jetë i vetqëndrueshëm pa mbështetje nga Buxheti i Kosovës. Humbjet komerciale janë të larta për shkak edhe të menaxhimit të dobët, ndërkohë që tarifat ekzistuese, edhe pse jo shumë të ulëta, nuk mbulojnë plotësisht koston e furnizimit.

3.4 Gazi natyror dhe derivatet e naftës

Ka ekzistuar një gazsjellës nëntokësor që ka furnizuar Hekuranën e Shkupit, Feroniklin, Trepçën, Lamkos-in dhe Termokosin me gaz nga procesi i gazifikimit të linjtit brenda ish-Elektroekonomisë së Kosovës. Sipas Studimit ESTAP I, linja ekzistuese nuk mund të ketë kosto të arsyeshme të riparimit, prandaj, rekomandohet linja e re e tubacioneve me parametra të tjerë operacionalë. Megjithatë, është pozitiv fakti që Qeveria posedon të drejtën pronësore të trasesë Hani i Elezit – Mitrovicë, dhe kjo do të konsiderohet gjatë rishqyrtimit të përdorimit të këtij aseti.

Në fushën e derivateve të naftës ekziston një furnizim relativisht i kënaqshëm i tregut nga sektori privat. Mirëpo, duhet bërë më shumë në sigurimin e rezervave të detyrueshme për situata të krizave. Një tjetër sfidë është rritja e sigurisë në transportim, deponim dhe distribuim të karburanteve.

3.5 Eficienca e energjisë dhe burimet e ripërtëritshme

Neni 10 i Ligjit mbi Energjinë 2004/8 parashtron kornizën për implementimin e parimeve të eficiencës së energjisë dhe shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë në Kosovë. Në veçanti, paragrafi (a) i nenit 10 lidhet me përgatitjen e një plani të implementimit për ta promovuar përdorimin eficient të energjisë dhe burimeve të ripërtëritshme. Masat për eficiencë të energjisë dhe menaxhim të kërkesës janë të rëndësishme kritike për zvogëlimin e normës së lartë të rritjes së kërkesës vjetore për energji, e cila shfaqet kryesisht për shkak të përdorimit të energjisë elektrike për ngrohje.

Në fillim të vitit 2007, MEM lansoi Programin për Eficiencë të Energjisë dhe Burime të Ripërtëritshme të Energjisë për vitet 2007-2009. Qëllimi i programit është që të parashtrrojë një sërë veprimesh gjithëpërfshirëse që do të kryhen në Kosovë, të cilat do të rezultojnë me eficiencë të shtuar të energjisë në të gjithë sektorët. Megjithatë, implementimi i këtij programi has vështirësi financiare dhe të mungesës së zbatimit të ligjit.

Grupi Punues (Task Forca) për Eficiencë të Energjisë, i themeluar nën kornizën e TKE-së në tetor të vitit 2007, ka vlerësuar statusin aktual të eficiencës së energjisë dhe ka udhëzuar mënyrën e hartimit të planeve për promovimin e saj nga palët kontraktuese të TKE-së. Në fund të nëntorit të vitit 2007, MEM përpiloi një raport gjithëpërfshirës mbi statusin e eficiencës së energjisë në Kosovë dhe të njëjtin raport e azhurnoi në Maj të vitit 2008⁴.

Sa i përket zhvillimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë, MEM në fund të vitit 2006 ka finalizuar një studim të parafizibilitetit për disa hidrocentrale të vogla. MEM ka në konsiderim edhe hulumtimin e tërë potencialit ujor për ndërtimin e hidrocentraleve të vogla në rrjedhat e lumenjve deri tani të pahulumtuar. Politika e Qeverisë së Kosovës është që të zhvillojë hidrocentrale të reja me investimet private, duke e dhënë me koncesion të drejtën e shfrytëzimit të ujit për gjenerim të energjisë elektrike⁵. ZRrE ka hartuar Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese. MEM ka iniciuar procesin dhe Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka aprovuar tarifën nxitëse (feed-in tarifën) për gjenerimin nga hidrocentralët e vogla dhe fermat e erës. MEM, me burime financiare nga Buxheti i Kosovës, gjatë vitit 2008 ka zbatuar në ndërtesa publike disa projekte demonstruese për ngrohje të ujit përmes energjisë diellore.

⁴ Me ndihmë nga AER, MEM ka hartuar raportin "Situa të Kosovës për Eficiencë të Energjisë në kuadër të Komunitetit të Energjisë". Ky raport shpjegon statusin e zhvillimit të kornizës ligjore dhe rregullative, strukturën institucionale dhe projektet e programeve në zbatim dhe planifikim.

⁵ Vendimi "Mbi promovimin e masave nxitëse për gjenerimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe bashkëprodhimin në Kosovë për periudhën 2007-2013" siguron masat për një proces të hapur, transparent dhe konkurrues për zhvillimin e hidrocentraleve të vogla.

Nën kuadër të PATEL, BB ka financuar azhurnimin e Studimit ekzistues të Fizibilitetit për Hidrocentralin e Zhurit. Në përputhje me politikat e BB është hartuar edhe Studimi i Vlerësimit Preliminar të Ndikimit në Mjedis dhe Ndikimet Sociale. Rezultatet e këtyre Studimeve tregojnë se Projekti i HC Zhur është i zbatueshëm.

Gjithashtu, planifikohet hartimi i Studimit të parafizibilitetit për shndërrimin e HC Ujman në hidrocentral reverzibil. Banka Botërore, gjithashtu ka iniciuar përkrahjen qeverisë në themelimin e kornizës rregullative për zhvillimin e burimeve të energjisë së ripërtëritshme, përfshirë përpilimin e propozimeve për mekanizmat përkrahës për burimet e ripërtëritshme të energjisë.

Nën kuadër të TKE, Kosova ka zhvilluar caqet indikative vjetore edhe 10-vjeçare për burime të ripërtëritshme. Ajo, gjithashtu ka përpiluar planin e detajuar për implementimin e (i) Direktivës 2001/77/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 27 shtator 2001 mbi promovimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burime të ripërtëritshme të energjisë në tregun e brendshëm të energjisë elektrike, dhe (ii) Direktivës 2003/30/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 8 maj 2003 mbi promovimin e shfrytëzimit të bio-karburanteve dhe karburanteve tjera të ripërtëritshme për transport.

MEM ka hartuar dhe po zbaton disa projekte në kuadër të Programit trevjeçar të Kosovës për Eficiencë të Energjisë dhe Burime të Ripërtëritshme Energjetike (BRE) 2006-2008.

MEM ka bërë përpjekje të vazhdueshme në këtë drejtim, dhe si pasojë e mungesës të një ligji për Eficiencën e Energjisë (EE), MEM ka promovuar nxjerrjen e disa akteve nënligjore që rregullojnë çështje të caktuara për fushat e EE dhe BRE. Janë miratuar aktet nënligjore: (i) Udhëzimi Administrativ për Etiketimin e Pajisjeve elektrike-shtëpiake, (ii) Udhëzimi Administrativ për Auditimin e Energjisë, (iii) Udhëzimi Administrativ për Shfrytëzimin e Energjisë nga Konsumatorët Përfundimtarë, (iv) Udhëzimi Administrativ për Caqet Indikative Njëvjeçare dhe Dhjetëvjeçare për BRE, dhe (v) Vendimi Qeveritar për Masat Nxitëse për Zhvillimin e BRE. Po ashtu, janë hartuar (por nuk janë miratuar akoma) edhe draft Udhëzimet Administrative për: (i) Bio-karburantet, dhe (ii) Zyrat Komunale të Energjisë.

Gjatë vitit 2006 është bërë studimi i parafizibilitetit për hidro-potencialet energjetike, kurse gjatë vitit 2008 janë vlerësuar potencialet e energjisë diellore, të erës, biomasës dhe ujërave gjeotermike. Ndërkohë, janë zhvilluar edhe projektet: Fushata e ndërgjegjësimit publik për Eficiencën e Energjisë (EE) në shkollat fillore e të mesme të vendit (2006), Organizimi i seminarit për rolin e EE dhe BRE (2005), Organizimi i kursit për Auditim të Energjisë, Studimi mbi Masat e EE në disa objekte publike (2008), Hartimi i procedurës tenderuese për ndërtimin e hidrocentraleve të vogla (2008), si dhe Promovimi i Energjisë Diellore (vendosja e paneleve diellore në disa Klinika të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe në Qendrën e Studentëve në Prishtinë (2008).

Kosova, si anëtare e TKE, është edhe anëtare e Task Force për Eficiencë të Energjisë, dhe pritet që gjatë vitit 2009 ta finalizojë edhe Planin Nacional të Veprimit për Eficiencë të Energjisë. Në këtë plan përcaktohen caqet nacionale për kursimin e energjisë për periudhën 2009-2011.

3.6 Mbrojtja e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit është në mandatin ligjor të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH). Megjithatë, kjo Strategji duhet të merret me mjedisin nga këndvështrimi i sektorit të energjisë. Emetimi aktual i gazrave, pluhurit dhe shkarkimi i ujërave të ndotura nga termocentralët ekzistues, për shkaqe të teknologjive të vjetruara dhe funksionimit të papërshtatshëm të pajisjeve

dhe stabilimenteve, janë mbi nivelet e lejuara me Direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian (BE-së).

Raporti Final i Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe Social (VSMS)⁶, është përfunduar në nëntor të vitit 2008, pas konsultimeve me ekspertët dhe me publikun. Në këtë raport identifikohen në nivel strategjik çështjet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale të ndërlidhura me gjendjen ekzistuese dhe me zhvillimin e sektorit të energjisë dhe linjitet në rajonin e gjerë të Minierës së Re të planifikuar. Raporti i VSMS-së hulumton dhe shqyrton rezultatet e zgjidhjeve strategjike që Qeveria e Kosovës dhe investitori në të ardhmen duhet të ndërmarrin në kontekst të përmirësimit të gjendjes dhe të zhvillimit të Projektit ‘Kosova e Re’. Opsionet më të rëndësishme të zhvillimit nga perspektiva mjedisore dhe sociale janë analizuar dhe ato kanë të bëjnë me lokacionin e ndërtimit të TC ‘Kosova e Re’, skemën dhe dinamikën e zhvillimit të minierës, madhësinë e blloqeve të TC-së, zgjedhjen e teknologjisë dhe ritmin e zhvillimit të projektit në raport me kërkesën e nivelit të prodhimit të energjisë dhe jetës së mbetur në operim të termocentraleve ekzistuese, e sidomos të TC ‘Kosova A’.

Duke i u referuar Studimit Themelor Mjedisor dhe social, ky raport arrin tek përfundimi se gjendja mjedisore në zonën e sektorit energjetik është tejet komplekse për disa arsye:

- Gjendja mjedisore është prekur thellë nga aktivitetet minerare nga e kaluara, të cilat kanë shkaktuar edhe modifikime të theksuara në terren;
- Cilësia e ajrit është e dobët për shkak të emetimeve nga termocentralet ekzistuese, të cilat nuk janë në pajtueshmëri me standardet aktuale të BE-së;
- Cilësia e tokës dhe ujërave tokësore ka pësuar në masë të gjerë nga depozitimi i hirit dhe mbeturinave tjera dhe nga veprimtaria e stabilimenteve të Tertorës, Gazifikimit dhe Azotikut në të kaluarën;
- Cilësia e ujërave sipërfaqësore është ndikuar nga derdhjet e ujërave të patrajtuara nga termocentralet, aktivitetet minerare dhe ujërat e zeza urbane;
- Emetimet e zhurmës nga aktivitetet minerare janë bezdisëse për njerëzit që jetojnë në afërsi të mihjeve sipërfaqësore;
- Mungesa dhe kontrolli jo efektiv mjedisor, apo mos-efikasiteti i tyre (sa i përket ujit e ajrit); dhe
- Nuk ka procedura formale për menaxhimin e ujërave në lokacionet industriale.

Rekomandimet kryesore, të cilat dalin nga Raporti dhe analizat e skenarëve të mundshëm zhvillimorë, janë si vijon:

- ‘Kosova A’ është lokacioni i preferuar për ndërtimin e TC ‘Kosova Re’, edhe pse rezultati i studimit të lokacionit alternativ pranë ‘Kosovës B’ i jep një përparësi të vogël këtij lokacioni sa i takon anës financiare. Në anën tjetër, lokacioni në Bivolak do duhej përjashtuar nga konkurrenca, sidomos për shkak se do të ishte ndërtim në fushë të gjelbër; dhe
- Të dy teknologjitë komerciale në dispozicion për djegien e linjitet (‘PF’ apo ‘CFB’)⁷ janë të pranueshme dhe do të ishin në pajtueshmëri të plotë me standardet e BE-së.

Njëherësh edhe Raporti i VSMS-së përshkruan kornizën ekzistuese ligjore dhe institucionale që ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin mjedisor, në nivelin nacional, regjional dhe lokal, si dhe analizon boshllëqet në krahasim me standardet dhe rregulloret ndërkombëtare. MMPH është

6 VSMS është hartuar si pjesë e projekti PATEL të financuar nga WB dhe EC. Rezultatet përfundimtare të VSMS-së do të informojnë njëherit edhe për hartimin e Planit Zhvillimor të Zonës së Minierës së Re e cila do të prezantoj kornizën e investimeve sektoriale dhe po ashtu masat zbutëse për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve të mundshme negative të opsioneve të ndryshme zhvillimore.

7 PF nënkupton ‘Pulverised fuel’, ndërsa CFB nënkupton ‘Circulating Fluidized Bed’

duke punuar në përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga TKE, sa i përket mjedisit. Në vijim janë të listuara obligimet që rrjedhin nga TKE.

Obligimet mjedisore në kuadër të TKE

Shtojca II e TKE përcakton orarin për implementimin e elementeve të ndryshme të *acquis* të BE, si vijon:

1. Me hyrjen në fuqi të Traktatit, të gjitha Palët kontraktuese do të zbatojnë Direktivën e Këshillit 85/337/EC të datës 27 qershor 1985 mbi vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private në mjedis, dhe ndryshimet e bëra përmes Direktivës së Këshillit 97/11/EC të datës 3 mars 1997, dhe Direktivës 2003/35/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 26 maj 2003.
2. Deri më 31 dhjetor 2011, të gjitha palët kontraktuese do të zbatojnë Direktivën e Këshillit 1999/32/EC të datës 26 prill të vitit 1999 lidhur me zvogëlimin e përmbajtjes së sulfurit në disa karburante të lëngshme dhe e cila ndryshon Direktivën 93/12/EEC.
3. Deri më 31 dhjetor 2017, të gjitha palët kontraktuese do të zbatojnë Direktivën 2001/80/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 23 tetor 2001 mbi limitimin e emetimeve të disa ndotësve në ajër nga impiantet e mëdha me djegie.
4. Me hyrjen në fuqi të Traktatit, të gjitha palët kontraktuese do të zbatojnë nenin 4, pika 2 të Direktivës 79/409/EC të Këshillit të datës 2 prill 1979 mbi ruajtjen e shpezhëve të egra.

Burimi: Traktati për Komunitetin e Energjisë

Gjendja aktuale e mjedisit kërkon adresim të qartë dhe zbatimin e programeve dhe projekteve për zvogëlimin e ndikimit në mjedis në mënyrë që ai të mos bëhet pengesë në zhvillimin e ardhshëm të sektorit të energjisë.

Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe Social propozon disa nga masat për zvogëlimin e ndikimit të dëmshëm në mjedis, të cilat përfshijnë:

- Zvogëlimi i konsumit të ujit përmes riciklimit të ujërave industriale të shkarkuara me teknologjitë më të përparuara;
- Përgatitja e planeve për menaxhimin e pellgjeve për hidrosistemin e Ibër-Lepencit, në pajtueshmëri me udhëzimet e BE-së dhe me politikat e specifikuar në Direktivën Kornizë të Ujit të BE-së;
- Përgatitja e planeve për investimet në infrastrukturën ujore;
- Hartimi i Studimit të fizibilitetit për krijimin e basenit akumulues me qëllim të rritjes së sigurisë së furnizimit të objekteve energjetike me ujë;
- Përgatitja e kornizës së politikave dhe kritereve për të udhëzuar alokimin e resurseve ujore tek sektorët e ndryshëm që shfrytëzojnë ujin me prioritetë;
- Instalimi i barrierave përkatëse të zërit për të zvogëluar pengesat e shkaktuara nga zhurmat;
- Rikultivimi i zonave të vjetra minerare;
- Zvogëlimi i emetimeve të partikulateve nga minierat, termocentralet dhe depot e hirit;
- Riparimi i pajisjeve në TC 'Kosova A' për zvogëlimin e emetimeve të pluhurit dhe shkarkimin e ujërave industrialë;
- Modernizimi i pajisjeve në TC 'Kosova B' për t'i zvogëluar emisionet në nivelin e lejuar në pajtim me standardet e BE-së;

- Ndërtimi i një impianti për trajtim të ujërave industriale, të zeza dhe kanalizimit në dalje nga objektet industriale;
- Krijimi i një sistemi adekuat të monitorimit të emetimeve;
- Miratimi i kornizës politike për zhvendosje; dhe
- Miratimi i planit zhvillimor hapësinor.

Trajtimi i emisionit të dyoksidit të karbonit (CO₂)

Republika e Kosovës angazhohet të bëhet pjesëmarrëse e UNFCCC dhe ta ratifikojë Protokollin e Kyotos. Ajo do të përkrahë procesin e diskutimit për post-Kyoton, që filloi në fund të vitit 2008 në Poloni dhe do të pritet të finalizohet në Danimarkë, mbase brenda vitit 2009. MEM-i përkrahë mbështetjen e GEF/UNDP për MMPH për përgatitjen e komunikimit të parë nacional.

Pjesëmarrja e Kosovës në këto marrëveshje jo vetëm që do të kontribuojë në arritjen e objektivave mbarë botërore për kontrollin dhe reduktimin e emetimeve të gazrave që shkaktojnë 'efektin serë', por do të ndikojë dukshëm edhe në përmirësimin e situatës mjedisore dhe ruajtjen e mjedisit në Kosovë nga ndikimi i emisioneve të dëmshme, përfshirë ato nga sektori energjetik, brenda kufijve të pranueshëm dhe të lejuar.

Kosova angazhohet të zbatojë në kohën e duhur detyrimin për t'u përmbajtur kuotave të emetimeve të lejuara nga stabilimentet e saj energjetike. Ajo do t'u kërkojë operatorëve privatë të stabilimenteve të reja gjeneruese të respektojnë, në përputhje edhe me kushtet e tregut, të gjitha angazhimet që Kosova do t'i marrë përsipër në kuadër të pjesëmarrjes në marrëveshjet e përmendura më sipër.

3.7 Mbështetja financiare e deritanishme

Prej fundit të vitit 1999 deri në vitin 2008, KEK-u ka pranuar rreth €1,052⁸ milionë në formë subvencionesh, prej të cilave €459 milionë nga Buxheti i Kosovës (BK) dhe €593 milionë nga donatorët (nga të cilat €415 nga Agjencia Evropiane për Rindërtim (AER) e Komisionit Evropian). Alokimet prej BK i rreth €70 milionë në vit gjatë tri viteve të fundit ka përbërë 11 për qind të të gjitha shpenzimeve buxhetore. Kjo mbështetje e gjerë financiare ka bërë që prodhimi i qymyrit dhe energjisë elektrike të ketë një rritje të vazhdueshme për çdo vit. Me gjithë atë, si rezultat i rritjes së konsumit dhe i performancës së dobët në kontrollin e konsumit dhe arkëtimit të energjisë së dërguar, KEK sh.a. ka pasur ndikime negative në financat publike dhe mjedisin për biznes. KEK sh.a. mbeti një pengesë e shtrenjtë mbi supet e Buxhetit të Kosovës, ndërsa absorbon edhe një pjesë të ndihmës së donatorëve për Kosovën. Aftësia e vogël e KEK-ut për të importuar energji elektrike dhe cilësia e ulët e shërbimeve që ofron i shkakton shpenzime të mëdha ekonomisë së Kosovës, duke bërë që furnizimi i parregullt me energji elektrike shpesh të konsiderohet si barriera më e madhe për investime në Kosovë.

Sikurse tregon edhe Tabela 5, shpenzimet totale për sektorin e energjisë, përfshirë këtu minierat, kanë qenë një shterues i konsiderueshëm i Buxhetit të Kosovës.

8 EC/WB 'Prospectus' i Kosovës, i prezantuar gjatë Konferencës së Donatorëve në Bruksel, 11 korrik 2008

Tabela 5: Totali i shpenzimeve për sektorin e energjisë [në milion €]

Përshkrimi:	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	Total
Totali i donatorëve	259.5	18.8	66.4	138.5	48.2	10.4	28.2	15.5	0	585.5
Subvencionet	-	-	4.1	-	-	-	-	-	-	4.1
Asistenca Teknike	-	-	9.8	90.3	10.9	10.4	21.4	3	-	145.8
Investimet kapitale	259.5	18.8	52.5	48.2	37.3	-	6.8	12.5	-	435.6
Totali i BKK-së	11.6	45.9	108.1	56.3	41.4	67.2	47.1	65.6	163.5	606.7
Mjetet e BKK-së	11.6	45.9	108.1	56.3	41.4	57.2	47.1	65.6	84.1	517.3
Kredia e dhene KEK-ut	-	-	-	-	-	10	-	-	79.4	89.4
Totali i donatorëve dhe BKK-së	271.1	64.7	174.5	194.8	89.6	77.6	75.3	81.1	163.5	1192.2

Burimi: KASH 2009-2011

Në vitin 2008 mbështetja buxhetore për sektorin energjetik ishte parashikuar në €163.5 milionë. Kjo tregon angazhimin e Qeverisë për përmirësimin rrënjësorë të situatës së furnizimit me energji elektrike, nëpërmjet financimit të gjithë investimeve kapitale të domosdoshme në sektorin e mihjeve të linjitet dhe riparimit dhe mirëmbajtjes së kapaciteteve elektrogjeneruese ekzistuese. Kjo mbështetje do të vazhdojë edhe për vitin 2009, kur shpenzimet për sektorin e energjisë do të arrijnë në 9.4% të totalit të Buxhetit për atë vit.



Burimi: KASH 2009-2011

4. Konsumi dhe furnizimi i energjisë

4.1 Konsumi total i energjisë gjatë periudhës 2004-2007

Furnizimi me energji i Kosovës gjatë periudhës 2004-2007 është rritur prej 2011 ktoe në vitin 2004 në 2201 ktoe në vitin 2007, siç paraqitet edhe në Figurën 6. Ai ka pasur një rritje mesatare vjetore prej rreth 3.2%. Sipas llojit dhe sasisë, për këtë periudhë furnizimi me energji ka qenë:

- Prodhimi i thëngjillit ka ndryshuar nga 1228 ktoe në vitin 2004 në 1298 ktoe për vitin 2007, që përbën një rritje mesatare vjetore prej 1.79%.
- Importi i produkteve të naftës është rritur nga 455 ktoe në vitin 2004 në 654 ktoe në vitin 2007, që përbën një rritje mesatare vjetore prej rreth 11.08%.
- Prodhimi i energjisë elektrike dominohet nga termocentralet 'Kosova A' dhe 'Kosova B', me një rritje të prodhimit nga 341 ktoe në vitin 2004 në 384 ktoe për vitin 2007, që paraqet një rritje vjetore të prodhimit prej rreth 3.81%.
- Prodhimi i energjisë elektrike nga Hidrocentralet e Kosovës ka pësuar një rënie nga 9.71 ktoe në vitin 2004 në 5.40 ktoe në vitin 2007, që përbën një rënie mesatare vjetore prej 23.7%.
- Për të bërë të mundur mbulimin e pikut të kërkesës, importohet sasi e konsiderueshme e energjisë elektrike. Në vitin 2004 janë importuar 55.96 ktoe, ndërsa energjia elektrike e importuar në vitin 2007 ka qenë 56.80 ktoe që është një rritje e importit mesatar vjetor prej 1.5%.
- Një sasi e energjisë elektrike eksportohet (teprica e energjisë gjatë orëve të natës). Sasia e eksportit është rritur nga 16.7 ktoe në 2004 në 31.7 ktoe në 2007, që paraqet një rritje mesatare vjetore prej 18.7%.
- Nuk ekzistojnë shifra reale sa i përket shkallës së prerjes së druve të zjarrit, por besohet kjo të jetë rreth 216-250 ktoe për vit.
- Kontributi i energjisë diellore, edhe pse jo i rëndësishëm për Kosovën, ka shënuar rritje.

4.2 Konsumi i energjisë sipas sektorëve ekonomikë gjatë periudhës 2004-2007

Për periudhën 2004-2007, kontributi i secilit burim primar të energjisë në konsumin total të saj paraqitet në Figurën 5. Ndërsa, kontributi në konsumin total të energjisë, për po të njëjtën periudhë, nga çdo sektor ekonomik është paraqitur në Figurën 6. Pjesa kryesore e këtij konsumi është mbuluar nga qymyri dhe më pas nafta dhe nënproduktet e saj.




Figura 5: Kontributi i secilit burim primar të energjisë në Kosovë (ktoe)




Figura 6: Kontributi në konsumin total të energjisë nga çdo sektor (ktoe)

4.3 Arsyet e rritjes së shpejtë të konsumit të energjisë

Problemet dhe sfidat kryesore, të cilat janë identifikuar përmes analizës së zhvillimit historik dhe të trendeve të kërkesës për energji dhe mbulimit të saj në të ardhmen në Kosovë, janë:

- Zhvillimi ekonomik i vendit ka kërkuar gjithnjë e më shumë energji. Kjo, si dhe gjendja e termocentraleve ekzistuese kanë diktuar nevojën për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese elektrike.
- Rritja e konsumit të energjisë elektrike gjatë një periudhe të gjatë deri më tani mund t'i atribuohet mungesës së kontrollit efikas të konsumit, i cili është shoqëruar me rritje të nivelit të humbjeve joteknike dhe abuzimit me energji elektrike, kryesisht në sektorin e amvisërisë, në enklavat me shumicë serbe dhe në një masë edhe në atë të shërbimeve, ka rezultuar në vazhdimin e furnizimit me reduktime.
- Mungesa e burimeve alternative të energjisë (ose çmimet e larta të tyre) për ta zëvendësuar energjinë elektrike dhe çmimet e ulëta të saj kanë çuar në shfrytëzim masiv të saj për ngrohje të hapësirave dhe shfrytëzim për qëllime të tjera, duke mos nxitur kursimin e saj.
- Rritja e kërkesës në sektorin e transportit për naftë dhe benzinë nga importi përkeqëson bilancin e huaj tregtar të Kosovës.

4.4 Prodhimi i energjisë elektrike në periudhën 2000-2007

Bazuar në disa studime të rëndësishme të pas vitit 2000, si dhe në analizat e bilanceve të energjisë të përgatitura nga MEM, analiza këtu që kanë marrë parasysh karakteristikat dhe strukturën e sistemit elektroenergetik të Kosovës, humbjet në rrjet dhe importin neto të energjisë elektrike, rezultojnë se për periudhën 2000-2007 prodhimi i secilit central elektro-gjenerues ka qenë siç paraqitet në Figurën 7*; ndërsa kontributi në përqindje i secilit central elektro-gjenerues në mbulimin e konsumit total të energjisë elektrike ka qenë siç paraqitet në Figurën 8.




Figura 7: Kontributi i secilit central në mbulimin e nevojave për energji elektrike (GWh)




Figura 8: Kontributi i secilit central në mbulimin e nevojave për energji elektrike (%)

* Shënim:

Me prodhimin e HC-ve të lidhura në rrjetin e shpërndarjes;

Humbjet teknike në bartje dhe shpërndarje janë vlerësuar në rreth 17-18% ;

Operimi i furnizimit me skemën 5:1.

4.5 Furnizimi me energji elektrike gjatë periudhës 2000-2007

Rritja mesatare relative vjetore e konsumit të energjisë elektrike në Kosovë gjatë periudhës 2000–2007 ka qenë rreth 7%. Konsumi elektroenergjetik prej 2,864 GWh në vitin 2000 arriti në 4,582 GWh në vitin 2007, pra një rritje totale prej 161%. Kjo rritje prej mesatarisht 7% (shih Figurat 9 dhe 10), është dukshëm më e lartë sesa kërkesa e parashikuar në studimin ESTAP I të Bankës Botërore në vitin 2002, ku rritja relative vjetore e konsumit të energjisë elektrike ishte parashikuar me 5%. (Skenari i Mesëm i Kërkesës).




Figura 9: Faturimi, konsumi direkt dhe humbjet në sistemin elektroenergjetik (GWh)




Figura 10: Faturimi, konsumi direkt dhe humbjet në sistemin elektroenergjetik (%)

Mund të thuhet se gjatë periudhës 2000 – 2007 dhe vitit 2008:

- prodhimi vendor i energjisë elektrike ka qenë nën nivelin e kërkesës;
- gjatë periudhave të dimrit ka pasur mungesa në furnizim të mjaftueshëm të qymyrit për operim të blloqeve në termocentrale;
- revitalizimi i blloqeve në TC ‘Kosova A’ nuk është krye siç ka qenë planifikuar sipas studimit të vitit 2005, gjë që e ka bërë të paarsyeshëm revitalizimin e tyre në të ardhmen;
- ka pasur kufizime të shaktuara nga kapacitetet e pamjaftueshme të bartjes dhe shpërndarjes në periudhën e ngarkesave të larta (sidomos gjatë dimrit);
- kontrolli dhe menaxhimi me konsumin elektroenergjetik (demand side management) nuk është arritur;
- arkëtimi i energjisë elektrike të konsumuar dhe faturuar ka qenë në nivel të ulët, pra humbjet komerciale kanë qenë tepër të larta;
- furnizimi me energji elektrike është balancuar me reduktime, sipas skemës kohore 5:1; dhe
- importi i vazhdueshëm i energjisë elektrike, i cili viteve të fundit mbulon 10-15% të konsumit.

Rritja e lartë e konsumit të energjisë elektrike dhe ngarkesave maksimale në sistemin elektroenergjetik të Kosovës në periudhën 2000-2007 është shkakuar kryesisht nga humbjet e larta komerciale në nivelin prej 25% - 31% nga bruto konsumi elektroenergjetik. Në periudhën 2005–2007, humbjet totale (teknike dhe joteknike) të energjisë elektrike në sistemin elektroenergjetik të Kosovës (bartja dhe shpërndarja) ishin sa rreth gjysma e bruto konsumit. Në këtë periudhë shkalla e inkasimit ishte rreth 75% e energjisë elektrike në pjesën e kontrolluar të konsumit.

Rreth 90% e bruto konsumit aktual të energjisë elektrike realizohet në rrjetin e shpërndarjes të nivelit të tensionit të mesëm 35(20)/10 kV dhe të tensionit të ulët 0.4 kV. Rritja relative e madhe e konsumit elektroenergjetik në nivel të tensionit të ultë në periudhën 2000– 2007 është shkakuar kryesisht nga:

- mos lidhja e të gjitha kontratave ndërmjet furnizuesit dhe konsumatorëve;
- mos menaxhimi i duhur i konsumit në amvisëri dhe sektorin komercial;
- mos inkasimi në enklavat e minoritetit serb;
- mosarritja e konsolidimit të procesit të faturimit dhe inkasimit; dhe
- shfrytëzimi i energjisë elektrike për qëllimet e ngrohjes.

4.6 Importi i energjisë elektrike

Duke filluar nga viti 2000 vendi ynë është shndërruar nga një eksportues neto i energjisë elektrike në një vend importues neto. Gjatë këtyre viteve vendi ka importuar prej maksimum 33% energji elektrike në vitin 2001 deri në 12.6% në vitin 2008 të konsumit të përgjithshëm të energjisë elektrike, në varësi të sasisë së energjisë të prodhuar në vend. Duke pasur parasysh rritjen e kërkesës për energji elektrike nga viti në vit, është pothuajse e sigurt që roli i importeve të energjisë elektrike në të ardhmen e afërt do të jetë esencial për sigurimin e një furnizimi të sigurt dhe të qëndrueshëm me energji. Importet e energjisë do të ndikojnë jo pak edhe në koston e furnizimit, për rrjedhojë edhe në rritjen e tarifave të energjisë elektrike për konsumatorët e të gjitha kategorive.

Duhet nënvizuar se kapaciteti importues/eksportues i sistemit elektroenergjetik të Kosovës nuk është i mjaftueshëm për plotësimin e ngarkesave maksimale (pikut) në rritje gjatë dimrit. Duke

pasur parasysh që kërkesa për energji elektrike në një ditë dimri arrin deri në 17-18 milionë kWh, shpeshherë KEK sh.a. ka qenë i detyruar të bëjë kufizime të ngarkesës, duke sjellë shqetësime dhe dëme në ekonomi dhe në cilësinë e jetesës së qytetarëve.

Një problem tjetër i mprehtë lidhur me importin e energjisë elektrike, me të cilin po përballet KEK sh.a., sidomos dy vitet e fundit, janë çmimet gjithmonë e më të larta të këtyre importeve. Kjo jo vetëm që e ka vënë KEK sh.a. në vështirësi likuiditetesh të mjaftueshme për të bërë këto importe, por ka kërkuar edhe rritje të mëtejshme të tarifave për klientët tariforë.

Duhet theksuar se importi i energjisë elektrike është vështirësuar për shkak të rritjes së deficitit të energjisë elektrike në rajonin e Ballkanit, ku numri më i madh i vendeve janë importues neto të energjisë elektrike. Parashikohet që për të ardhmen e afërt të vazhdojnë të ekzistojnë vështirësi të furnizimit me energji elektrike në rajonin tonë.

Nga Masterplani i Gjenerimit të Energjisë Elektrike (përgatitja e të cilit u financua nga Banka Botërore), rezulton se Rajoni i Ballkanit do të ketë nevojë për 20.000 MW fuqi të re të instaluar, si dhe për t'i rehabilituar 5000 MW të gjenerimit ekzistues. Ndërkohë, për ta transmetuar këtë energji nga qendrat gjeneruese tek konsumatorët kërkohet ndërtimi në rajon i linjave të interkonjeksionit dhe të transmetimit me një vlerë rreth 2.5-3 miliardë USD. Vlen të theksohet se në këtë studim Termocentrali 'Kosova e Re' është identifikuar si një nga projektet më prioritare, gjë që e vendosë Kosovën në pozicion strategjik rajonal për sa i takon gjenerimit të energjisë elektrike në të ardhmen.

5. Projekti ‘Kosova e Re’

Me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit të energjisë, Qeveria e Kosovës planifikon kyçjen e ekspertizës dhe kapitalit privat nga jashtë. Banka Botërore është duke mbështetur Kosovën në përpjekjet për t’i joshur investimet për zhvillimin e projektit “Kosova e Re”, përmes Projektit të Asistencës Teknike Energjia nga Linjiti (PATEL)⁹. Kjo përpjekje është mbështetur edhe nga KE, përmes financimit të Studimit të Opsioneve, si dhe studimeve tjera teknike që janë në funksion të PATEL-it.

Projekti “Kosova e Re” do të duhet të ndërtohet përmes një qasje me faza, në të cilën faza e parë (1000 MW) do të mundësonte zëvendësimin e termocentralit ‘Kosova A’ (pra dekomisionimin e tij), do t’i përmbushte nevojat vendore, dhe do ta mundësonte rehabilitimin e termocentralit ‘Kosova B’, në mënyrë që të ngritet besueshmëria e tij dhe të sillet në pajtueshmëri me standardet mjedisore të BE-së. Një sasi nga prodhimi i TC ‘Kosova e Re’ do të mund të eksportohej. Faza e dytë (1000 MW) do të përmbushte kërkesën në rritje dhe do të mundësonte mbylljen e mëvonshme të Termocentralit ‘Kosova B’, kur të përfundojë jeta e tij teknike pas revitalizimit;

Me mbështetjen e Këshilltarëve të Projektit, financiar përmes PATEL, Qeveria e Kosovës është duke ndërmarrë një proces transparent dhe konkurrues për ta përzgjedhur një investitor strategjik për zhvillimin e Projektit “Kosova e Re”. Deri më tani është kryer procesi i parakualifikimit të investitorëve potencialë. Parashikohet që mbyllja financiare e Projektit të ndodhë brenda vitit 2010.

⁹ Objektivat kryesore të PATEL janë: (a) mbështetja e Qeverisë në fuqizimin e politikave, kornizës ligjore dhe rregullative të cilat mundësojnë investimet të reja në sektorin e energjisë; dhe (b) mbështetja e Qeverisë për të joshur investitorë privat të kualifikuar për ndërtimin e termocentralit të ri me linjit, bazuar në principet e larta të qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale.

6. Integrimet Rajonale dhe Evropiane

Kosova është e angazhuar fuqishëm drejt integrimi Evropiane. Për sektorin energjetik procesi i integrimi zhvillohet në dy fronte: (i) pjesëmarrja në Komunitetin e Energjisë, dhe (ii) procesi i integrimi në Evropë, në kuadër të Mekanizmit Përcjellës për Stabilizim Asocim.

6.1 Traktati për Komunitetin e Energjisë

Kosova është nënshkruese e Traktatit për Themelimin e Komunitetit të Energjisë (TKE) të Evropës Juglindore, i cili ka hyrë në fuqi në 1 korrik 2006. Në këtë kontekst, Qeveria e Kosovës është e angazhuar substancialisht për ta zhvilluar sektorin e energjisë në përputhje me kërkesat e TKE-së. Ky Traktat obligon implementimin e 'Acquis Communautaire' të BE-së nga ana e secilës palë kontraktuese, sipas një kalendari për zbatim të reformave të kërkuara. Në kontekst të vendosjes së kushteve të tregut të energjisë në rajon, Operatorët e Sistemit të Bartjes (OSB) të Evropës Juglindore, nën koordinimin e Operatorëve Evropianë të Sistemit të Bartjes (ETSO), në korrik 2004 kanë filluar zbatimin e mekanizmit të kompensimit ndërmjet OSB-ve, me qëllim të kompensimit të shfrytëzimit të sistemeve bartëse nacionale, përmes Tregtisë Ndërkufitare në Evropën Juglindore (EJ). Gjithashtu, është në vazhdim procesi për zbatimin e veprimeve të koordinuara për kapacitetet e ndërlihdjeve.

Sistemi i energjisë elektrike i Kosovës ka lidhje të drejtpërdrejtë ndërlihdëse me sistemet e Shqipërisë, të Malit të Zi, të Serbisë dhe të Maqedonisë. Me përjashtim të Serbisë, të gjitha këto sisteme janë neto-importuese të energjisë elektrike. Ky fakt paraqet mundësi për investime potenciale në termocentrale të reja të linjimit në Kosovë.

Duhet të theksohet se sistemi i bartjes në Kosovë paraqet infrastrukturë të rëndësishme për bartjen e energjisë elektrike të sistemeve tjera elektro-energjetike të rajonit, si dhe për tregtarët e energjisë elektrike. Sasitë respektive vjetore të energjisë elektrike të bartura vlerësohen në 3,000 GWh. Ky faktor duhet të konsiderohet gjatë planifikimit dhe zhvillimit të kapaciteteve të reja për transmetimin e energjisë elektrike në Kosovë.

Zbatimi i obligimeve të Traktatit të Komunitetit të Energjisë do të vazhdojnë të përbejnë prioritet parësorë për sektorin energjetik dhe aktorët e tij vendorë.

Traktati për themelimin e Komunitetit të Energjisë

Në vazhdim të procesit të Athinës, që kishte për qëllim krijimin e një tregu të integruar rajonal në Evropën Jug-Lindore, në 25 tetor 2005 Komuniteti Evropian dhe Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia, Rumania, Serbia dhe UNMIK-u, që përfaqësonte Kosovën, nënshkruan Traktatin për themelimin e Komunitetit të Energjisë. Austria, Qipro, Republika Çeke, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Sllovakia, Sllovenia, Mbretëria e Bashkuar u pajtuan për pjesëmarrje në takimin e parë Ministror në Nëntor të vitit 2006.

Traktati për Komunitetin e Energjisë kërkon nga palët kontraktuese që të zbatojnë pjesë të rëndësishme të *acquis communautaire*, ofron mundësi për krijimin e një tregu të vetëm të energjisë dhe mekanizmin për operimin e tregjeve të energjive që përcillen nëpërmjet rrjetave. Ai, gjithashtu themelon edhe institucionet e Komunitetit të Energjisë, si dhe procesin e vendimmarrjes. Pas procesit të miratimit dhe shpalljes, Traktati hyri në fuqi më 1 Korrik 2006.

Kuadri Institucional dhe procesi i vendimmarrjes brenda Komunitetit të Energjisë përfshin organet në vijim: (i) Këshillin Ministror, (ii) Grupin Permanent të Nivelit të Lartë, (iii) Fora-n, dhe (iv) Sekretariatin.

Në pajtim me Nenin 2 të Traktatit, detyra e Komunitetit të Energjisë është të organizojë lidhje ndërmjet Palëve Kontraktuese dhe të krijojë një kornizë ligjore dhe ekonomike për energjitë që përcillen përmes rrjetave, në mënyrë që të:

- (i) Krijojë një kornizë të qëndrueshme rregullatore dhe të tregut, që do të mund të nxisë investimet në rrjetat e gazit, gjenerim të energjisë, dhe rrjetat e transmisionit dhe distribucionit të energjisë elektrike,
- (ii) Krijojë një hapësirë të vetme rregullatore për tregti për energjitë që përcillen përmes rrjetave,
- (iii) Përmirësojë sigurinë e furnizimit në një hapësirë të vetme rregullatore,
- (iv) Përmirësojë situatën mjedisore në lidhje me energjitë që përcillen përmes rrjetave dhe eficientëcn e energjisë, kujdeset për shfrytëzimin e energjisë së ripërtëritshme dhe cakton kushtet për tregti të energjisë në një hapësirë të vetme rregullatore, dhe
- (v) Zhvillon konkurrencën në tregun e energjive që përcillen përmes rrjetave në një shtrirje më të gjerë gjeografike dhe përdorë ekonomitë e shkallës.

6.2 Mekanizmi Përcjellës për Stabilizim Asocim

Zhvillimi i Sektorit Energetik në pajtim me *Acquis* e BE-së është një nga komponentët më të rëndësishëm të Planit të Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE). Ministria e Energjisë dhe Minierave (MEM), në kuadër të një Grupi Punues për Energji (GPE) të krijuar në fillim të vitit 2007, është duke koordinuar të gjitha aktivitetet për zbatimin e PVPE për sektorin energetik.

Procesi i Integrit Evropian për Kosovën

Mekanizmi Përcjellës i Stabilizim Asocimit (MPSA) është dizajnuar për t'i siguruar Republikës së Kosovës ekspertizën dhe udhëheqjen politike të Komisionit Evropian, me qëllim të asistimit të autoriteteve Kosovare për të përfituar nga instrumentet e ndryshme të procesit të Stabilizim Asocimit.

Takimet e rregullta organizohen për ta vlerësuar progresin e shënuar në Kosovë për sa i përket reformave politike, ekonomike dhe institucionale, në pajtim me Procesin e kushtëzuar të Stabilizim Asocimit të BE-së. Komisioni Evropian rregullisht monitoron progresin e Procesit të Stabilizim Asocimit në Kosovë, nëpërmjet STM.

Plani i Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE) paraqet kornizën për monitorimin e progresit që Kosova po shënon vit pas viti në drejtim të Komunitetit Evropian. Institucionet e Kosovës janë fuqimisht të përkushtuara në zbatimin e PVPE, i cili nga njëra anë ofron të gjithë hapat për reforma dhe në anën tjetër drejton asistencën e Komunitetit Evropian për Kosovën.

Ministria e Energjisë dhe Minierave (MEM) ka koordinuar të gjitha aktivitetet në emër të Kosovës, si pjesëmarrëse e Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE). Grupi Punues për Energji (GPE), i themeluar në Kosovë, pasi TKE hyri në fuqi, ka qenë forumi ndëristitucional për mbarëvajtjen e aktiviteteve në kuadër të TKE-së. Anëtarët e GPE kanë qenë nga MEM-i, Zyra e Rregullatorit për Energji, KOSTT sh.a, KEK sh.a, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Për fillimit të këtyre proceseve, MEM dhe aktorët tjerë relevantë të sektorit energjetik kanë bërë punë të lavdërueshme për t'iu përgjigjur obligimeve që rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë dhe Plani i Veprimit për Partneritet Evropian.

6.3 Bashkëpunimi dypalësh

Bashkëpunimi me Shqipërinë

Në drejtim të zhvillimit dhe avancimit të mëtutjeshëm të bashkëpunimit rajonal, Kosova ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për sektorin e energjisë me Shqipërinë. Është me rëndësi të theksohet se sistemi i energjisë elektrike i Shqipërisë, mbështetet kryesisht në hidroenergji (pothuajse 100%), derisa sistemi i Kosovës mbështetet pothuajse 100% në termoenergji. Këto dy sisteme janë komplementare, prandaj ofrojnë mundësi të jashtëzakonshme bashkëpunimi ndërmjet tyre, optimizim të operimit, këmbim optimal të energjisë, rritje të sigurisë së furnizimit, si dhe mundësi për optimizim të investimeve. Në kontekstin e integritimeve rajonale dhe evropiane ky fakt reflektohet në të dyja sistemet, por edhe më gjerë, duke krijuar kushte atraktive për investorët e interesuar në prodhimin e energjisë elektrike në Kosovë dhe në vendet tjera në rajon.

Bashkëpunimi me Maqedoninë dhe Malin e Zi

Qeveria e Republikës së Kosovës është duke punuar në avancimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit në sektorin e energjisë edhe me shtetet tjera në rajon, si me Maqedoninë dhe Malin

e Zi. Kështu, është rënë dakord tashmë me Maqedoninë që të nënshkruhet brenda vitit 2009 një marrëveshje dypalëshe bashkëpunimi në sektorin e energjisë. Edhe me malin e Zi synohet e njëjta gjë. Draft marrëveshja është përgatitur.

Bashkëpunimi me Republikën e Bullgarisë

Tashmë është përgatitur dhe negociuar një marrëveshje dypalëshe midis MEM dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Energjisë të Republikës së Bullgarisë. Kjo marrëveshje parashikohet të nënshkruhet brenda vitit 2009.

Marrëdhëniet me Serbinë dhe dëmet gjatë periudhës 1990-1999

Në periudhën 1990-1999 objektet energjetike, elektroenergjetike dhe burimet e energjisë janë shfrytëzuar nga ana e regjimit serb pa pëlqimin e Kosovës. Si pasojë e shfrytëzimit të egër të objekteve gjatë një dekade, minierat e qymyrit dhe termo-elektro-centralet janë degraduar dukshëm, janë shkatërruar dhe një pjesë e pajisjeve është bartur në Serbi. Dëmi direkt dhe indirekt në këtë periudhë në sektorin e energjisë së Kosovës, shkaktuar nga ana e regjimit serb është shumë i lartë

Gjendja e sistemit elektroenergjetik në enklavat e minoriteteve

Në periudhën e pasluftës 1999-2008, KEK sh.a. ka favorizuar furnizimin me energji elektrike të enklavave me shumicë serbe, ndërsa Qeveria e Kosovës e ka bërë këtë favorizim me derivate të naftës për sistemet e ngrohjes. Në këtë periudhë KEK sh.a. nuk ka pasur qasje, kontroll, lexim të shpenzimit dhe bërjen e inkasimit të energjisë elektrike të shpenzuar në enklavat e minoritetit serb. Vazhdimi eventual i kësaj situete do të keqësojë situatën në sektorin e energjisë dhe do të vazhdojë të ketë implikime direkte edhe në Buxhetin e Kosovës

Gjate tërë periudhës 1999-2007, konsumatorët në enklava me shumicë serbe nuk kanë lidhur kontrata me furnizuesin dhe nuk kanë paguar për energjinë elektrike të shpenzuar të furnizuar nga sistemi elektroenergjetik i Kosovës. Gjate vitit 2009 një pjesë e konsumatorëve të energjisë elektrike në enklava kanë lidhur kontrata me KEK sh.a. Shuma e papaguar për energji elektrike ka arritur vlerën në €145 milionë.

Marrëdhëniet me Serbinë dhe marrëdhëniet në kuadër të Komunitetit të Energjisë

Në vitin 2001 midis Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe Ministrisë së Energjetikës së Serbisë/EPS, janë nënshkruar dy marrëveshje:

1. Marrëveshje teknike e përkohshme (TTA), 2001/03/26, dhe
2. Marrëveshje teknike e përkohshme për shkëmbimin e energjisë (TEEA), 2001/04/08

Këto dy marrëveshje teknike kanë pas afatin e vlefshmërisë për tërë kohën sa zgjatë misioni i UNMIK-ut në Kosovë.

Këto marrëveshje kanë mbuluar, përveç të tjerash edhe:

1. Kompensimin për transitin e energjisë elektrike nëpër sistemin e bartjes së Kosovës, dhe
2. Rregullimin sekondar (sigurimi i rezervës +/- 20 MW) për mbajtjen e balancës së sistemit.

Serbia i ka shkelur këto marrëveshje që nga korriku i vitit 2004. Prej atëherë Serbia nuk paguan kompensimin për transit, pa pëlqimin dhe në kundërshtim me KOSTT sh.a. alokon kapacitetet e bartjes të sistemit elektroenergetik të Kosovës, dhe, në emër të tregimit ndërkufitar të energjisë elektrike (CBT) për në shtetet e rajonit, inkason të hyrat nga tranzitimi i energjisë elektrike dhe i përvetëson ato në dëm të Kosovës. Vlera e përvetësuar nga OST e Serbisë për periudhën korrik 2004 – korrik 2008 është në lartësi prej €15 milionë. Ndërkohë, KOSTT sh.a. ka ndërprerë pagesën për rezervën, ndërsa vazhdon të kompensojë për devijimin.

Edhe pse është palë kontraktuese e Traktatit për Komunitetin e Energjisë (TKE), Serbia shkel dy marrëveshjet, uzurpon të drejtat e Kosovës, përvetëson kompensimet nga CBT mekanizmi për pjesën e Kosovës, nuk është transparent në alokimin e kapaciteteve për importet në rajon, duke shkaktuar ngritjen e paarsyeshme të çmimit të importeve në rajon, duke penguar kështu krijimin e tregut rajonal transparent dhe konkurrues. Ndaj shkeljes evidente të Traktatit që i bën Republika e Serbisë është ushtruar ankesë në Komunitetin e Energjisë.

Nga motivet politike OST serbe dhe vetë Serbia, si palë kontraktuese e Komunitetit të Energjisë, vazhdimisht pengojnë pjesëmarrjen e KOSTT sh.a. në mekanizmat e rajonit dhe të Evropës. OST e Serbisë është pengesë edhe në operimet ditore me sistemin e transmissioinit të KOSTT sh.a.

Marrëdhëniet në sistemin elektroenergetik të rajonit dhe pozita e Kosovës

Qeveria e Kosovës, në mënyrë institucionale, do të mbështesë krijimin e kushteve që KEK sh.a. të ketë qasje në tërë rrjetin elektrik të bartjes dhe shpërndarjes, t'i kryejë obligimet ndaj konsumatorëve dhe ta realizojë pagesën e energjisë elektrike.

Qeveria e Kosovës respekton marrëveshjet ndërkombëtare dhe obligimet që dalin nga TKE dhe do të bashkëpunojë me të gjithë nënshkruesit e TKE-së, pra edhe me Serbinë.

Mosrespektimi eventual, edhe në vazhdim, i detyrimeve të TKE-së do të ketë pasoja negative në operacionalizimin e tregut rajonal të energjisë elektrike dhe do të bëhet pengesë e zhvillimit të energjetikës së rajonit. Kosova është e angazhuar për bashkëpunim rajonal me të gjithë aktorët në baza të interesit reciprok.

6.4 Konferenca e Donatorëve për Kosovën

Më 11 korrik 2008, në Bruksel, u mbajt Konferenca e Parë e Donatorëve për Kosovën. Sektori i energjisë, për rëndësinë që ka për të ardhmen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe social të Kosovës, zuri vend të rëndësishëm në këtë Konferencë. Komuniteti i donatorëve jo vetëm që vlerësoi rëndësinë e sektorit të energjisë, por edhe vërejti domosdoshmërinë për vazhdimin e ristrukturimit të sektorit dhe risanimin financiar të KEK sh.a., si parakushte për investime të rëndësishme në sektor.

Mbetet detyrë parësore e institucioneve të sektorit të energjisë të vazhdojnë zbatimin e reformave dhe, në konsultim me donatorët, të përgatisin propozim-programe dhe projekte, të cilat kanë gjasa të financohen në kuadër të fondeve që ata premtuan në Konferencën e Donatorëve në Bruksel.

7. Përmbledhje e analizës SWOT për sektorin energjetik

Analiza e Përparësive, Dobësive, Mundësive dhe Rreziqeve (SWOT), e paraqitur në vijim, përmbledhë aftësitë konkurruese të sektorit të energjisë, duke marrë parasysh Përparësitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Rreziqet e identifikuar. Më tej objektivat strategjike të identifikuar në këtë Strategji do të përqendrohen në tejkalimin e dobësive të sektorit, parashikimin dhe evitimin e rreziqeve të mundshme që vijnë nga mjedisi përreth, si dhe do të ndikojnë në shfrytëzimin e përparësive dhe mundësive ekzistuese për zhvillimin e shpejtë të sektorit tonë energjetik. Tabela 6 paraqet një përmbledhje të Përparësive, Dobësive, Mundësive dhe Rreziqeve për sektorin e energjisë.

Tabela 6: Përmbledhje e analizës SWOT për sektorin e energjisë

Përparësitë:	Dobësitë:
<ul style="list-style-type: none"> • Përparësitë konkurruese për eksploatimin e resurseve natyrore energjetike • Rezervat e mjaftueshme të linjtit me mundësi të gjera për të gjeneruar energji elektrike me çmime konkurruese • Pozicioni i Kosovës në qendër të Ballkanit si e favorshme për transit të energjisë • Përvoja dhe kultura industriale në prodhim dhe në eksploatim të linjtit në Kosovë • Resurset humane të mjaftueshme • Baza ligjore në harmoni me standardet ndërkombëtare. • Republika e Kosovës është anëtare e Traktatit për Themelimin e komunitetit të Energjisë të EJL. • Mekanizmat institucionalë adekuatë për funksionimin e sektorit të energjisë, në veçanti autoritetet e pavarura rregullatorë dhe operatori i pavarur i sistemit të energjisë elektrike 	<ul style="list-style-type: none"> • Degradimi dhe deinvestimi në sistemin energjetik gjatë periudhës 1990-1999, që ka rezultuar në një sistem të vjetruar energjetik me humbje të mëdha teknike • Menaxhimi joefikas, humbje të larta komerciale, si dhe niveli i ulët i arkëtimit të borxheve, duke rezultuar në situatë jo të mirë ekonomike dhe financiare të ndërmarrjeve energjetike • Pamundësia për vetëfinansim të investimeve dhe marrje të kredive • Ngecja në ritmin e investimeve për modernizimin e kapaciteteve prodhuese, të bartjes dhe të shpërndarjes, që ka çuar në ndërprerje të shpeshtuara në furnizimin me energji elektrike • Ngecja në zhvillimin e minierave të reja të linjtit • Pjesëmarrja e ulët e BRE-ve në prodhimin e energjisë elektrike, • Varësia nga importi i disa llojeve të energjisë • Efiçienca e pamjaftueshme në procesin e prodhimit dhe shfrytëzimit të energjisë elektrike • Ndotja e mjedisit nga minierat e linjtit dhe nga prodhimi i energjisë dhe mungesa e veprimeve efikase për sanimin e gjendjes • Mungesa e një sistemi të përhershëm monitorimi të ndotjes

Mundësitë:	Rreziqet:
<ul style="list-style-type: none"> • Kërkesa në rritje për energji në Kosovë dhe rajon me mundësi për zhvillim të shpejtë të sektorit • Ristrukturimi dhe reformimi i sektorit të energjisë • Liberalizimi dhe privatizimi • Mundësia e tërheqjes së investitorëve strategjikë • Përdorimi i Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë • Ngritja e kapaciteteve të resurseve njerëzore • Qasja e Kosovës në mekanizmat ndërkombëtar financiarë për zhvillimin e BRE dhe rritjen EE 	<ul style="list-style-type: none"> • Ngritja e paparashikueshme të çmimeve të karburanteve të lëngëta që importohen dhe ndërprerja e paparashikueshme e furnizimit me prodhime të importuara të naftës • Çrregullimet sociale nga reformat në sektorin e energjisë, • Dështimet në zbatimin e mekanizmit efektiv për detyrim të arkëtimit të kërkesave, • Rritje e çmimeve të energjisë elektrike nga importi • Mosarritja e krijimit të një tregu të hapur dhe konkurrent të energjisë elektrike në rajon

Pjesa e Dytë

8. Parashikimi i nevojave për energji për periudhën 2009-2018

MEM, në kuadër të detyrave të veta, në bashkëpunim të ngushtë me KEK sh.a, KOSTT sh.a., ZRRrE, ngrohtoret, KPMM, MTI dhe Entin e Statistikave të Kosovës, përgatit bilanci vjetore të energjisë dhe parashikimet vjetore dhe afatgjata të nevojave për energji në Kosovë. Këto bilance dhe parashikime të nevojave kryhen në përputhje me standardet e Eurostatit¹⁰.

Dy nga treguesit më të rëndësishëm që përdoren në parashikimet energjetike të çdo vendi janë intensiteti energjetik dhe konsumi energjetik për banor, të cilët janë analizuar në seksionet në vijim.

8.1 Intensiteti energjetik dhe konsumi energjetik për banor

Aktualisht, intensiteti i energjisë¹¹ në Kosovë është në nivel relativisht të lartë. Kjo do të thotë se prodhimi makroekonomik, i raportuar normalisht nga Produkti i Brendshëm Bruto (PBB), ka qenë i ulët, krahasuar me konsumin e përgjithshëm të energjisë. Arsytet për këtë lidhen me zhvillimin e ulët industrial të vendit tonë, krahasuar me vendet tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore.

Kosova paraqitet me një konsum energjie mesatar për banorë, gati dy herë më të lartë së Shqipëria dhe gati të barabartë me Kroacinë. Intensiteti energjetik për Kosovën është me i larti në rajonin e Ballkanit, pas Bullgarisë.

Çështjet më të rëndësishme për zhvillimin e ardhshëm të ekonomisë kosovare dhe sektorit të saj të energjisë janë rritja e konsumit të energjisë për banor dhe në të njëjtën kohë mbajtja e nivelit të ulët të intensitetit të energjisë, gjë që do të sjellë një ekonomi eficiente dhe konkurruese në tregun gjithnjë e më të hapur ndërkombëtar.

8.2 Parashikimi i kërkesës për energji

Në kuadër të planeve për zhvillimin ekonomik të vendit dhe parashikimit të nevojave për energji, janë supozuar si më realistë dy skenarë të normës së rritjes të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) për periudhën 2009-2018, siç paraqiten në Tabelën 7.

Tabela 7: Dy skenarë të normës të rritjes së PBB-së në [%] për periudhën 2009-2018

Skenari	2009-2010	2011-2014	2015-2018
Mesëm	3.20	3.10	3.00
Lartë	6.20	5.29	5.00

¹⁰ Duhet të shënohet se të dhënat për emetimet që lirohen në mjedis nga shfrytëzimi i burimeve energjetike janë përpunuar në software-t energjetike LEAP (Long Energy Alternative Planning = Planifikimi Afatgjatë i Nevojave Energjetike) dhe IPCC (Intergovernmental Panel for Climate Change = Paneli Ndërkombëtar i Ndryshimeve Klimaterike).

¹¹ Një tregues sintetik shumë i rëndësishëm, që tregon nivelin e zhvillimit të sektorit energjetik, sidomos në drejtim të efikasitetit të energjisë, është intensiteti energjetik, i cili është i barabartë me raportin e konsumit të burimeve primare energjetike në një vit të caktuar në lidhje me Produktin Bruto të Brendshëm (PBB) të prodhuar në atë vit.

Rritja e furnizimit me energji duhet t'i përgjigjet rritjes së zhvillimit ekonomik dhe social. Figurat 11 dhe 12 paraqesin parashikimin e PBB-së për secilin sektor deri në vitin 2018 për skenarin me rritje të lartë të PBB¹².




Figura 11: Parashikimi i kontributit nga secili sektor ekonomik në PBB për skenarin me rritjen e lartë (milionë Euro)




Figura 12: Parashikimi i rritjes së PBB sipas dy skenarëve (milionë Euro)

Skenarët e përdorur në përgatitjen e parashikimeve të kërkesës për energji¹³ përshkruajnë mundësitë e zhvillimit të sektorit energjetik në Kosovë për periudhën afatmesme, duke konsideruar edhe parashikimet e zhvillimit teknologjik dhe ekonomik të vendeve fqinje.

Vlerësimi i trendit të indikatorëve makro-ekonomikë tregon që gjatë viteve 2003-2007 ekonomia e vendit u përforcua, si rezultat i zhvillimit të sektorëve të ndërtimit, shërbimeve dhe bujqësisë, si dhe rehabilitimit të industrisë dhe masës së konsiderueshme të remitencave nga emigrantët.

8.2.1 Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin banesor

Konsumi i energjisë dhe kërkesa e parashikuar në sektorin banesor është analizuar dhe diskutuar me kujdes, për shkak të kontributit më të lartë në energjinë totale të konsumuar, si dhe për shkak të konsumit tejet të lartë të energjisë elektrike në këtë nënsektor ekonomik.

Në Tabelën 8 janë dhënë parametrat kryesorë në të cilat bazohet parashikimi i kërkesës për energji në sektorin banesor¹⁴.

12 Bazuar në studimin ESTAP dhe konsulentat nga institucionet e ndryshme vendore e ndërkombëtare.

13 Skenarët që janë ndërtuar nuk pretendojnë të jenë preciz në parashikime, sepse për një gjë të tillë nevojiten shumë të dhëna dhe strategji tejet të qarta zhvillimore për sektorët e ndryshëm ekonomikë dhe socialë.

14 Numri i popullsisë është faktor i rëndësishëm udhëheqës i përdorur për llogaritjen e kërkesës së energjisë në sektorin banesor. Numri i familjeve për secilin zonë klimatike dhe grade ditët e ngrohjes për familjet urbane e rurale për secilin nga këto zona janë përdorur si faktorë themelorë në llogaritjen e kërkesës për energji në këtë nënsektor ekonomik.

Tabela 8: Parametrat kryesorë për parashikimin e kërkesës për energji për sektorin banesor

Viti	Nr. Banesave	Nr. Njerëzve për amvisni	Popullsia
2003	360000	5.429	1954000
2004	372407	5.310	1977448
2005	385521	5.191	2001177
2006	399308	5.072	2025192
2007	413816	4.953	2049494
2008	429099	4.834	2074088
2009	445217	4.715	2098977
2010	462235	4.595	2124165
2011	478329	4.476	2141158
2012	495332	4.357	2158287
2013	513324	4.238	2175553
2014	532390	4.119	2192958
2015	552625	4.000	2210501
2016	571967	3.8852	2228184
2017	595696	3.770	2246011
2018	619318	3.656	2263979

Parashikimi bazohet në metodologjinë që aplikon qasjen “së larti-poshtë”. Kërkesa e parashikuar për energji, bazuar në këtë metodologji dhe parametrat e lartpërmendur, për sektorin banesor, është treguar në Figurat 13 dhe 14.




Figura 13: Parashikimi i kërkesës së energjisë për sektorin banesor për skenarin e lartë (kete)




Figura 14: Parashikimi i kërkesës totale të energjisë për sektorin banesor sipas dy skenarëve (kete)

Burimet kryesore energjetike që realizojnë mbulimin e nevojave në sektorin banesor janë energjia elektrike, drutë e zjarrit dhe nënproduktet e naftës. Mbulimi i nevojave për të ardhmen tregon që energjia elektrike do të ketë rritje në vlera absolute, por në vlera relative kontributi i saj do të bjerë për të ardhmen. Kjo rënie e kontributit relativ të energjisë elektrike do të mbulohet nga rritja

relative e nënprodukteve të naftës (sidomos e Gazit të Lëngëzuar të Naftës - LPG) dhe druve të zjarrit. Për pasojë, është shumë e rëndësishme që të merren masat e duhura në lidhje me penetrimin e LPG në tregun energjetik kosovar.

8.2.2 Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e shërbimeve

Për ta rritur cilësinë e shërbimeve dhe përmirësuar kushtet e punës dhe komoditetin për administratën publike, është parashikuar që gjatë periudhës 2007-2016 përpjesa midis sipërfaqes së mjediseve të ngrohura dhe totalit të atyre të ngrohura e të pangrohura të rritet gradualisht, duke arritur në 100% më 2016. Rritja e PBB-së nga sektori shërbyes privat do të përcillet me rritjen e kërkesës për energji, për shkak të kërkesave të larta për komfort, nevojës për përmirësim cilësor të shërbimeve dhe ndryshimeve në përpjesën mes popullsisë urbane dhe rurale në favor të së parës.

Në Tabelën 9 jepen parametrat kryesorë, në të cilat është bazuar parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e shërbimeve.

Viti	PBB-Shërbimi [Milion EURO]	Intensiteti i energjisë për sektorin e shërbimit [ktoe/Milion EURO]	Popullsia
2003	430.44	0.319896	1954000
2004	443.03	0.294902	1977448
2005	462.80	0.315717	2001177
2006	495.20	0.322031	2025192
2007	529.86	0.328472	2049494
2008	566.95	0.335041	2074088
2009	606.64	0.341742	2098977
2010	649.11	0.348577	2124165
2011	688.05	0.355549	2141158
2012	729.34	0.362660	2158287
2013	773.10	0.369913	2175553
2014	819.48	0.377311	2192958
2015	868.65	0.384857	2210501
2016	921.63	0.392554	2228184
2017	956.90	0.400406	2246011
2018	996.45	0.408414	2263979

Analiza e indikatorëve makroekonomikë të vendit tregon se sektori shërbyes përbën rreth 10.9% të PBB-së, pjesë kjo që do të vazhdojë të rritet, siç është paraqitur në Figurat 15 dhe 16.

Konsumi i energjisë në sektorin e shërbimeve do të rritet gradualisht, së bashku me rritjen e numrit të ndërtesave të ngrohura dhe përmirësimin e vetë shërbimeve. Gjithashtu, parashikohen ndryshime strukturale: shkallë më e ulët e rritjes së shfrytëzimit të tëngjillit dhe rritje e rolit të derivateve të naftës në strukturën e konsumit të energjisë.




Figura 15: Parashikimi i kërkesës së energjisë për sektorin e shërbimeve për skenarin e lartë (ktoe)




Figura 16: Parashikimi i kërkesës totale të energjisë për sektorin e shërbimeve sipas dy skenarëve (ktoe)

8.2.3 Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e industrisë

Gjatë viteve të fundit, zhvillimet stabilizuese dhe tendencat për rritje në sektorin industrial janë bazuar kryesisht në teknologjinë ekzistuese, me disa zhvillime pozitive. Nga këndvështrimi i konsumit të energjisë, industria vazhdon të ketë intensitet mjaft të lartë të energjisë për njësi prodhimit, si në sasi ashtu edhe në vlerë, respektivisht 0.131 toe/ton prodhim dhe 0.688 toe/mijë Euro.

Në Tabelën 10 jepen parametrat kryesorë në të cilat është bazuar parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e industrisë.

Tabela 10: Parametrat kryesorë për parashikimin e kërkesës për energji për sektorin industrial			
Viti	PBB-Industria [Milion EURO]	Intensiteti i energjisë në industri [ktoe/Milion EURO]	TOTAL PBB [Milion EURO]
2003	255.86	0.846099	2163
2004	267.44	0.696298	2260
2005	269.22	0.846297	2373
2006	285.37	0.837834	2504
2007	302.50	0.829371	2642
2008	320.65	0.820908	2787
2009	339.88	0.812445	2940
2010	360.28	0.803982	3102
2011	381.89	0.795519	3241
2012	404.81	0.787056	3387
2013	429.10	0.778593	3540
2014	454.84	0.770130	3699
2015	48213	0.761667	3866
2016	523.86	0.753289	4041
2017	531.12	0.746434	4164
2018	553.07	0.738817	4298

Kontributi më i madh në PBB për sektorin e industrisë parashikohet të vazhdojë të vijë nga nënsektorët e ushqimit, pijeve, duhanit, metalurgjisë dhe materialeve ndërtimore. Ndërsa, sa i takon konsumit të burimeve të energjisë, kontributi kryesor vjen nga nënsektorët e metalurgjisë, materialeve të ndërtimit dhe ai ushqimor.

Parashikimi i bazuar në qasjen ‘së larti-poshtë’ i kërkesës për energji për sektorin industrial paraqitet në Figurat 17 dhe 18.




Figura 17: Parashikimi i kërkesës së energjisë për sektorin industrial për skenarin e lartë (ktoe)




Figura 18: Parashikimi i kërkesës totale të energjisë për sektorin industrial sipas dy skenarëve (ktoe)

8.2.4 Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e transportit

Trendi i indikatorëve themelorë si udhëtar-km dhe ton-km është faktori më i rëndësishëm udhëheqës në përgatitjen e parashikimit të kërkesës së energjisë për transportin e udhëtarëve dhe mallrave. Transporti i udhëtarëve është rritur mjaft pas vitit 2003. Kjo i dedikohet përdorimit të stuar të automjeteve private të udhëtimit.

Tabela 11 paraqet parametrat kryesorë të parashikimit të kërkesës për energji në sektorin e transportit¹⁵.

Tabela 11: Parametrat kryesorë të parashikimit të kërkesës për energji në transport				
Viti	PBB-Transporti [Milion EURO]	Intensiteti i energjisë për transport [ktoe/Milion EURO]	TOTAL PBB [Milion EURO]	Popullsia
2003	351.94	0.9155447	2163	1954000
2004	374.50	0.7444079	2260	1977448
2005	407.19	0.8780696	2373	2001177
2006	423.47	0.8605082	2504	2025192
2007	440.41	0.8429468	2642	2049494
2008	458.03	0.8253854	2787	2074088
2009	476.35	0.8078240	2940	2098977
2010	495.40	0.7902626	3102	2124165
2011	512.74	0.7727012	3241	2141158
2012	530.69	0.7551398	3387	2158287
2013	549.26	0.7375785	3540	2175553
2014	568.49	0.7200171	3699	2192958
2015	588.38	0.7024557	3866	2210501
2016	606.89	0.6884066	4041	2228184
2017	624.10	0.6743574	4164	2246011
2018	640.10	0.6603083	4298	2263979

Parashikimi i bazuar në qasjen së larti-poshtë të kërkesës për energji për sektorin e transportit paraqitet në Figurat 19 dhe 20.




Figura 19: Parashikimi i kërkesës së energjisë për sektorin e transportit për skenarin e lartë (ktoe)




Figura 20: Parashikimi i kërkesës totale të energjisë për sektorin e transportit sipas dy skenarëve (ktoe)

15 Në mungesë të të dhënave të detajuara, parashikimi i kërkesës së energjisë për sektorin e transportit është bazuar mbi vlerën e shtuar (pjesë e PBB) nga sektori i transportit.

Siç tregohet edhe në Figurën 19, burimet kryesore energjetike që realizojnë mbulimin e nevojave në sektorin e transportit janë dieseli, benzina dhe vajguri i avionëve. Për të ardhmen parashikohet që nafta dhe derivatet e saj dhe vajguri i avionëve do të kenë një rritje të vogël relative kundrejt benzinës.

8.2.5 Parashikimi i kërkesës së energjisë në sektorin e bujqësisë

Për sektorin e bujqësisë PBB është rritur nga 1,124.76 milionë Euro në 2003 në 1,441.26 milionë Euro në 2008. Ai parashikohet të rritet në 2,109 milionë Euro në vitin 2018. Kërkesa për energji në sektorin e bujqësisë pritet të rritet në masë të konsiderueshme për të mbështetur zhvillimin e këtij sektori të rëndësishëm për ekonominë e Kosovës.

Në Tabelën 12 paraqiten parametrat kryesorë të parashikimit të kërkesës për energji në sektorin e bujqësisë.

Viti	PBB-Bujqësia [Milion EURO]	Intensiteti i energjisë për sektorin e bujqësisë [ktoe/Milion EURO]	TOTAL PBB [Milion EURO]
2003	1124.76	0.0480212	2163
2004	1175.3742	0.0407741	2260
2005	1234.1429	0.0451517	2373
2006	1299.8404	0.0442486	2504
2007	1368.8288	0.0433456	2642
2008	1441.2602	0.0424426	2787
2009	1517.2924	0.0415395	2940
2010	1597.0896	0.0406365	3102
2011	1658.772	0.0397335	3241
2012	1722.4949	0.0388304	3387
2013	1788.3019	0.0379274	3540
2014	1856.2353	0.0370244	3699
2015	1926.3359	0.0361213	3866
2016	1999.151	0.035215	4041
2017	2052	0.0346765	4041
2018	2109	0.033954	4164

Parashikimi i bazuar në qasjen së larti-poshtë i kërkesës për energji për sektorin e bujqësisë paraqitet në Figurat 21 dhe 22¹⁶.




Figura 21: Parashikimi i kërkesës së energjisë për sektorin e bujqësisë për skenarin e lartë (ktoe)




Figura 22: Parashikimi i kërkesës totale të energjisë për sektorin e bujqësisë sipas dy skenarëve (ktoe)

Siç vërehet edhe nga Figura 21, konsumi i naftës pritet të rritet mjaft në të ardhmen; kjo për ta mbështetur kryesisht rritjen e prodhimit bujqësor të mekanizuar. Lëndët dominuese djegëse në nënsektor do të vazhdojnë të jenë nënproduktet e naftës dhe drutë e zjarrit, por parashikohet të rritet edhe kërkesa relative për energji elektrike, kryesisht për shkak të modernizimit të sistemeve të ujitjes.

8.2.6 Parashikimi i kërkesës për energji për gjithë sektorët

Figurat 23 dhe 24 paraqesin totalin e konsumit të energjisë prej vitit 2003 dhe totalin e parashikimit të kërkesës për energji në Kosovë për periudhën deri në vitin 2018.




Figura 23: Parashikimi i totalit të konsumit të energjisë në të shkuarën dhe të kërkesës së energjisë për të ardhmen nga gjithë sektorët për skenarin e lartë (ktoe)




Figura 24: Parashikimi i totalit të konsumit të energjisë në të shkuarën dhe të kërkesës së energjisë për të ardhmen nga gjithë sektorët për skenarin e lartë (%)

16 Vlera e shtuar nga sektori i bujqësisë dhe intensitetet e energjisë janë përdorur si aktivitetet themelore për parashikimin e kërkesës së ardhshme për energji në sektor. Intensitetet janë kalkuluar si raport mes konsumit të burimeve energjetike dhe nivelit të aktivitetit të nënsektorit të bujqësisë, të shprehur në milionë Euro.

Nga Figurat 23 dhe 24 duket se energjia elektrike pritet ta rritë ndjeshëm kontributin e saj relativ në konsumin total të energjisë në Kosovë. Figurat 25 dhe 26 paraqesin parashikimin e kërkesës për secilin sektor dhe totalin e saj. Nga Figura 25 duket se kërkesa e energjisë për secilin sektor ekonomik do të rritet.




Figura 25: Parashikimi i totalit të kërkesës së energjisë për të gjithë sektorët ekonomikë për skenarin e lartë (ktoe)




Figura 26: Parashikimi i totalit të kërkesës së energjisë për dy skenarët (ktoe)

8.3 Analiza e parashikimit të kërkesës për energji elektrike

8.3.1 Parashikimi i kërkesës për energji elektrike dhe i ngarkesave maksimale

Në studimin rajonal¹⁷ të parashikimit të nevojave për energji, studim i kryer ky për ta mbështetur zhvillimin e kapaciteteve të reja elektrogjeneruese dhe transmetuese të mjaftueshme të energjisë elektrike, prej vitit 2007 është rishikuar edhe parashikimi i kërkesës për energji në nivel të tregut rajonal të energjisë elektrike, bazuar kjo në kërkesat e secilit vend të rajonit, përfshirë Kosovën, me të dhënat e saj të paraqitura në seksionet këtu më sipër.

Në skenarin e mesëm të kërkesës (SMK) për energji elektrike, rritja e kërkesës në sektorin e amvisorisë parashikohet modeste, ndërsa parashikohet rritje e lartë e kërkesës në sektorin e shërbimeve dhe të industrisë. Kërkesa në vitin 2018 parashihet në 6,939 GWh/vit, kjo e shoqëruar me ngarkesë maksimale prej 1,543 MW të sistemit elektroenergjetik. Në këtë skenar të kërkesës është supozuar reduktimi gradual deri në masën 5% i humbjeve komerciale gjatë periudhës 2009-2011.

Ndërsa, sipas skenarit të lartë të kërkesës (SLK) për energjinë elektrike, konsumi në vitin 2018 parashikohet të jetë 7,431 GWh/vit, kjo e shoqëruar me ngarkesë maksimale prej 1,671 MW. Në këtë skenar të kërkesës është supozuar reduktimi gradual deri në masën 5% i humbjeve komerciale gjatë periudhës 2009-2015.

Vlerësimi i kërkesës për energji elektrike dhe ngarkesave maksimale për periudhën 2009–2018 për dy skenarët e parashikimit varet nga periudha e eliminimit të humbjeve komerciale në sistemin elektroenergjetik të Kosovës. Kërkesat për energji elektrike dhe ngarkesat maksimale për dy skenarët: (a): SMK - skenari i mesëm dhe (b) SLK – skenari i lartë, janë të paraqitura në Tabelën 13.

¹⁷ Studimi rajonal për parashikimin e nevojave energjetike, financuar nga USAID

Tabela 13: Kërkesa për energji elektrike dhe ngarkesat maksimale për periudhën 2009 – 2018 (Burimi: Pöyry - Tregu në kuadër të Kosovës dhe rishikuar bazuar në parashikimin e nevojave në mënyrë të integruar për secilin sektor sipas analizës së dhënë më sipër)

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
GWh										
SMK	4994	5226	5418	5621	5834	6059	6295	6500	6715	6939
SLK	5299	5514	5713	5929	6164	6422	6662	6898	7153	7431
MW										
SMK	1130	1174	1212	1251	1297	1343	1403	1449	1506	1543
SLK	1210	1257	1302	1349	1389	1434	1515	1566	1618	1671

Parashikimi i kërkesës së rritur sipas skenarit të lartë (SLK) nënkupton edhe investime të paarsyeshme dhe të parakohshme për ndërtimin e burimeve të reja gjeneruese dhe investimin në zgjerimin e kapaciteteve të rrjetës së bartjes dhe asaj të shpërndarjes.

Diferenca ndërmjet dy skenarëve SLK dhe SMK në kërkesat për energji elektrike dhe për fuqi maksimale arrin në rreth 492 GWh për energji elektrike dhe në rreth 128 MW për fuqi maksimale në vitin 2018. Është e evidente se eliminimi i humbjeve komerciale dhe pagesa e energjisë së konsumuar elektrike kërkon qasje dhe trajtim shumë serioz.

Në kuadër të planifikimit të angazhimit të burimeve të energjisë elektrike dhe fuqisë së nevojshme duhet të shtohet edhe kërkesa për kapacitetet rezervë në sistemin elektroenergetik.

8.3.2 Humbjet e energjisë elektrike në sistemin elektroenergetik

Niveli i lartë i humbjeve teknike (17-18%) dhe komerciale të energjisë elektrike (31-35%) në sistemin elektroenergetik, me pjesëmarrje të tyre kështu prej rreth 50% në bruto konsum në periudhën 2000-2007, janë shkaktarët kryesorë për gjendjen aktuale operuese dhe financiare të KEK sh.a.

Në sistemin elektroenergetik janë përcaktuar kufijtë në asete të prodhimit-bartjes-shpërndarjes së KEK sh.a dhe të KOSTT sh.a. Përveç humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, që janë detyrë e KEK sh.a., edhe KOSTT sh.a. duhet t'i kufizojë më tej humbjet teknike në rrjetin e tij të bartjes të shkaktuara nga konsumi elektroenergetik brenda Kosovës dhe nga tranzitimi i energjisë elektrike.

Qeveria e Kosovës në mënyrë institucionale mbështet KEK sh.a në eliminimin e humbjeve komerciale, pagesën e energjisë elektrike nga konsumatorët e financiar nga buxheti dhe fillimin e pagesës së energjisë elektrike në enklavat minoritare.

8.3.3 Masat për stabilizimin e furnizimit dhe kontrollit të konsumit të energjisë elektrike

Me qëllim të stabilizimit të furnizimit, kontrollit dhe menaxhimit të konsumit, si dhe për një planifikim të mirëfillt të kërkesës, në periudhën 2009-2010 duhet të merren masa efektive¹⁸ për eliminimin e shpenzimit ilegal dhe pagesës së energjisë elektrike, si vijon:

18 Në shumë studime janë trajtuar humbjet në sistemin elektroenergetik, sidomos humbjet komerciale (ESTAP I, D Module, Reduction in Technical Losses in Transmission and Distribution, 2002; dhe Studimi Pöyry, 2007) dhe janë propozuar masat dhe afatet për zvogëlimin e tyre.

- (i) eliminimi i lidhjeve ilegale të energjisë elektrike;
- (ii) lidhja e kontratave për furnizim me energji elektrike;
- (iii) pagesa e energjisë elektrike në bazë të matjeve; dhe
- (iv) aplikimi i politikave që tarifat t'i mbulojnë gradualisht kostot¹⁹.

8.4 Parashikimi i prodhimit të energjisë elektrike në Kosovë për periudhën 2009-2018

Gjatë tërë periudhës 1999-2008, prodhimi vjetor i energjisë elektrike nga burimet vendore ka qenë nën nivelin e kërkesës. Niveli aktual i prodhimit vjetor vendor të energjisë elektrike është në rreth 4,300 – 4,600 GWh.

Parashikimi i prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 2009-2018 bazohet në prodhimin e energjisë elektrike nga Termocentralet 'Kosova B', 'Kosova A', Hidrocentrali i Ujmanit, Hidrocentralet distributive ekzistuese dhe të reja, Hidrocentrali i Zhurit dhe nga prodhimi i Termocentralit 'Kosova e Re'.

Mbulimi i kërkesës për energji elektrike parashikohet të arrihet si vijon:

- (i) Prodhimi i energjisë elektrike në Termocentralin 'Kosova A', duke operuar Bllloqet A3, A4 dhe A5. Në zbatim të Direktivës Evropiane për Impiantet e Mëdha me Djegie, njësitë e TC 'Kosova A' mund të shfrytëzohen deri në fund të vitit 2017²⁰.
- (ii) Prodhimi i energjisë elektrike në Termocentralin 'Kosova B', duke operuar Bllloqet B1 dhe B2. Në vitin 2016 dhe 2017 parashikohen të kryhen revitalizimet dhe të realizohen projektet për përbushjen e kërkesave mjedisore të kërkuara nga Direktiva Evropiane për Impiantet e Mëdha me Djegie. Këto bllloqe pastaj do të mund të vazhdojnë operimin komercial deri edhe 15 vite mbas revitalizimit, respektivisht deri në vitin 2030.
- (iii) Prodhimi i energjisë elektrike në Hidrocentralin e Ujmanit, i cili me mirëmbajtje dhe revitalizim do të mund të jetë në operim komercial në një periudhë afatgjatë.
- (iv) Prodhimi i energjisë elektrike nga hidrocentrali distributiv i Lumbardhit.
- (v) Prodhimi i energjisë elektrike nga Hidrocentrali në Zhur, i cili parashikohet të ndërtohet deri në vitin 2015 dhe të futet në operim komercial në vitin 2016.
- (vi) Prodhimi i energjisë elektrike në bllloqet e reja në Termocentralin 'Kosova e Re'. Parashikohet që blloku i parë gjenerues të futet në operim komercial në vitin 2016.
- (vii) Në periudhën 2010- 2018 do të ndërtohen dhe do të hyjnë në shfrytëzim më shumë se 16 hidrocentrale të vogla me fuqi totale të instaluar më të madhe se 60 MW. Ndërkohë do të rehabilitohen dhe futen në shfrytëzim edhe hidrocentralet e vogla ekzistuese.
- (viii) Për një periudhë të ardhshme deri në aktivizimin e TC 'Kosova e Re', mbulimi i bilancit të energjisë elektrike do të arrihet nëpërmjet importit.

¹⁹ ESTAP III, Electricity Transmission and Retail Tariffs and Subsidy Delivery Mechanism, KEMA, 2007 (World Bank Study)

²⁰ Koha e daljes nga operimi i bllloqeve të TC 'Kosova A' përpara fundit të vitit 2017 do të varet nga hyrja në punë e bllloqeve të Termocentralit 'Kosova e Re'.


Bazuar në pranimet e mësipërme, për periudhën 2009-2018 prodhimi i energjisë elektrike nga stabilitetet gjeneruese vendore parashikohet të jetë si në Tabelën 14.

Tabela 14: Parashikimi i prodhimit të energjisë elektrike [GWh]

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
TC Kosova A	1300	1300	1300	1450	1450	950	500	0	0	0
TC Kosova B	3300	3300	3300	3300	3300	3300	3300	2500	2500	3400
TC Kosova e Re	0	0	0	0	0	0	1750	5500	7500	7500
HC Ujman	79	79	79	79	79	79	79	79	79	79
HC Zhur	0	0	0	0	0	0	398	398	398	398
HC Distributive	42	100	125	150	175	200	210	225	240	250
Total	4721	4779	4804	4979	5004	4529	6237	8702		

Një paraqitje grafike e prodhimit të parashikuar të energjisë elektrike jepet në Figurën 27.

Figura 27: Parashikimi i prodhimit të energjisë elektrike [GWh]



8.5 Furnizimi i Kosovës me energji elektrike për periudhën 2009 – 2018

Furnizimi me energji elektrike në periudhën 2009 – 2018 do të realizohet nga prodhimi vendor dhe importi, i cili do të jetë i nevojshëm deri kah mesi i vitit 2015. Në vitin 2016 pritet të futet në operim komercial blloku i parë në Termocentralin ‘Kosova e Re’ dhe përfundimisht nuk do të ketë më nevojë për import. Sasia e importit të energjisë elektrike varet nga kontrolli i konsumit të saj, më së shumti nga eliminimi i humbjeve komerciale. Kërkesat sipas skenarëve të përshkruar më sipër dhe prodhimi i parashikuar i energjisë elektrike për periudhën 2009–2018 janë përmbledhur në Tabelën 15.

Tabela 15: Kërkesa dhe prodhimi i parashikuar i energjisë elektrike

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Kërkesa [GWh]										
SMK	4994	5226	5418	5621	5834	6059	6295	6500	6715	6939
SLK	5299	5514	5713	5929	6164	6422	6662	6898	7153	7431
Prodhimi	4721	4779	4804	4979	5004	4529	6237	8702	10717	11627
Bilanci [GWh]										
Për SMK	-273	-447	-614	-642	-830	-1530	-58	2202	4902	4688
Për SLK	-578	-735	-909	-950	-1160	-1893	-425	1804	4464	4196

Vërejtje: (-) vlerat në tabelë me parashenjën minus në bilanc janë nevojat për importe vjetore

8.6 Furnizimi i termocentraleve me linjit për periudhën 2009-2018

Kërkesat për linjit për furnizimin e termocentraleve ekzistuese dhe TC 'Kosova e Re' (për fazën e parë deri në 1,000 MW) janë paraqitur në Tabelën 16.

Tabela 16: Kërkesat për linjit

Ne '000 ton

Viti	TC A	TC B	TC Kosova e Re	Tregu	Total
2009	2405	4785	0	50	7,240
2010	2405	4785	0	70	7,260
2011	2405	4785	0	100	7,290
2012	2683	4785	0	110	7,578
2013	2683	4785	0	120	7,588
2014	1758	4785	0	130	6,673
2015	925	4785	1925	150	7,785
2016	0	3625	6050	160	9,835
2017	0	3625	8250	170	12,046
2018	0	4585	8250	180	13,015

9. Misioni dhe vizioni i strategjisë së energjisë

Energjia është sektor kyç për ekonominë e Kosovës, veçanërisht kjo për shkak të potencialeve të mëdha për mihjen e linjitet dhe prodhimin e energjisë elektrike në Kosovë. Furnizimi i sigurtë dhe me cilësi të lartë i energjisë elektrike është element kritik për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik dhe për tërheqjen e interesit të sektorit privat për investime në Kosovë. Sektori i mihjes së linjitet dhe prodhimit të energjisë elektrike, po ashtu, ka potencial të bëhet burim substancial afatgjatë i të ardhurave për vendin, duke shtuar ndjeshëm tregtinë e energjisë elektrike me Evropën Juglindore si dhe duke kontribuar në integrim më të afërt me pjesën tjetër të Evropës. Kosova është e përkushtuar në arritjen e këtij synimi duke qenë në pajtueshmëri me të gjitha direktivat, normat dhe standardet e BE-së për energji dhe mjedis si dhe me dispozitat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Misioni

Misioni i kësaj Strategjie është t'i kontribuojë zhvillimit të Kosovës, duke mundësuar një zhvillim të shpejtë dhe të qëndrueshëm të sektorit energjetik në përputhje me qasjen dhe standardet Evropiane, të bazuar kryesisht në shfrytëzimin racional dhe efektiv të burimeve energjetike natyrore vendore, për ta arritur një furnizim stabil dhe kualitativ të konsumatorëve me energji dhe përdorim eficient të energjisë, duke u kujdesur njëherësh edhe për ruajtjen e mjedisit.

Vizioni

Misioni i strategjisë do të plotësohet nëpërmjet arritjes së qëndrueshmërisë financiare të sektorit energjetik; ristrukturimit të plotë të tij në përputhje me qasjen Evropiane; plotësimin të kuadrit ligjor dhe rregullator për tërheqjen e investimeve të nevojshme private, nëpërmjet proceseve të hapura dhe konkurruese; krijimit të një tregu energjie të lirë, të hapur, konkurrues dhe të integruar me tregjet rajonale dhe Evropiane të energjisë, nga i cili të gjithë konsumatorët do të përfitojnë, me kosto minimale të mundshme, shërbime energjetike të ofruara nga sisteme me teknologji miqësore ndaj mjedisit.

10. Objektivat strategjike

Zhvillimi i përshpejtuar dhe i qëndrueshëm ekonomik për Kosovën do të varet në masë të konsiderueshme nga zbatimi i politikave dhe reformave adekuate ekonomike dhe strukturore, të cilat do të sigurojnë shfrytëzim racional të burimeve natyrore dhe burimeve njerëzore në Kosovë. Qeveria e Kosovës (QK) ka përcaktuar sektorin e energjisë si njërin nga shtyllat më të rëndësishme të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe social të vendit. Ristrukturimi i sektorit të energjisë për të joshur investime private dhe zhvillimi i kapaciteteve të reja të prodhimit të energjisë elektrike, bazuar në shfrytëzimin racional të resurseve të pasura të linjtit, për ta mbuluar jo vetëm kërkesën gjithnjë në rritje të vendit për energji, por edhe për të eksportuar, janë dy synimet prioritare për QK. Këto synime janë gurëthelet e kësaj Strategjie.

Siguria e furnizimit, nxitja e investimeve në sektor, ruajtja e mjedisit dhe zhvillimi i mëtejshëm i tregut energjetik janë qëllimet strategjike kryesore të strategjisë së re Evropiane për sektorin energjetik në BE. Nga këto qëllime rrjedhin një numër objektivash të rëndësishme, përfshirë ato të ashtuquajturat 20% - 20% - 20%.

Kosova synon integrimin sa më parë në BE. Kjo do të kërkojë edhe zbatimin e objektivave 20-20-20 të planit të BE-së për fushën e energjisë, që kërkon nga shtetet anëtare që deri në vitin 2020 të: (i) Reduktojnë me 20% emetimi i gazeve që krijojnë efektin 'serë', (ii) Rritin në 20% pjesëmarrjen e burimeve të ripërtëritshme në konsumin e energjisë, dhe (iii) Përmirësimin me 20% të efikasitetit të energjisë.

Rishikimi i objektivave strategjike është bazuar në analizën e thellë të: (i) situatës aktuale të sektorit energjetik, (ii) Strategjisë së Energjisë 2005-2015, (iii) Programit të Qeverisë, si dhe (iv) angazhimit të Kosovës për t'u integruar sa më parë që është e mundur në BE.

Objektivat e identifikuar strategjike të kësaj Strategjie të Rishikuar të Energjisë janë:

1. Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm të energjisë: Të gjitha kategoritë e konsumatorëve të energjisë duhet të jenë në gjendje të gëzojnë furnizim eficient dhe të pandërprerë të energjisë, dhe të cilësisë adekuate.
2. Ristrukturimi dhe zhvillimi i sektorit të energjisë në pajtim me Traktatin e Komunitetit të Energjisë (TKE): Legjislacioni i energjisë në Kosovë duhet të jetë i bashkërenduar me *Acquis communautaire* të BE-së mbi energjinë, si dhe me planin kohor të përcaktuar nga TKE. Kosova duhet të vazhdojë me reformimet në sektorin e saj të industrisë së energjisë, në mënyrë që të sigurojë konkurrencë në tregun e energjisë sipas parimeve të përgjithshme të konkurrencës së hapur, mosdiskriminimit, transparencës, barazisë, respektimit të mbrojtjes së konsumatorëve dhe zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë.
3. Zhvillimi dhe rehabilitimi i kapaciteteve të prodhimit të energjisë elektrike nga linjiti. Zhvillimi dhe rehabilitimi i kapaciteteve energjetike gjeneruese përmes investimeve private është prioritet i lartë i Qeverisë së Kosovës. Prodhimi i mjaftueshëm i energjisë elektrike për shfrytëzim vendor, sigurimi i rezervës dhe e një sasive për eksport do të promovojë zhvillim të qëndrueshëm të vendit dhe do të sigurojë të ardhura të rëndësishme për ekonominë e vendit.

4. Zhvillimi i infrastrukturës së bartjes së energjisë: Kosova ka shthurur funksionin e bartjes (KOSTT sh.a. tanimë është korporatizuar) dhe është duke punuar në avancimin e kapaciteteve të saja të bartjes dhe transformuese për furnizim vendor dhe lidhjes më të mirë me sistemet e shteteve fqinje, përmes rehabilitimit, përforcimit dhe zgjerimit të infrastrukturës së saj të bartjes.
5. Zhvillimi i infrastrukturës së shpërndarjes së energjisë: Është e domosdoshme që Kosova t'i zvogëlojë në mënyrë drastike humbjet e energjisë, si ato komerciale ashtu dhe ato teknike në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike. Po ashtu, kërkohet edhe zgjerimi dhe fuqizimi i rrjetit të shpërndarjes së ngrohjes qendrore.
6. Promovimi i investimeve të huaja në sektorin e energjisë: Kosova synon ta mbulojë shumicën e kërkesave për kapital në sektorin e energjisë përmes investimeve private. Për ta joshur kapitalin privat, Kosova duhet ta përfundojë ristrukturimin e sektorit të energjisë dhe ta ofrojë një mjedis të qëndrueshëm rregullator brenda kontekstit të një tregu konkurrues, si dhe të përdorë disa mjete të duhura institucionale. Shturja e mihjes së linjtit, prodhimit të energjisë elektrike dhe shpërndarjes së saj, si pjesë e procesit tanimë të filluar të ristrukturimit, janë parakushte për joshjen e kapitalit privat në pajtim me *Acquis*-në e BE-së për sektorin e energjisë.
7. Optimizimi i shfrytëzimit të të gjitha burimeve të energjisë në dispozicion, përfshirë burimet vendore dhe ato të importuara: Kosova duhet ta shfrytëzojë avantazhin që i japin burimet e shumta të linjtit dhe të planifikojë shfrytëzimin e tyre racional për prodhim të energjisë elektrike, duke shfrytëzuar përparësinë konkurruese të industrisë së saj elektroenergjetike në Komunitetin e Energjisë. Veç kësaj, ajo do të shfrytëzojë në mënyrë racionale të gjitha burimet e tjera të energjisë, si potencialin hidroenergjetik dhe burimet tjera të energjisë së ripërtëritshme.
8. Promovimi i vetëdijesimit mbi mbrojtjen mjedisore në aktivitetet e energjisë: Në pajtim me TKE, Kosova është e vendosur të zbatojë *Acquis Communautaire* mbi Mjedisin për sa i përket eksploatimit të burimeve të energjisë dhe ndërtimit dhe operimit të infrastrukturës së energjisë elektrike.
9. Sigurimi i shfrytëzimit eficient të energjisë dhe promovimi i përdorimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë: Kosova ka bërë plane për promovimin e Eficiencës së Energjisë dhe shfrytëzimin e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë, si dy opsione të ndërlidhura të zhvillimit të qëndrueshëm, të cilat kontribuojnë në sigurinë e përgjithshme të furnizimit dhe mbrojtjes së mjedisit.
10. Zhvillimi i infrastrukturës së rrjetit të gazit: Është me rëndësi për Kosovën që në një periudhë afatmesme të lidhet në rrjetat rajonale të gazit përmes investimeve private. Kjo do të shtojë shumëllojshmërinë e burimeve të energjisë dhe kontribuojë konsiderueshëm në zvogëlimin e konsumit të energjisë elektrike në ekonomitë familjare dhe sektorin e shërbimeve.

11. Politikat dhe masat prioritare për realizimin e objektivave strategjike

Kosova parashikon të avancojë një numër reformash, politikash dhe strategjish sektoriale. Këto përfshijnë:

- (i) zhvillimin e kapaciteteve të reja të gjenerimit të energjisë elektrike;
- (ii) shturjen e plotë të KEK sh.a., për t'i përmbushur obligimet e Kosovës sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe për lehtësimin e pjesëmarrjes private;
- (iii) zhvillimin e një kornize të shëndoshë dhe gjithëpërfshirëse institucionale për koncesione dhe/ose privatizim për investitorët strategjikë;
- (iv) dhënien në koncesion apo privatizimin e shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike, si dhe angazhimin e sektorit privat në industrinë ekzistuese të prodhimit të energjisë elektrike;
- (v) zhvillimin e mëtutjeshëm të sistemit të bartjes së energjisë dhe interkonjeksioneve;
- (vi) promovimin e eficiencës së energjisë dhe investimet private në zhvillimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë; dhe
- (vii) zhvillimin dhe zbatimin e politikave të shëndosha për kycjen në rrjetet rajonale të gazit dhe diversifikimin e burimeve të furnizimit me energji.

11.1 Mihja e linjtit

Me shterjen e rezervave të linjtit në mihjet Bardh dhe Mirash në vitin 2010-11, hapja e mihjes së re të linjtit, me qëllim të furnizimit në kontinuitet të objekteve ekzistuese të gjenerimit, TC 'Kosova A' dhe TC 'Kosova B', është çështje urgjente, pasi që ndikon direkt në sigurinë e furnizimit me energji elektrike.

Zhvillimi i mihjeve të linjtit në periudhën e ardhshme është paraparë të ndodhë në pjesën veriore të basenit të linjtit "Kosova". Kjo pjesë njihet edhe me emrin "Fusha e Sibovcit", por me kërkesën e banorëve të asaj ane gjatë konsultimeve publike kjo fushë tani quhet "Mihja e Re".

Për të siguruar furnizim të pandërprerë me linjtit të objekteve ekzistuese të gjenerimit, në mënyrë që të shmangen ndërprerjet e kushtueshme të furnizimit me energji elektrike, kërkohet që mihja e re në pjesën Jugperëndimore të "Mihjes së Re" të fillojë me prodhim të linjtit që nga viti 2010; ashtu siç është paraparë në projektet e financuar nga AER²¹ në vitet 2005-2006.


Parandalimi i një kolapsi eventual energjetik, si shkak i vonesës në zhvillimin e "Mihjes së Re", përbën prioritet të lartë për Qeverinë. Investimet fillestare, gjatë periudhës 2008-09, të cilat arrijnë vlerën prej rreth 150 milionë Euro, do të mbulohen nga Buxheti i Kosovës. Qeveria, në kuadër të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (MTEF), ka ndarë për KEK sh.a. 75 milionë Euro gjatë vitit 2008, si linjë krediti (hua të butë) për ta financuar rehabilitimin dhe/apo për të blerë pajisjet e reja (ekskavatorët rrotorikë) për "Mihjen e Re" dhe ka zotuar për vitin 2009 rreth 75 Milionë Euro të tjera. KE (ish AER) dhe KfW kanë akorduar 26.2 milionë Euro për rehabilitimin e dy ekskavatorëve rrotorikë në sistemin e djerrinës, ku Buxheti i Kosovës bashkëfinancon me 15 milionë Euro. Qeveria do të vazhdojë ta mbështesë çdo masë të nevojshme për të siguruar furnizim të pandërprerë të kapaciteteve ekzistuese gjeneruese me linjtit.

21 Agjencioni Evropian për Rindërtim

Deri në futjen në prodhim të fazës së parë të TC “Kosova e Re” me madhësi prej 1,000 MW do të nevojitet zgjerimi i mihjes, si vazhdimësi e mihjes në pjesën Jugperëndim. Sasia totale e eksploatueshme e linjtit në “Mihjen e Re” vlerësohet të jetë 830 milionë tonë, sasi kjo që, përveç kapaciteteve gjeneruese ekzistuese, mundëson edhe furnizimin me linjit të një kompleksi termoenergjetik prej rreth 2000 MW për 40 vite.

Në Figurën 28 është paraqitur prodhimi i linjtit në parashikuar i linjtit në mihjet sipërfaqësore në periudhën 10 vjeçare 2009-2018.

Figura 28: Prodhimi i linjtit për periudhën 2009-2018



Burimi: Bilanci Afatgjatë i Energjisë Elektrike të Kosovës, 2009-2018, KOSTT sh.a.

Politika për sektorin

Qeveria po shqyrton opsionet e mundshme të riorganizimit të sektorit të mihjes së linjtit në mënyrë që të mundësohet shfrytëzimi sa më racional i linjtit nga “Mihja e Re”, duke siguruar njëherësh përfitime maksimale të mundshme financiare, ekonomike dhe sociale, si dhe përmirësimin e gjendjes mjedisore në atë lokacion.

Për këtë, Qeveria do të zhvillojë një regjim adekuat të të ardhurave, bazuar në Tantiemat (“Royalty”), taksat për rehabilitim (reclamation taxes) dhe Taksën mbi Mihjen e Linjtit (“TML”) për gjenerimin e energjisë elektrike. Ky regjim do të bazohet në kushtet e tregut, ku niveli i shumës së këtyre taksave do të jetë ndër parametrat kryesorë të përzgjedhjes së investitorit strategjik.

Zhvillimi i “Mihjes se Re” do të realizohet nëpërmjet angazhimit të investimeve të konsiderueshme, kryesisht private, në periudhën afatmesme deri atë afatgjatë me mbështetjen fillestare nga Buxheti i Kosovës, për t’i shmangur vonesat në zhvillimin me kohë të mihjes së re.

Masat kryesore që do të ndërmerren

a. Rregullimet paraprake financiare

Me qëllim të shmangies të vonesës në hapjen e “Mihjes së Re” në pjesën Jugperëndimore, me qëllim të furnizimit me kontinuitet të objekteve ekzistuese të gjenerimi, Qeveria:

1. po ndihmon në përshpejtimin e procedurave të prokurimit të KEK-ut lidhur me pajisjet dhe shërbimet e nevojshme për hapjen me kohë të mihjes së Sibovcit jugperëndimor; dhe
2. po bën financimin e nevojshëm për këtë prokurim.

b. Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit të linjtit

Qeveria do të vazhdojë ta përforcojë rolin e vet në mundësimin e investimeve private për zhvillimin e aktiviteteve minerare. Rrjedhimisht, Qeveria do të:

1. sigurojë shfrytëzimin e pastër të linjtit përmes inkurajimit të operacioneve efikase të mihjes, përmes zvogëlimit të ndikimit negativ gjatë transportimit të linjtit dhe deponimit të hirit, përmes inkurajimit të praktikave të mira globale të teknologjisë së gjenerimit, si dhe përmes ngritjes së institucioneve dhe kornizave rregullative të nevojshme për monitorim, raportim dhe verifikimin e praktikave të tilla;
2. sigurojë që komunitetet të përfitojnë nga mihja e linjiti dhe ku është e mundshme, që të lidhet zhvillimi ekonomik lokal me projektin e ri;
3. fitojë mbështetjen e gjerë të komuniteteve të prekura përmes konsultimit dhe pjesëmarrjes së informuar në nivel lokal; dhe
4. përkujdeset për politikën shtetërore të zhvillimit të minierave dhe mineraleve, e cila udhëhiqet nga parimet e qëndrueshmërisë.

c. Masat mbrojtëse mjedisore dhe sociale

Qeveria është e zotuar në ngritjen e çështjeve sociale, të cilat rezultojnë nga zhvillimi i minierave në mënyrën, e cila është në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Politikën sociale për konsultim me komunitetin, pjesëmarrje dhe zhvendosjen e banorëve të cilët jetojnë në zonat e parapara për zhvillim, do të bëhen në përputhje me rregulloret e BE-së, si dhe për t'u siguruar që efektet mbi banorët e prekur nga zhvillimi i sektorit të jenë të trajtuara në mënyrë të duhur. Në këtë aspekt, Qeveria do të:

1. hartojë dhe miratojë, në fillim të vitit 2010, kornizën e politikës sociale, përmes së cilës do të rregullohen të gjitha aspektet e procesit të zhvendosjes të banorëve në zonat ku do të zhvillohen aktivitetet e mihjes;
2. fillojë përpjekjet, gjatë vitit 2009, për rikultivimin e tokës përmes rregullimit dhe rikultivimit të lokacioneve të mbuluara në të kaluarën me djerrinë; dhe
3. zhvillojë politikën e përshtatshme për të siguruar shpërndarjen transparente dhe të paanshme të çfarëdo toke të rikultivuar.

d. Politikat e qeverisjes së mirë

Qeveria do të:

1. konsiderojë rekomandimet e këshilltarëve të kornizës ligjore dhe rregullative të projektit ‘Kosova e Re’, duke përfshirë rekomandimin lidhur me legjislaturën e propozuar për Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe Social (VSMS) dhe ndryshimet e propozuara të ligjit për shpronësim; dhe
2. mbështesë pavarësinë e Komisionit të Pavarur të Minerave dhe Mineraleve, si dhe do të sigurojë ndarjen e duhur të funksioneve të politikave nga ato rregullatore në përputhje me praktikën e mira ndërkombëtare.

11.2 Energjia elektrike

Politika që do të zbatohet

Përkundër subvencioneve të mëdha kapitale dhe operative nga bashkësia ndërkombëtare dhe Buxheti i Kosovës gjatë 10 viteve të fundit, performanca operative e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK sh.a.) nuk ka pësuar përmirësim të konsiderueshëm dhe gjendja e furnizimit me energji elektrike nuk është në nivelin e kërkuar.

Për ta adresuar këtë problem, Kosova është duke përparuar me Projektin e TC ‘Kosova e Re’, i cili në fazën e parë do të rezultojë me ndërtimin e 1,000 MW kapacitete gjeneruese moderne, efikase dhe të përshtatshme për mjedisin, që do të përbushin të gjitha nevojat e Kosovës me energji elektrike të pandërprerë në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Projekti e TC ‘Kosova e Re’ do t’i mundësojë Kosovës që nga pozita e importuesit neto të energjisë elektrike të bëhet eksportues neto i saj.

Deri në ndërtimin e TC ‘Kosova e Re’, mbulimi i kërkesës për energji elektrike do të realizohet nga prodhimi i energjisë elektrike nga kapacitetet gjeneruese ekzistuese dhe atyre të reja. Deri në aktivizim të kapaciteteve të reja gjeneruese mungesat do të mbulohen sa më mirë të jetë e mundur nga importi dhe këmbimet rajonale.

Masat kryesore që do të ndërmerren për mbulimin e kërkesës për energji elektrike

a. Mirëmbajtja dhe operimi normal i kapaciteteve ekzistuese gjeneruese

1. TC ‘Kosova A’, operim komercial me mirëmbajtje të rregullt deri në fund të vitit 2017, më së largëti:

- Operim me dy ose tri blloqe varësisht nga mundësitë e furnizimit me qymyr;
- Operim me tri blloqe, pasi të fillojë prodhimi nga ‘Miniera e Re’ e qymyrit;
- Realizimi i projektit të transportit hidraulik të hirit në miniera; dhe
- Përmirësimi i mundshëm i komponentës mjedisore.

2. TC ‘Kosova B’, operimi komercial me dy blloqe:

- Operim me dy blloqe në periudhën afatgjatë; dhe
- Rivitalizimi i dy blloqeve në periudhën 2016-2017.

3. Hidrocentralet, gjenerimi nga Ujmani dhe hidrocentralet e vogla ekzistuese.*b. Importimi dhe shkëmbimet e energjisë elektrike**c. Ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese*

- Ndërtimi i TC ‘Kosova e Re’ nëpërmjet një procesi të hapur, transparent dhe konkurrues;
- Ndërtimit i HC ‘Zhur’ me koncesion nëpërmjet një procesi të hapur, transparent dhe konkurrues;
- Ngritja e kapacitetit/shndërrimi i HC ‘Ujman’ në hidrocentral reversibil;
- Ndërtimi me koncesion i hidrocentraleve të vogla të reja nëpërmjet një procesi të hapur, transparent dhe konkurrues;
- Rivitalizimi i blloqeve të TC ‘Kosova B’; dhe
- Ndërtimi i kapaciteteve gjeneruese nga burimet e tjera të rinovueshme.

11.2.1 Sthurja e mëtejme e KEK sh.a.

Sthurja e KEK sh.a. kërkohet sipas legjislacionit ekzistues në Kosovë, obligimet në kuadër të TKE-së, dhe Strategjia e Kosovës për Energjinë. Sthurja e KEK sh.a. ka filluar me krijimin e KOSTT sh.a. në vitin 2006. Sthurja e mëtutjeshme është në proces dhe do të bëhet para se Qeveria e Kosovës të vazhdojë me privatizimin/dhënien me koncesion të TC ‘Kosova B’ dhe të aktiviteteve të Shpërndarjes dhe Furnizimit të energjisë elektrike.

Qeveria do të sigurojë ndërmarrjen e hapave për përmirësimin e qeverisjes së KEK sh.a. para privatizimit, ose dhënies me koncesion. Përmes Bordit të Drejtorëve të KEK sh.a., ajo do të kërkojë, mes tjerash, avancimin e përgjithshëm të menaxhmentit dhe sistemeve të menaxhimit të KEK sh.a. dhe dorëzimin në kohë të raporteve vjetore të auditimit të jashtëm me një numër më të vogël të kualifikimeve.

Fazat e parashikuara për shturjen e plotë të KEK sh.a. janë:

Faza e Parë: Gjatë gjysmës së parë të vitit 2009, është kryer sthurja midis divizioneve të KEK sh.a. në përputhje me Vendimin e Qeverisë së Kosovës të vitit 2008²². Sipas këtij vendimi parashihet ndarja organizative dhe financiare e KEK sh.a. në pesë njësi, apo nënsubjekte, përfshirë: Minierat e Linjtit, TC ‘Kosova A’, TC ‘Kosova B’, Shpërndarja e Energjisë Elektrike dhe Furnizimi Publik i Energjisë Elektrike. Sthurja e plotë e llogarive dhe menaxhimit midis divizioneve të KEK sh.a. është obligim edhe në kuadër të TKE-së.

Faza e Dytë: Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2009, në vijim të ndarjes financiare/menaxheriale, Shpërndarja dhe Furnizimi do të ndahen ligjërisht nga KEK sh.a. në një ndërmarrje, e cila më tej do të privatizohet në 2010, siç edhe është vendosur nga Qeveria e Kosovës në vitin 2008.

Qeveria, gjatë periudhës 2009-2010, gjithashtu do të definojë statusin pronësor të aktiviteteve jothemelore të KEK sh.a., si transporti shoqëror dhe shërbimet për ushqim.

²² Vendimi i Qeverisë mbi themelimin e Kompanisë për Shpërndarje dhe Furnizim të Energjisë Elektrike Nr 03/38, 2008; dhe privatizimin e saj përmes tenderit publik Nr 03/38, 2008 dhe Nr 08/39.

11.2.2 Faturimi dhe inkasimi, risanimi financiar i KEK sh.a.

Politika që do të zbatohet

Disa përmirësime teknike në rrjet mund të rrisin sasinë e energjisë elektrike të faturuar. KEK sh.a. tanimë ka zbatuar një sistem të hollësishëm të raportimit të bilancit të energjisë për të përcaktuar sasinë e energjisë së humbur për çdo shteg. Përparimi i mëtutjeshëm kërkon zgjerimin e njehsimit/matjes së siguruar, si në nivel të transformatorëve të shpërndarjes, ashtu edhe në nivel të përdoruesve fundorë, ku njehsorët do të jenë në lokacione të qasshme dhe të siguruar për të parandaluar manovrimin e qëllimshëm të tyre. Futja e njehsimit përmes njehsorëve 'smart' është filluar si pilot projekt në një zonë të qytetit të Prishtinës-

KEK sh.a. do të mbështetet përmes veprimeve të forta paralele të Qeverisë dhe gjyqësorit. Do të parashikohen ndëshkime të rënda për vjedhjen e energjisë elektrike dhe për korrupsion të stafit të KEK sh.a. KEK sh.a. duhet të shkarkojë punonjës të pandershëm dhe joefektivë, pa mundësi të kërkimit prej tyre të kompensimit shtesë. Policia duhet të asistojë KEK sh.a. në identifikimin sistematik të rasteve të vjedhjes dhe, sipas nevojës, të kryejë arrestime. Gjykatat duhet të pajisen me burimet e duhura dhe të përgatiten që me shpejtësi të trajtojnë ngarkesën e madhe të lëndëve të vjedhjeve të energjisë elektrike dhe të mospagesave, si dhe të procedojë me rastet e reja në të njëjtën mënyrë. KEK sh.a. duhet t'i lejojeh pronësi e plotë e të gjithë njehsorëve të përdoruesve fundorë, si dhe të jetë autoriteti i vetëm për blerjen dhe instalimin e njehsorëve.

Përmirësimi i faturimit dhe inkasimit, si dhe zvogëlimi i mospagesave të energjisë elektrike²³ kërkon vullnet të fuqishëm politik dhe zbatim të sundimit të ligjit. Një Plan gjithëpërfshirës dhe integral i Veprimit (PV), i përkrahur nga Qeveria e Kosovës (QK), që përfshin, mes tjerash, zhvillimin dhe zbatimin e një fushate mediale për edukimin e konsumatorëve dhe veprimet ndëshkuese përmes gjykatave për ata që nuk paguajnë, do të përgatitet dhe zbatohet. PV-ja duhet të mbështetet me investime kritike, siç është prokurimi i njehsorëve për transformatorët e shpërndarjes së energjisë elektrike, të cilët do të përmirësonin llogaritjen e energjisë në një nivel më të ulët dhe më të menaxhueshëm. Qëndrimi i MEM/QK është që të ofrojë mbështetje të gjerë për përpjekjet e KEK sh.a. në zbatimin e këtij Plani të Veprimit. Po ashtu, Qeveria e Kosovës është zotuar që ta miratojë legjislacionin, përmes të cilit vjedhja e energjisë elektrike do të definohej si vepër penale.

Masat prioritare për zvogëlimin e humbjeve komerciale

Vjedhja dhe mospagesa e faturave të energjisë elektrike përbën rreth 44% të kërkesës së energjisë elektrike, në sasi pothuajse të barabarta mes tyre, duke përbërë kështu një humbje në të ardhura prej afro €100 milionë. Një gjë e tillë i pamundëson KEK sh.a. mbulimin e shpenzimeve të veta operative, investimet dhe mirëmbajtjen e duhur; financimin e kontratave për importin e energjisë elektrike, si dhe pengon prospektet e joshjes së investimeve private me kushte të favorshme në sektor. Për trajtimin e kësaj çështjeje, Qeveria e Kosovës:

1. Do të kërkojë nga KEK sh.a. përgatitjen e një plani veprimi (PV) dyvjeçar për rritjen e faturimit dhe inkasimit në nivel të pranueshëm, për periudhën kohore 2009-2010, përfshirë vendosjen e caqeve për çdo tremujor;
2. Do të mbështesë KEK sh.a. në zbatimin e PV, të përmendur më sipër;
3. Do ta mbështesë KEK sh.a. në marrjen e masave për punonjësit e pandershëm dhe joefektivë;
4. Do të ndryshojë Kodin Penal, nëse është e nevojshme, për të siguruar ndëshkime të

23 Në vitin 2007 humbjet teknike përbënin 16.2% të kërkesës; vjedhja 22.4%; dhe humbjet tjera komerciale 21.4%. Thënë shkurt, 60% e kërkesës nuk është paguar. Vetëm 77% e energjisë elektrike të faturuar është inkasuar.

fuqishme dhe efektive për vjedhjen e energjisë elektrike nga konsumatorët dhe për korrupsion të punonjësve të KEK-ut;

5. Do të ofrojë burime dhe autorizime për policinë në asistimin e KEK sh.a. në identifikimin dhe regjistrimin sistematik të të gjitha rasteve të vjedhjes dhe, sipas nevojës, të kryejë arrestime;
6. Do të ofrojë burime dhe do të fuqizojë gjykatat që me shpejtësi të trajtojnë ngarkesën e madhe të lëndëve të vjedhjes së energjisë elektrike dhe të mospagesave, si dhe të trajtojnë rastet e reja në të njëjtën mënyrë; dhe
7. Do të ofrojë mbështetje të vazhdueshme për KEK sh.a. përmes fushatave të pandërprera mediale për edukimin publik.

11.2.3 Mjedisi ligjor dhe rregullator

Për sa i përket kornizave ligjore dhe rregullatore për sektorët e energjisë dhe të minierave, Kosova do të mbështetet në rekomandimet e Këshilltarëve Ligjorë dhe Rregullatorë të PATEL-it, duke përfshirë rekomandimet përkitazi për legjislacionin e propozuar për Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe Social (VSMS) dhe korigjimet e propozuara në Ligjin për Shpronësime. Po ashtu, Qeveria është e përkushtuar në mbështetjen e fuqizimit të pavarësisë dhe kompetencave të autoriteteve rregullatore të energjisë dhe minierave, si dhe për të siguruar ndarjen e duhur të funksioneve politike dhe rregullatore, në pajtim me kërkesat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe Direktivat e BE-së në fuqi.

Qeveria do të vazhdojë ta mbështesë autonominë dhe pavarësinë e ZRrE-së, sepse kjo kërkohet jo vetëm për të siguruar që KEK sh.a. dhe KOSTT sh.a. mund të bëhen të vetëqëndrueshme, por edhe për të arritur besimin e investitorëve të mundshëm. Prandaj, Qeveria do t'i mbështesë dhe respektojë vendimet e ZRrE-së.

Komisioni i pavarur për miniera dhe minerale (KPM) është i ngarkuar me licencimin e minierave të thëngjillit dhe sigurimin e pajtueshmërisë me kërkesat për shëndetin dhe sigurinë. Qeveria njëhënjërisht e mbështet dhe pavarësinë e KPM-së.

11.2.4 Termocentrali 'Kosova e Re'

Qeveria është zotuar për zhvillimin e mihjes së re të linjtit me kapacitetet përkatëse të gjenerimit, përmes investitorit strategjik privat (më tutje nën emrin "Projekti Kosova e Re"). Përmes grantit të Bankës Botërore, Projekti i Asistencës Teknike Energjia nga Linjiti (PATEL), Qeveria e Kosovës ka angazhuar këshilltarë të transaksionit, këshilltarë të kornizës ligjore dhe rregullative, dhe këshilltarë të masave mbrojtëse mjedisore dhe sociale. Këta këshilltarë të projektit po e mbështesin Qeverinë gjatë përgatitjes të një procesi të hapur, transparent dhe konkurrues për zhvillimin e projektit 'Kosova e Re'.

Pakaja finale e tenderit për Projektin 'Kosova e Re', përveç termocentralit të ri dhe mihjes së nevojshme për të, mund të përfshijë, ose të mos përfshijë, një pjesë të caktuar, apo tërë rezervat e 'Minierës së Re'. Gjatë vitit 2009, Qeveria do ta definojë përmbajtjen e kësaj pakete, në mënyrë të tillë që Projekti të realizohet me sukses duke kënaqur sa më mirë të jetë e mundur pritshmëritë prej tij nga institucionet e Kosovës. Pasi Qeveria të përcaktojë përmbajtjen e pakos tenderuese, Këshilltarët e Transaksionit do të finalizojnë Ftesën për Propozim (FpP). Ofertat priten të dorëzohen në 3-mujorin e katërt të vitit 2009, të vlerësohen në 3-mujorin e parë të 2010, dhe përmbyllja financiare pritet të ndodhë në gjysmën e dytë të vitit 2010.

Qeveria e Kosovës, përveç të tjerave, do të:

1. konsultohet me këshilltarët e transaksionit dhe këshilltarët e kornizës ligjore dhe rregullative gjatë procesit të përzgjedhjes së ofertuesit të preferuar;
2. marrë vendimet me kohë mbi çështjet e politikave;
3. finalizojë “Planin zhvillimorë të fushës së minierës së re”, përfshirë planin hapësinor të zonës së veçantë, ku do të zhvillohen të gjitha aktivitetet e lidhura me projektin ‘Kosova e Re’;
4. përcaktojë politikat ujore bazuar në prioritetet e shfrytëzimit të ujit;
5. finalizojë ndërtimin e linjës së re interkonjektive 400 kV me Republikën e Shqipërisë; dhe
6. fillojë me aktivitetet për hartimin e dokumentacionit për ndërtimin e linjës së dytë interkonjektive 400kV me Republikën e Maqedonisë.

11.2.5 Rivitalizimi i TC ‘Kosova B’ me pjesëmarrjen e sektorit privat

Rivitalizimi i TC ‘Kosova B’ është domosdoshmëri teknike. Ai jo vetëm do ta rrisë besueshmërinë në punë të këtij termocentrali dhe disi edhe kapacitetin prodhues të tij, por njëherësh do ta mundësojë edhe respektimin e normave mjedisore të kërkuara nga ligji në fuqi.

Periudha kur do të kryhet ky rivitalizim do të lidhet me kohën e futjes në operim të Termocentralit ‘Kosova e Re’. Qeveria do të realizojë rivitalizimin e termocentralit ‘Kosova B’, duke angazhuar sektorin privat. Forma e përfshirjes së sektorit privat do të vlerësohet dhe përzgjidhet me kujdes. Preferohet forma e partneritetit publik privat (PPP). Qeveria do të angazhojë mbështetjen e donatorëve për kryerjen e të gjitha studimeve të nevojshme për arritjen e rivitalizimit të TC ‘Kosova B’ në kohën e duhur me investime private.

11.2.6 Modernizimi i sistemit të bartjes dhe integrimi ndërkombëtar i tij

Politika që do të zbatohet

Qëllimi kryesor i strategjisë, sa i përket sistemit të transmisionit, është krijimi i infrastrukturës së qëndrueshme për t’i përballuar nevojat në rritje për furnizimin e konsumatorëve vendorë dhe rritjen e mundësive të Kosovës për të këmbyer energji elektrike në tregun rajonal.

Avancimi i mëtutjeshëm dhe investimet e reja janë të domosdoshme në rrjetin e bartjes. Investimet e fokusuar do të përmirësojnë besueshmërinë e sistemit të bartjes, do të eliminojnë kufizimet në transferimin e energjisë elektrike, do të lehtësojnë shkëmbimet rajonale të energjisë elektrike, si dhe do të ndihmojnë në zvogëlimin e humbjeve teknike. Përforcimi i interkonjeksioneve të Kosovës në tregun rajonal të energjisë elektrike është i domosdoshëm për të arritur siguri të furnizimit me energji elektrike në Kosovë. Rehabilitimi i disa nënstacioneve është i domosdoshëm për uljen e humbjeve teknike, përmirësimin e shërbimeve dhe rritjen e besueshmërisë.

Është e domosdoshme që zhvillimi i infrastrukturës së transmetimit të bëhet në harmoni me kriteret që sigurojnë besueshmërinë e operimit sipas standardeve evropiane. Para së gjithash, është me rëndësi të tejkalohen kufizimet në shkëmbimet e energjisë elektrike me vendet fqinje, sidomos me Shqipërinë nëpërmjet të ndërtimit të linjës së re 400 kV. Kërkesa për intensifikim të

shkëmbimeve me Shqipërinë lidhet me mundësinë e optimizimit të dy sistemeve kompatible në baza komerciale.

Furnizimi cilësor me energji elektrike nga blloqet e TPP 'Kosova e Re' imponon përformimin e rrjetës së bartjes dhe ndërtimin e nënstacioneve të reja.

Çështje të rëndësishme që do të trajtohen me kujdes lidhen me:

- Krijimin e kapacitetit të mjaftueshëm transformues ndërmjet niveleve 400 kV në 110kV dhe mirëmbajtja dhe zgjerime eventuale të stacioneve ekzistues transformues 220 kV në 110 kV;
- Krijimin e kapacitetit të mjaftueshëm të rrjetit të bartjes në nivelin e tensionit 110 kV; dhe
- Sigurimi i pajisjeve të sigurta të sistemit të grumbullimit dhe të kontrollimit të të dhënave për operimin e sistemit të bartjes.

Zhvillimi i rrjetit të bartjes do të synojë ngritjen e kapaciteteve bartëse në përputhje me kërkesat që shtrohen në kuadër të parashikimit të kërkesës në rritje për energji. Plani i zhvillimit të kapaciteteve bartëse do të mbështesë edhe nevojat e kapaciteteve të reja gjeneruese për kucje në rrjet, edhe pse investimet për kucje në rrjet duhet të përballohen nga vet gjeneruesit e rinj.

Masat kryesore që do të ndërmerren

Masat kryesore për zhvillimin e rrjetit të transmetimit përfshijnë:

- Ndërtimin e linjës interkonjektive 400 kV me Shqipërinë, nyjave 400/110 kV në regjionin e Pejës, Prizrenit dhe atij të Ferizajt me Gjilan, instalimi i SCADA/EMS²⁴, si dhe përforcimet e duhura në tensionin 110 kV;
- Përgatitjen e rregullave dhe infrastrukturës së nevojshme për operimin e tregut të energjisë elektrike;
- Kontrollin e fuqisë dhe të frekuencës (LFC) në sistemin e energjisë elektrike të Kosovës dhe blerjes nga shtetet fqinje që mundësojnë një mëvetësi në rregullim dhe kontrollimin e transaksioneve në kufijtë me sistemet fqinje; dhe
- Definimi i statusit të linjave 220 kV Nr.212 dhe Nr.215 me Maqedoninë, dhe fillimin e aktiviteteve për ndërtimin e linjës së dytë interkonjektive 400 kV me Republikën e Maqedonisë.

Qeveria e Kosovës do të definojë qartë modelin e tregut të energjisë elektrike, ashtu që zhvilluesit potencialë të gjenerimeve të reja të dinë apriori rregullat e lojës.

11.2.7 Angazhimi i sektorit privat në shpërndarje dhe furnizim të energjisë elektrike

Politika që do të zbatohet

Krijimi i kushteve për një treg pa monopol të energjisë elektrike në Kosovë, në përputhje edhe me detyrimet që rrjedhin nga Traktati për Komunitetin e Energjisë (TKE), përbën qasjen e Qeverisë për

²⁴ Sistemi për Kontroll, Mbikëqyrje dhe Grumbullim të të dhënave (SCADA) dhe Sistemi për Menaxhim të Energjisë (EMS)

tërheqje të investimeve për të siguruar çmime sa më të favorshme të energjisë për konsumatorët.

Avancimi i mëturshëm dhe investimet e reja janë të domosdoshme në rrjetin e shpërndarjes për t'i zvogëluar humbjet, ndërkohë që duhet të ndërmerren investime edhe për rritjen e efikasitetit të energjisë elektrike, për të ndihmuar kështu në kontrollimin e kërkesës. Investimet e fokusuar do të përmirësojnë besueshmërinë e sistemit të shpërndarjes, do të ndihmojnë në zvogëlimin e humbjeve teknike dhe do të përmirësojnë shërbimet dhe besueshmërinë. Investimet më urgjente në rrjetin e shpërndarjes lidhen me asetet e njësisimit në nivel të nënstacioneve dhe njësisimit të sigurt në nivel të përdoruesve fundorë.

Për shkak të faturimit dhe inkasimit të dobët dhe nevojës së skajshme për investime kapitale, Qeveria ka vendosur që Divizioni i Shpërndarjes së KEK sh.a. të privatizohet. Qeveria tashmë ka përzgjedhur Këshilltarët e Transaksionit që do ta mbështesin procesin përgatitor dhe të përzgjedhjes së investitorit privat strategjik që do t'i privatizojë funksionet e shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike, tashmë këto të fundit të inkuorporuara në një korporatë të re, të ndarë nga KEK sh.a.

Qeveria e njeh faktin se duhen të ndërmerren veprimet e duhura për përmirësimin e performancës së KEK sh.a., përpara se investitori privat të zotohet në marrjen përsipër të korporatës së re të shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike. Në të kundërtën, Qeveria do të duhet që formalisht të pranojë një nivel të palejueshëm të lartë të detyrimeve kontingjente karshi investitorëve privatë.

Qeveria është zotuar në privatizimin e KEK Shpërndarjes, mundësisht përmes shitjes së aksioneve të saj, tek investitori privat strategjik nëpërmjet një procedure ndërkombëtare konkurruese të tenderimit. Ky privatizim me një investitor strategjik me mbështetje financiare jo vetëm që do të ndihmonte në përmirësimin e shërbimeve për konsumatorët dhe zvogëlimin e barrës së Buxhetit të Kosovës, por edhe do të mundësonte investime substanciale kapitale të domosdoshme në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike në Kosovë.

Qeveria pranon se privatizimet e suksesshme në këtë nivel duhet të përgatiten mirë në mënyrë që të maksimizohen përfitimet për Kosovën. Ajo është në dijeni të faktit se shpejtësia e procesit në masë kritike varet nga vendimmarrjet e saj në lidhje me opsionet strategjike për sektorin, kapaciteti i saj institucional dhe kushtet mbizotëruese në treg.

Angazhimi i sektorit privat mund kërkojë që Kosova të marrë përsipër detyrime të konsiderueshme kontingjente, qoftë drejtpërdrejt, apo tërthorazi përmes KEK sh.a., apo KOSTT sh.a. Të gjitha detyrimet kontingjente do të deklarohen/paraqiten në pajtimit me udhëzimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), apo praktikave tjera më të mira. Kujdes i duhur do të ushtrohet gjatë negociimit të klauzolave të tilla, ndërsa vëmendje e duhur do t'i kushtohet limiteve fiskale dhe sigurimit të një shpërndarje të arsyeshme të rreziqeve ndërmjet shtetit dhe sektorit privat.

Masat që do të ndërmerren

Pas privatizimit të KEK Shpërndarjes, investitori privat do të duhet të rritë numrin e pikave të furnizimit, si dhe të fuqizojë nënstacionet 110/35kV dhe 35/10kV, bashkë me linjat ndërlidhëse. Përveç kësaj, duhet të përmirësohet konfiguracioni i rrjetit, furnizuesit/linjat e distribucionit dhe trafostacionet.

Masat dhe veprimet lidhur me rrjetin e shpërndarjes gjatë periudhës 2009-2015 parashikohet të jenë:

- Kryerja e rehabilitimeve të domosdoshme, forcimi dhe modernizimi i rrjetit me qëllim eliminimin e fytëve të ngushta, reduktimin e humbjeve teknike dhe përmirësimin e sigurisë së furnizimit me energji elektrike për konsumatorët fundorë;

- Ndërtimi i nënstacioneve të domosdoshme në të gjitha nivelet;
- Përcaktimi i nevojave të mëtutjeshme për nënstacionet e reja dhe kalimin në nivele të ndryshme të tensionit;
- Krijimi i kushteve për kyçje në sistemin e shpërndarjes të kapaciteteve prodhuese të energjisë, të bazuara në burimet e ripërtëritshme.

11.2.8 Zhvillimi i tregut të energjisë elektrike dhe konkurrenca

Politika që do të zbatohet

Qeveria është e angazhuar në zbatimin e të gjitha obligimeve të Traktatit për Komunitetin e Energjisë (TKE), në kuadër të të cilit krijimi i tregut të lirë dhe konkurrues të energjisë është një nga obligimet kryesore. Krijimin e tregut energjetik e detyrojnë edhe ligjet e Kosovës.

Po të kemi parasysh mungesën e kapaciteteve të mjaftueshme gjeneruese, kufizimet në rrjetin e bartjes, gjendjen teknike të rrjetit të shpërndarjes dhe vështirësitë për shkëmbime energjetike në sasi të mjaftueshme me vendet e tjera, si dhe çmimet e larta të importit, duket se zhvillimi i një tregu vendor konkurrues për energjinë elektrike praktikisht është i pamundur në një periudhë afatshkurtër.

Masat kryesore që do të ndërmerren

Për ta plotësuar obligimin nga TKE, hapja e tregut të energjisë elektrike për të gjithë konsumatorët jofamiljarë mund të bëhet shpejt, por kjo nuk nënkupton hapjen e tij në praktikë, kryesisht sepse rrjeti i shpërndarjes nuk është në nivelin e duhur teknik ta ofrojë pa probleme qasjen e palës së tretë (Third Party Access), si dhe sepse çmimet në tregun e huaj të energjisë elektrike nuk janë të favorshme, krahasuar me çmimet në Kosovë.

Qeveria do t'i bëjë të gjitha përpjekjet dhe mbështesë përgatitjet e duhura sa i takon bazës rregullatore që tregu vendor i energjisë të krijohet si pjesë e tregut rajonal të energjisë, në kuadër të TKE-së. Kjo nënkupton se modeli dhe rregullat e tregut Kosovar të energjisë elektrike do të jenë në përputhje me *acquis* të BE-së dhe kërkesat e TKE-së.

Në kuadër të TKE-së, Kosova detyrohet edhe të ketë provizionet e konkurrencës në përputhje me *acquis* të BE-së. Është konstatuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë se ligji ekzistues për konkurrencën në Kosovë nuk është plotësisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Për këtë MEM do të nxisë MTI-në dhe MEF-in që ky ligj të rishikohet/amandamendohet dhe të implementohet plotësisht nëpërmjet mekanizmave të identifikuar në të, duke mbuluar si duhet edhe tregun e energjisë të Kosovës në të ardhmen.

11.2.9 Tarifat e energjisë elektrike dhe mbrojtja sociale

Politika që do të zbatohet

Është politikë e Qeverisë që ta mbështesë rritjen graduale të tarifave të energjisë në mënyrë që ato të mbulojnë kostot e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe importit. Rritja do të bëhet graduale dhe e studiuar në mënyrë që çdo rritje të jetë e përballueshme nga të ardhurat e shumicës dërmuese të amvisërive në Kosovë. Për ta arritur këtë të fundit, MEM do ta koordinojë përgatitjen e një studimi mbi mundësinë e konsumatorëve për t'i përballuar shpenzimet për energji.

Masat që do të ndërmerren

Barra që rritjet e tarifave dhe zbatimin e ligjit për fuqizimin e inkasimit do të imponojnë në ekonomitë më të varfra familjare është shqetësim legjitim i Qeverisë. Ky shqetësim do të trajtohet përmes programeve mbështetëse, të cilat do t'i shënjestrojnë ekonomitë familjare në nevojë. Programi ekzistues i subvencioneve nuk është i mjaftueshëm për sa i përket financimit, si dhe nuk është efektiv në identifikimin e përfituesve të subvencioneve.

MEM-i në vitin 2007 ka propozuar konceptin e një programi mbështetës me përcaktim më të mirë të përfituesve të ekonomive familjare me të ardhura të ulëta. Në të ardhmen e afërme, në bashkëpunim me MEF-in dhe ZRRë-në, MEM-i do të këshillojë dhe mbështesë MPMS-në në zhvillimin dhe paraqitjen e një programi gjithëpërfshirës që do të shënjestrojë ekonomitë familjare nevojtare.

11.2.10 Programi për menaxhimin e kërkesës 'Demand Side Management'

Për ta përmbajtur rritjen e paqëndrueshme të kërkesës së energjisë dhe promovimin e eficiencës dhe kursimit të energjisë, MEM do ta koordinojë zhvillimin e një Programi Nacional për Menaxhimin e Kërkesës (Demand Side Management). Ky program do të përfshijë një varg masash relevante për dekurajimin e shfrytëzimit joeficient të energjisë dhe promovimin e eficiencës së energjisë dhe zhvendosjes së ngarkesës.

Objektivat e këtij programi do të përfshijnë, mes tjerash: (i) uljen e ngarkesës, (ii) zhvendosjen e ngarkesës, dhe (iii) uljen e niveleve të kërkesës, pikut dhe rritjen e niveleve të kërkesës bazë (zakonisht duke zhvendosur kërkesën e pikut drejt periudhave të kërkesës së ulët), dhe (iv) kontrollimin e rritjes së ngarkesës.

Synimi i zhvillimit të këtij programi është edhe përfshirja kompanive që orfojnë shërbimeve energjetike, furnizuesve të energjisë apo kompanive private në ofrimin e shërbimeve DSM me vlerë të shtuar për konsumatorët e energjisë, ashtu që ata të marrin vlerën më të mirë për shpenzimet e tyre për energji. Shërbimet DSM do të duhet të përfshijnë çdo gjë, nga ndihma në planifikimin e eficiencës për ndërtime të reja, gjetja e furnizuesve alternativë, konsultimet për masat e konservimit deri te menaxhimi i plotë i intervenimeve për eficiencë të energjisë.

11.2.11 Mbështetja nga Buxheti i Kosovës për sektorin elektroenergjetik

Duke marrë parasysh rritjen e parashikuar të kërkesës, çmimet e larta të energjisë së importuar dhe kohën deri në futjen në operim të TC 'Kosova e Re' (rreth vitit 2015), implikimi kryesor është se, në ndërkohë, KEK sh.a. duhet të financojë investimet dhe shpenzimet kritike për:

- (i) zhvillimin e minierës së Sibovcit Jugperëndimor për të siguruar furnizim me thëngjill pas shterimit të rezervave të mbetura të thëngjillit në Minierat Bardh dhe Mirash;
- (ii) shtimin e kapacitetit dhe rritjen e besueshmërisë së kapaciteteve ekzistuese gjeneruese të njësive të TC 'Kosova A'²⁵ dhe TC 'Kosova B', sipas nevojës, për t'i mbajtur ato në operim;

²⁵ Fokusi do të jetë në blloqet e TC 'Kosova B', të cilat konsumojnë më pak lëndë djegëse dhe lirojnë më pak emetime, sesa blloqet e TC 'Kosova A', që, megjithatë operojnë nën kapacitetin e dizajnuar. Me investime të duhura dhe mirëmbajtje, TC 'Kosova B' do të duhej të ishte në gjendje të operonte në mënyrë më të besueshme dhe me një kapacitet më të madh deri në vitin 2030. Blloqet A3, A4 dhe A5 do të mirëmbahen për të ofruar shërbime deri në vitin 2015, kur TC 'Kosova A' pritet të mbyllet, në pajtim me Direktivën e BE-së për Impiantet e Mëdhenj me Djegie.

- (iii) disa përmirësime mjedisore të sistemit të shkarkimit të hirit dhe stabilimenteve të TC ‘Kosova A’; dhe
- (iv) (iv) importimin e energjisë elektrike sipas nevojës, së paku deri në fund të vitit 2010.

Megjithatë, gjendja e dobët financiare dhe performanca ende e dobët e KEK sh.a. lënë të kuptojnë se KEK sh.a. nuk ka mundësi të financimit të më shumë se një pjese të vogël të këtyre shpenzimeve të domosdoshme. Prandaj, Qeveria duhet të ndërhyjë, sipas nevojës, për të ofruar një pjesë, apo të gjitha resurset e duhura për nevojat e përshkruara më lart.

11.3 Ngrohja e përqendruar

Politika që do të zbatohet

Ligji për Ngrohje Qendrore vendosë kushtet dhe standardet për kryerjen e aktiviteteve të prodhimit, shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë termike për ngrohje, si dhe kushtet për operimin e ndërmarrjeve të ngrohjes dhe subjekteve të tjera relevante. Ai, po ashtu mundëson qasje në rrjet dhe orienton organizimin e tregut të ngrohjes.

Masat që do të ndërmerren

Masat për zhvillimin e sistemeve ekzistuese dhe të reja të ngrohjes së përqendruar përfshijnë:

- Krijimin e kushteve të favorshme biznesore dhe nxitja e realizimit të projektit për furnizim të Prishtinës me bashkëprodhim të energjisë nga TC ‘Kosova B’;
- Orientimin e komunave drejt angazhimit të sektorit privat në zhvillimin dhe operimin e ndërmarrjeve të ngrohjes qendrore, përfshirë nxitjen për rinovimin teknologjik dhe masat për mbrojtjen e mjedisit;
- Promovimin e prodhimit të kombinuar ekonomik të energjisë në tërë territorin e Kosovës;
- Mbështetjen e iniciativave për ndërtimin e sistemeve të reja të ngrohjes qendrore në të gjitha qendrat rajonale të Kosovës.

11.4 Gazi natyror

Politika që do të zbatohet

Studimi i Gazifikimit në Evropën Juglindore i Bankës Botërore dhe KfW (tetor 2007) ka shqyrtuar mundësitë ekonomike të sjelljes së gazit në Kosovë. Ai konkludoi se mund të jetë i realizueshëm furnizimi i ngarkesave industriale dhe komerciale dhe ndërtimi i rrjeteve të shpërndarjes së gazit në Prishtinë dhe Mitrovicë.

Politika e Qeverisë është promovimi dhe përkrahja e kycjes së Kosovës në projektet rajonale të furnizimit me gaz, siç është projekti i Unazës në Evropën Juglindore, shih Figurën 28, si dhe ndërtimi me investime private i rrjetit të brendshëm për përdorimin e tij nga sa më shumë konsumatorë, kryesisht në sektorin banesor, shërbime dhe industri.

Në këtë rrafsh, varësisht prospekteve për zhvillimin e projekteve rajonale të gazit në Evropën Juglindore në kuadër të TKE-së, Qeveria mbetet e përkushtuar në krijimin e bazës ligjore dhe rregullatore për zhvillimin e sektorit të gazit me investime private. Për këtë është përgatitur draft Ligji për Gazin, në përputhje të plotë me direktivat përkatëse Evropiane.

Masat që do të ndërmerren

Në këtë kontekst, në periudhë afatshkurtër, Qeveria do të:

1. Kërkojë nga Kuvendi i Kosovës ta miratojë deri në fund të vitit 2009 draftligjin e paraqitur për gazin natyror; dhe
2. Qartësojë pronësinë e tubacionit ekzistues të gazit të qytetit dhe të drejtën mbi shtegun për atë tubacion.

Figura 29: Unaza e gazit natyror për Ballkanin Perëndimor



Burimi: Studimi i Gazifikimit Regional, Draft Raporti Final, Tetor 2007, Economic Consulting Associates

ZRRë, si organi rregullator edhe për sektorin e gazit, do ta përgatisë në kohën e duhur kuadrin rregullator për këtë sektor, kuadër ky që do të jetë plotësisht në përputhje me Direktivat e BE-së dhe kërkesat e TKE-së.

11.5 Nafta dhe derivatet e saj

Politika që do të zbatohet

Është i nevojshëm plotësimi dhe forcimi i implementimit të kornizës rregullatore për transportin, trajtimin e karburanteve të lëngëta dhe operimin e tregut të karburanteve të lëngëta në Kosovë. Fillimi i përdorimit të biokarburanteve është kërkesë e TKE-së. Për këtë, Qeveria do ta miratojë draftvendimin përkatës të përgatitur nga MEM.

Paralelisht me politikat energjetike që i përkasin shfrytëzimit racional të energjisë dhe përmirësimit të efikasitetit të përgjithshme të energjisë në Kosovë, do të merren masa për stimulimet e konsumatorëve për shfrytëzimin racional të karburanteve të lëngëta.

Shtrirja e përdorimit të Gazit të Lëngëzuar të Naftës (LPG) përbën prioritet, sepse i shërben diversifikimit të burimeve energjetike në dispozicion të konsumatorëve. Kjo do të krijonte kushte për reduktim të ndjeshëm të energjisë elektrike që përdoret për ngrohje, gatim dhe shërbime të tjera.

Kjo strategji synon edhe krijimin e rezervave të detyrueshme të derivateve të naftës, me qëllim të sigurimit të furnizimit të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm me derivate, pa luhatje ekstreme të çmimeve në tregun vendor. Për këtë, MEM do të propozojë masa për përgatitjen e një qasje afatgjatë për krijimin e stokut të karburanteve në përputhshmëri me direktivat përkatëse të BE-së. MEM, gjithashtu do ta mbështesë MTI-në në përgatitjen e një programi masash afatmesme për arritjen e rezervës së detyrueshme të karburanteve në përputhje me direktivën përkatëse të BE-së.

Masat që do të ndërmerren

Masat për zhvillimin e sektorit të karburanteve të lëngëta do të përfshijnë:

- Rregullimi i sektorit të Gazit të Lëngëzuar të Naftës (LPG), me udhëzime administrative, përfshirë hartimin dhe zbatimin e një politike nxitëse për penetrimin e gjerë të tij;
- Zbatimin e dispozitave të përgjithshme për shëndetin, sigurinë dhe mjedisin, që do të aplikohen nga organizatat dhe individët që merren me biznesin e produkteve të naftës;
- Promovimi i transportit hekurudhor për mallra dhe udhëtarë në tërë rrjetin hekurudhor të Kosovës, si alternativë e transportit automobilistik;
- Promovimi i përdorimit të biokarburanteve; dhe
- Përgatitja e planit për arritjen e rezervës së sigurisë të karburanteve të lëngëta në përputhje me direktivat Evropiane.

11.6 Eficiencia e energjisë dhe burimet e ripërtëritshme të energjisë

Politika që do të zbatohet

Sipas dispozitave të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Kosova është zotuar në rritjen e pjesës së energjisë të përfuar nga burimet e ripërtëritshme në portofolion e saj të gjenerimit. Qeveria ka vendosur një cak për Kosovën, që është arritja e një përpjese të energjisë nga burime të ripërtëritshme prej 7% deri në vitin 2016. Eficiencia e energjisë është mjet i rëndësishëm shtesë për arritjen e këtij caku. Po ashtu, me këtë do të zvogëloheshin lirimet e gazrave me efekt serë, konsumatorët do t'i zvogëlonin faturat e tyre të energjisë, dhe do të zvogëlohej kërkesa në përgjithësi, së paku në kuptim relativ. Është e qartë se rritja e pjesës së energjisë nga burimet e ripërtëritshme është e rëndësishme për Kosovën në aspektin e diversifikimit të burimeve energjetike dhe varësia gati e plotë nga kapacitetet gjeneruese me djegie të linjtit.

Përbushja e parashikimeve për prodhimin e energjisë nga BRE përbën një objektiv afatgjatë që lidhet edhe me respektimin e detyrimeve të TKE-së. Rritja e EE dhe shfrytëzimi i BRE do të kontribuojnë në realizimin e tri qëllimeve të politikës energjetike të vendit: mbështetjes për rritjen e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik, rritjen e sigurisë së furnizimit me energji dhe mbrojtjen

e mjedisit. Parakushti i zhvillimit të Eficiencës së Energjisë është plotësimi i bazës ligjore dhe rregullatore, si dhe fuqizimi i ndërtimit institucional të sektorit të EE dhe BRE, sipas shembullit të praktikave më të mira të vendeve të rajonit e më gjerë. Miratimi i Ligjit për Eficiencën e Energjisë, zbatimi i masave nxitëse qeveritare përmes politikës fiskale, si dhe nxitja për aktivizimin e sektorit publik dhe privat në aplikimin e masave të eficiencës së energjisë janë aktivitete mjaft të rëndësishme në këtë proces. Për t'i arritur caqet indikative afatgjata, tashmë të vendosura, për shfrytëzimin e BRE, përveç një pakete të masave nxitëse fiskale, ZRRë do të aprovohet tarifa nxitëse për shfrytëzimin e BRE-ve për të gjitha llojet e BRE-ve, si dhe do të krijohet një sistem për certifikatat e gjelbra.

Plotësimi i bazës ligjore dhe rregullatore për EE dhe BRE, do të përfshijë transpozimin e mëtejshëm të direktivave Evropiane për EE dhe BRE, si dhe miratimin e Ligjit për Eficiencën e Energjisë. Në zbatim të këtij ligji parashihet edhe ngritja e Agjencisë së Kosovës për Eficiencë të Energjisë, si dhe krijimi i Fondit për EE. Funkzioni, roli dhe përgjegjësitë e agjencisë do të përcaktohen me dispozitat e Ligjit për Eficiencë të Energjisë. Zbatimi i projekteve konkrete imponon nevojën për krijimin e një Fondi, apo mekanizmi inkurajues finansues, i cili, sipas këtij ligji, do të financohet nga Qeveria dhe donacionet e ndryshme të jashtme.

Masa konkrete nxitëse fiskale në fushën e EE dhe BRE përmes politikës fiskale do ta mundësojnë aplikimin e lehtësimeve doganore dhe të obligimeve të tjera lidhur me teknologjitë eficiente. Për këtë qëllim, MEM, së bashku me MEF, do të punojnë për ta ofruar një program stimujsh fiskalë në drejtim të përkrahjes së EE dhe BRE, në funksion të krijimit të një tregu të favorshëm për ta promovuar rritjen e eficiencës së energjisë dhe të shkallës së shfrytëzimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

Përgatitja e një programi mbështetës dhe nxitës për tërheqjen e investimeve private në zhvillimin e EE dhe BRE-së, sipas qasjeve Evropiane është një tjetër masë e rëndësishme që do të ndërmerret. Ajo do të synojë mundësimin e asistencës teknike për përgatitjen e projekteve të fizibilitetit dhe të zbatimit për rritje të eficiencës dhe shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme (kryesisht hidrocentraleve të vogla), si dhe për krijimin e një fondi për garantimin e kredive që investitorët privatë do t'i marrin prej bankave vendore, për të zbatuar projekte të EE dhe BRE. Synimi është tërheqja e kapitalit privat në zhvillimin e qëndrueshëm të EE dhe BRE, si masë kryesore për t'i arritur caqet në përputhje me direktivat përkatëse Evropiane për EE dhe BRE.

Masat që do të ndërmerren

Për t'i zbatuar politikat dhe masat e sipërpërmendura, Qeveria do të:

1. Përgatisë në vitin 2009 Planin Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë, siç është caktuar nga 'Task Force' për Eficiencë të Energjisë i TKE-së;
2. Transpozohet Direktivën e BE-së për Shërbime të Energjisë në ligjin dhe rregulloret vendore gjatë periudhës 2009-2010;
3. Plotësojë kornizat ekzistuese ligjore dhe rregullatore për eficiencën e energjisë dhe burimeve të ripërtëritshme në pajtim me kërkesat e TKE-së, përfshirë Ligjin për Eficiencë të Energjisë;
4. Përcaktojë dhe miratojë strategjinë për sektorin e ngrohjes, bazuar në Studimin e tregut të ngrohjes në Kosovë (2007), përfshirë opsionin e lidhjes së sistemit të ngrohjes qendrore të Prishtinës me TC 'Kosova B';
5. Rishikojë politikat ekzistuese dhe miratojë masa stimuluese, të cilat do ta përkrahin zhvillimin e sektorit të burimeve të ripërtëritshme;

6. Japë me koncesion ndërtimin e Hidrocentralit të Zhurit, pasi ai t' i nënshtrohet studimeve të pranueshme të fizibilitetit, të masave mbrojtëse mjedisore dhe sociale dhe të kalojë në procesin e konsultimeve publike;
7. Identifikojë dhe vlerësojë, gjatë vitin 2009 dhe 2010, hidro-potencialet e tjera të vogla që ekzistojnë në Kosovë;
8. Japë, deri në fund të vitit 2011, me koncesion investitorëve privatë ndërtimin e të gjitha hidrocentraleve të vogla të identifikuar dhe që do të identifikohen gjatë 2009-2010, përmes një procesi transparent dhe konkurrues të tenderimit;
9. Zhvillojë dhe fuqizojë, deri në fund të vitit 2009, masat stimuluese fiskale për promovimin e eficiencës së energjisë dhe teknologjive të energjisë së ripërtëritshme;
10. Zhvillojë, deri në fund të vitit 2010, një program gjithëpërfshirës për promovimin e investimeve private në projekte të eficiencës së energjisë dhe energjisë së ripërtëritshme; dhe
11. Ratifikojë Konventën Kornizë të OKB-së për Ndryshimin Klimatik dhe Protokollin e Kyoto-s, apo pasuesen e tyre, sa më shpejtë që të jetë e mundur.

11.7 Sigurimi i standardeve për mbrojtjen e mjedisit dhe çështjet sociale

Kosova është e angazhuar ta zhvillojë edhe më tej një kuadër të plotë ligjor dhe rregullator për mjedisin dhe ruajtjen e tij, në përputhje të plotë me *acquis* për mjedis dhe normat e standardet Evropiane. Zbatimi në praktikë i këtij kuadri ligjor dhe rregullator përbën sfidën më të madhe për të ardhmen. Kjo sepse, nga njëra anë sistemet e monitorimit të nivelit të ndotësve të mjedisit pothuajse nuk ekzistojnë, dhe nga ana tjetër aftësitë e organeve të ngarkuara me zbatimin e ligjit janë akoma të kufizuara.

Në kuadër të TKE-së Kosova njihet dhe do ta respektojë detyrimin për zbatimin e *acquis* për mjedis, që lidhen me sektorin e energjisë. Për këtë është përgatitur dhe po zbatohet një plan i veçantë masash dhe aktiviteteve. Vështirësi hasen në sigurimin e financimit për ngritjen e sistemeve të monitorimit të mjedisit.

Masat mbrojtëse mjedisore

Kosova është zotuar në miratimin dhe zbatimin e standardeve mjedisore të BE-së në të gjitha investimet në sektorin e energjisë. Qeveria do të:

1. Komplettojë legjislacionin mjedisor dhe do të avancojë aftësitë institucionale të lëshimit të autorizimeve dhe lejeve, monitorimit dhe zbatimit;
2. Miratojë kornizën e Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe Social (VSMS), përfshirë konsultimet publike, e cila do të ndihmojë në përcaktimin e opsioneve strategjike dhe informojë mbi planet zhvillimore për projektet e ardhshme të mihjeve dhe të energjisë;
3. Forcojë legjislacionin dhe strukturat institucionale për rregullimin e ndikimeve mjedisore për projektet e ardhshme të mihjes dhe të energjisë; dhe
4. Forcojë menaxhimin e burimeve ujore në pajtim me Ligjin Kosovar për Ujërat dhe Direktivat Kornizë të BE-së mbi Ujërat, në mënyrë që të sigurojë furnizim të besueshëm me ujë për sektorin banesor, industrial, të energjisë dhe të bujqësisë.

Ulja e ndotjes në ajër dhe ujërave (Kosova A)

Për shkak të pajisjeve të vjetra dhe me funksionim të dobët, 'Kosova A' liron sasi të mëdha të materieve/grimcave të ngurta në ajër dhe ndotë ujërat sipërfaqësore. Qeveria do ta përkrahë KEK sh.a. për të:

1. Riparuar dhe funksionalizuar, deri në vitin 2010, sistemin e trajtimit dhe deponimit të hirit dhe sistemin e trajtimit të ujërave të zeza për tërë termocentralin, duke përfshirë kthimin nga transportimi dhe deponimi i thatë në atë hidraulik të hirit; dhe
2. Instaluar sistemin e monitorimit mjedisor.

Masat mbrojtëse sociale

Qeveria është zotuar që çështjet sociale që lindin nga zhvillimi i minierave t'i adresojë në pajtim me praktikatat më të mira ndërkombëtare. Politikatat sociale për konsultime, pjesëmarrje dhe zhvendosje të komunitetit, janë duke u harmonizuar me rregulloret e BE-së. Qeveria do të sigurojë që ndikimet në njerëzit e prekur nga zhvillimet e sektorit adresohen si duhet. Qeveria do të:

1. Zhvillojë dhe miratojë një kornizë politikash sociale për qeverisjen e të gjitha aspekteve të zhvendosjes;
2. Fillojë në vitin 2009 me përpjekjet për bonifikimin e tokës, duke riformësuar dhe rikultivuar pjesët e mbuluara me djerrinë nga minierat ekzistuese të linjtit; dhe
3. Zhvillojë politika të përshtatshme për të siguruar shpërndarje transparente dhe të drejtë të tokave të bonifikuara, përfshirë politikatat për zhvendosjen e ekonomive familjare dhe komuniteteve të prekura.

11.8 Vendosja e sistemit modern të statistikave energjetike

Sistemi i grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave, që tashmë është në realizim e sipër edhe në MEM, duhet të jetë plotësisht në pajtim me sistemin EUROSTAT sa i përket metodave plotësisht të përcaktuara për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, si në drejtim të konsumit, ashtu edhe në drejtim të furnizimit me burime energjetike.

Një sistem i tillë i statistikave energjetike ka për qëllim të sigurojë pasqyrë të plotë për Qeverinë, investitorët dhe palët tjera të interesuara mbi gjendjen reale energjetike të vendit, si në drejtim të konsumit/tregut të burimeve energjetike, ashtu edhe në drejtim të potencialeve përkatëse energjetike, për ta bërë të mundur shfrytëzimin racional të tyre.

Në periudhën afatshkurtër në Kosovë do të vendoset një sistem adekuat i grumbullimit, përpunimit dhe verifikimit të shënimeve të plota dhe të besueshme për prodhimin dhe konsumin e energjisë sipas sektorëve. Më tej do të kalohet edhe në një sistem të të dhënave rajonale, i cili do ta bëjë të mundur vlerësimin e situatave energjetike në nivel rajonal, kjo për ta mbështetur më mirë zhvillimin në nivel rajonal.

12. Integrimet Evropiane dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

Integrimet Evropiane, si prioritet parësor i Qeverisë së Kosovës edhe për sektorin e energjisë, do të vazhdojnë të realizohen nëpërmjet:

- Procesit të Mekanizmit Përcjellës për Stabilizim dhe Asocim me BE-në (STM),
- Pjesëmarrjes në Traktatin për Komunitetin e Energjisë (TKE), dhe
- Zhvillimit të Bashkëpunimit dypalësh.

MEM do të vazhdojë ta koordinojë punën për mbarëvajtjen e aktiviteteve të sektorit të energjisë në kuadër të implementimit të Mekanizmit Përcjellës për Stabilizim dhe Asocim me BE-në. Raportet vjetore të KE-së për Kosovën i kushtojnë kujdes të veçantë edhe sektorit të energjisë. Ato identifikojnë progresin dhe sfidat për të ardhmen. Këto sfida do të jenë vazhdimisht në vëmendje të punës së institucioneve të sektorit energjetik. MEM do të vazhdojë të marrë masat e duhura, që për çdo sfidë të përgatitet plan konkret masash dhe të ndërmerren aktivitetet e duhura për ta tejkaluar atë.

Plotësimi i obligimeve të TKE-së do të vazhdojë të përbëjë një prej prioriteteve të Qeverisë. MEM do t'i intensifikojë përpjekjet për plotësimin e obligimeve nëpërmjet zbatimit në kohë të të gjitha planeve dhe roadmap-eve të përgatitura deri më tani për plotësimin e një numri të Direktivave të BE-së, në kuadër të TKE-së.

Për koordinimin dhe mbarëvajtjen e punës me aktivitetet për integrimet Evropiane, në kuadër të STM dhe ato rajonale në kuadër të TKE-së, MEM do të vazhdojë të punojmë me të gjithë aktorët relevantë të sektorit energjetik, në kuadër të Nëngrupit Punues për Energji, përfshirë bashkërendimin e punës me Agjencionin për Koordinim të Zhvillimit dhe Integrimi Evropiane.

Qeveria konsideron se bashkëpunimi ndërshtetëror dypalësh është mjaft i rëndësishëm për Kosovën. Për sektorin e energjisë ky bashkëpunim merr rëndësi të veçantë, sepse synon jo vetëm integrimin e tregjeve energjetike, por edhe rritjen e mirëkuptimit të ndërsjellë dhe shtimin e shkëmbimeve energjetike, që janë mjaft të rëndësishme për rritjen e sigurisë së furnizimit me energji, në kushtet kur infrastrukturën energjetike në vendet e rajonit nuk janë të zhvilluara në masën e duhur që të mundësojnë shkëmbime të mjaftueshme energjetike pa probleme.

Bashkëpunimi dypalësh do të synojë edhe në shkëmbimin e eksperiencave dhe unifikimi i qasjeve dhe praktikave për çështje relevante. Në periudhën afatshkurtër MEM synon të arrijë marrëveshje të bashkëpunimit për sektorin energjetik me Maqedoninë, Malin e Zi dhe Bullgarinë.

13. Ngritja e kapaciteteve institucionale vendore

Zhvillimi i kapaciteteve politikëbërëse, rregullatore dhe menaxhuese përbën një tjetër sfidë të rëndësishme për Kosovën, që lidhet dhe ndikon direkt edhe në zbatimin e kësaj Strategjie të Rishikuar të Energjisë. Qeveria çdo vit do të ndajë nga Buxheti i saj fonde për ngritjen e kapaciteteve njerëzore, si dhe do të nxisë dhe mbështesë edhe entet rregullatore të energjisë dhe minierave ta bëjnë të njëjtën gjë. Por, vetëm mbështetja nga Buxheti nuk do të jetë e mjaftueshme, prandaj kërkohet dhe pritet që edhe në kuadër të bashkëpunimit me donatorët ndërkombëtarë të sigurohet mbështetje për ngritje të kapaciteteve njerëzore në fushën e politikëbërjes, rregullimit ekonomik të sektorit energjetik dhe menaxhimit e ndërmarrjeve energjetike. Kjo asistencë nuk ka munguar deri më tani, por ajo duhet të shtohet sepse edhe sfidat me të cilat ballafaqohet aktualisht sektori energjetik janë më të mëdha.

Zhvillimi i kapaciteteve hulumtuese dhe atyre për aplikimin e teknologjive të reja është një tjetër fushë ku kërkohet vëmendje dhe mbështetje. Qeveria është e angazhuar në këtë drejtim dhe do t'i mbështesë institucionet kërkimore e shkencore dhe universitetet në fokusimin më të mirë të punës së tyre në zhvillimin e kapaciteteve hulumtuese, njohjen e teknologjive të reja dhe aplikimin e tyre në Kosovë.

14. Masat për zbatimin e Strategjisë së Energjisë

Për zbatimin e kësaj Strategjie do të përgatitet së shpejti Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë (PZSE) për Periudhën 2009-2011. Ky program do t'i përmbajë:

- masat dhe projektet (të rishikuara sipas nevojës) që nuk janë arritur të financohen dhe zbatohen gjatë periudhës 2006-2008 dhe që janë konsideruar prioritare dhe të nevojshme nga kjo strategji e rishikuar e energjisë;
- masat dhe projektet e reja që janë identifikuar dhe përfshihen në këtë strategji të rishikuar të energjisë për periudhën afatshkurtër deri në atë afatmesme;
- propozime konkrete të mënyrës së financimit për secilën masë, program, apo projekt të përfshirë në të (përfshirë financim në kuadër të KASH, ose nga donatorë konkretë); dhe
- një masë për institucionalizimin e bashkëpunimit ndërinstucional vendor për zbatimin e PZSE 2009-2011.

PZSE 2009-2011 do të konsiderojë në mënyrë të veçantë edhe projektet e paraqitura në Konferencën e Donatoreve për Kosovën, mbajtur në Bruksel më 11 korrik 2008. PZSE do të konsultohet paraprakisht me MEF dhe donatorët kryesorë në mënyrë që të arrihet financimi sa më i mirë i tij për tri vitet 2009-2011.

Koordinimi i përgatitjes së PZSE 2009-2011 do të bëhet nga MEM. PZSE 2009-2011 do të paraqitet në Qeverinë e Kosovës.